



# LOGOS

## REVISTË SHKENCORE

---

KALIBRIMI I THROMBOPLASTINËS  
DHE STANDARDIZIMI I KOHËS  
SË PROTROMBINËS

KORRELACIONI MES IgE - TOTALË  
DHE EOZINOFILISË NË  
SËMUNDJET ALERGJIKE

ANALIZA E KRIMIT NË SHQIPËRI  
PËRMES APLIKIMIT  
TË METODAVE TË GRUPIMIT  
DATA MINING

ASPEKTE TË MODELIT  
TË MENAXHIMIT  
TË EMIGRACIONIT NË FRANCË

ISSN 2308 - 2208

| 2016 | NR. 3 |

TIRANË





# LOGOS

- REVISTË SHKENCORE -

| 2016 | Nr. 3 |

SHTYPUR NË SHTYPSHKRONJËN "NGJALLJA"

Botim i Shkollës së Lartë Private “*LOGOS*”

**Kryeredaktor:**

Prof. ALEKSANDËR SALLABANDA

**Redaksia:**

Prof. asc TEFTA RROTA

PhD. GUXIM KOLA

PhD. LEONORA ZOTO

Dr. RIDVANA MEDIU

Msc. ARIOL RAMA

Msc. LUAN SINANAJ

Msc. DORINA MINXURI, sekretare e redaksisë

Adresa e kontaktit: [redaksia@shlplogos.edu.al](mailto:redaksia@shlplogos.edu.al)

ISSN 2308-2208

## TREGUESI I LËNDËS

- Kalibrimi i tromboplastinës dhe standardizimi i kohës së protrombinës në popullatën shqiptare ..... 7  
*Msc. Ariol RAMA, Erisa SINO*
- Korrelacioni mes IgE - totale dhe eozinofilisë në sëmundjet alergjike. .... 19  
*Msc. Alketa BAKIRI, Dr. Alma BARBULLUSHI, Xhevahire GAXHA, Dr. Ervin MINGOMATAJ*
- Diferenca mes testimit të glicemisë në laborator dhe testimit me glukometër ..... 35  
*Msc. Blerina RESULAJ, Rigerta VESELI*
- Ripërdorimi i të dhënave të Internetit përmes kalimit nga një platformë softuerike në një tjetër ..... 47  
*Msc Luan SINANAJ, Dr. Valmira OSMANAJ*
- Analiza e krimit në Shqipëri përmes aplikimit të metodave të grupimit data mining. .... 64  
*Msc. Olta PETRITAJ, Prof. asc. Ana KTONA, Msc. Gazmira BRAHUSHI*

• Aspekte të modelit të menaxhimit të emigracionit “Tolerancë dhe laicizëm” në Francë . . . . .	78
<i>PhD. Leonora ZOTO</i>	
• Dinamika sociale dhe juridike e minoriteteve etnike në Rumani . . . . .	94
<i>Dr. Bledar ILIA</i>	
• Kontributi i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në arsim. . . . .	108
<i>Olgert (Kristi) XHAFER, PhD. Patris POSHNJARI</i>	

Revista “**LOGOS**”, botim i Shkollës së Lartë Private “Logos” është një revistë shkencore multidisiplinare, që synon të botojë artikuj shkencorë nga studentët, stafi akademik dhe bashkëpunëtorët e tyre. Ajo i dedikohet në radhë të parë studentit dhe ka njëkohësisht qëllim profesional dhe edukativ. Revista ofron një mundësi për botimin e artikujve më të mirë lidhur me eksperiencat praktike dhe punën kërkimore, që përkojnë me programin e studimeve. Të mësuarit aktiv dhe i integruar ndihmon në forcimin e lidhjes ndërmjet teorisë, kërkimit dhe praktikës. Qëllimi kësaj reviste është që të zhvillojë mendimin kritik te studentët, t’i ndihmojë ata në realizimin e diplomave dhe t’i familjarizojë me botimin shkencor. Revista synon të botojë artikuj të rinj, të cilët nuk janë publikuar më parë, nga fusha e ekonomisë, mjekësisë, informatikës dhe shkencave sociale.

Student është çdokush që studion, kërkon dhe hulumton, prandaj revista fton të gjithë individët e angazhuar në procesin e studimit dhe kërkimit, si në disiplinat shkencore dhe ato sociale, në botimin e artikujve dhe promovimin e punës së tyre.

REDAKSIA



# KALIBRIMI I TROMBOPLASTINËS DHE STANDARDIZIMI I KOHËS SË PROTROMBINËS NË POPULLATËN SHQIPTARE

**Msc Ariol Rama<sup>1,2</sup> , Erisa Sino<sup>1</sup>**

## ABSTRAKT

Studimet e kaskadës së koagulimit janë të rëndësishme për të kuptuar spektrin e plotë të koagulopative që prekin një numër të madh pacientësh. Studimi i kaskadës së koagulimit ka më tepër rëndësi tek ata pacientë që trajtohen me antikoagulant si Warfarin, Sintrom dhe mjekime të ngjashme. Te këta persona rëndësi të veçantë klinike kanë vlerat e PT/ INR. Skema e OBSH-s për standardizimin e kohës së protrombinës (PT) gjen zbatim të kufizuar për shkak të vështirësive në implementim. Në këtë eksperiment është trajtuar de-novo skema e kalibrimit të tromboplastinës dhe standardizimi i kohës së protrombinës në popullatën shqiptare

---

1. Universiteti Logos, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Departamenti i Teknikëve të Lartë të Laboratorëve Mjekësorë, Tiranë, Albania

2. Laboratori Qendror Diagnostik, Hygeia Hospital, Tiranë, Albania



## 1. Hyrje

Protrombina është një proteinë, që merr pjesë në procesin e koagulimit duke hyrë në reaksion me *Tromboplastinën* një enzimë që gjendet brenda trombociteve. Koha e protrombinës (PT) është një test që mat kohën (në sekonda) që i duhet gjakut për të formuar trombin hemostatik. Kaskada e koagulimit të gjakut, e quajtur ndryshe dhe hemostaza sekondare, është proces i ndërlikuar, në të cilin marrin pjesë 13 faktorë dhe që përfundon me formimin e rrjetës së fibrinës. Në varësi të vendit ku gjenerohen faktorët, kaskada e koagulimit ndahet në tri rrugë; në rrugën e jashtme, në rrugën e brendshme dhe në atë të përbashkët. Në rrugën e brendshme (*Intrinsic Pathway*) marrin pjesë faktori i XII, XI, IX, VIII, rruga e jashtme (*Extrinsic Pathway*) përbëhet nga faktori i VII, VIIa dhe rruga e përbashkët nga faktori i X, Xa [9].

Koha e protrombinës (PT) u fut si koncept nga Quick në vitin 1935, përpara se të zbuloheshin atikoagulantët oral dhe për një kohë të gjatë ka qenë metodë universale për kontrollin laboratorik të kohës së koagulimit. Testi i zhvilluar nga Quick u përdor më vonë për terapinë e antikoagulantëve oral [10].

Për shkak të mungesës së standardizimit të tromboplastinës dhe metodave të ndryshme të përdorura për të gjeneruar rezultatet laboratorike, testi i PT nuk dha rezultate uniforme dhe të sigurta për dozimin oral të antikoagulantëve. Në vijim, gjatë një studimi bashkëpunues ndërkombëtar u propozua sistemi INR (*International Normalized Ratio*) që u miratua nga OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) [10].

Skema e OBSH për standardizimin e kohës së protrombinës (PT) ka hyrë në përdorim që para 25 vitesh. Në këtë skemë INR derivon nga testimi manual i PT duke përdorur kryesisht përgatitje sipas referencës [4].

Vlerat ISI (*International Sensitivity Index*) dhe të INR (*International Normalized Ratio*) mund ndryshojnë në varësi të aparaturave dhe mënyrës së kalibrimit. Prandaj, disa prodhues sigurojnë një sërë vlerash të ISI (0.97-1.0) për koagulometra të ndryshëm. Në përpjekje për të tejkaluar vështirësitë e kalibrimit të ISI, u rekomandua përdorimi i një seti plazmash të liofilizuara sipas ECAA

(European Concerted Action on Anticoagulation) me INR të certifikuar nga OBSH, procedurë e miratuar edhe nga Administrata Amerikane e Medikamenteve dhe Ushqimit (FDA).[4]

Metoda direkte e përllogaritjes së INR bazohet në analizën e regresionit linear, e cila përdor ISI të gjeneruar nga njësi lokale laboratorike. INR gjenerohet sipas ekuacionit (PT/MNPT e pacientit) ISI ku MNPT është mesatarja gjeometrike e kohës së protrombinës në të paktën 20 subjekte të rritur e të shëndoshë të të dy seksëve në të njëjtin sistem lokal duke ruajtur të njëjtat kushte testimi. Kështu tromboplastina karakterizohet nga ISI, e cila përftohet nga krahasimi i rezultateve të kohës së protrombinës (PT) të 20 pacientëve shëndoshë dhe 60 pacientëve të stabilizuar (të trajtuar me antikoagulant prej më shumë se 6 javësh), të matur me tromboplastinën lokale dhe vlerave të kohës së protrombinës (PT) të të njëjtave plazma, duke përdorur tromboplastinë e standardizuar sipas OBSH. [7]

Sa më afër vlerës 1.0 të jetë ISI, aq më i lartë është sensitiviteti i tromboplastinës lokale. Megjithëse ISI korrigjon diferenca të mëdha të PT, vihet re një mospërputhje persistente e INR midis rezultateve të gjeneruara me sisteme të ndryshme testimi. Gjithashtu, plazma të pacientëve të ndryshëm mund të shfaqin diferenca të theksuara të INR-së kur testohen paralelisht me reagentë të ndryshëm.[6]

Evidenca laboratorike ka demonstruar se tromboplastinat njerëzore me ISI të ulët ndikohen më shumë nga koagulometrat se tromboplastinat e derivuara nga lepuri me ISI të lartë. Kjo ndodh kryesisht për shkak të zvogëlimit të propocionuar të PT-së normale që sjell një ndryshim të raportit të protrombinës (RP= PT/MNPT) nga e cila varet INR. Për të korrigjuar këtë rekomandohet sistemi lokal i përllogaritjes së ISI(kombinimi tromboplastinë/koagulometër), i cili redukton gabimin, por nuk e korrigjon plotësisht INR. Në të gjitha rastet kalibrimi i ISI në sistemet individuale të testimit të PT është i rekomanduar. [7]

Marrëdhënia e saktësisë së INR-së me ISI-në nuk është e thjeshtë meqë ndikohet nga cilësia e reagentëve që përdoren gjatë testimit.[2] Tromboplastinat me ISI që variojnë nga 0.9 deri në 1.3 janë të pranueshme sipas udhëzimeve të rishikuara të OBSH.[9] Avantazhi klinik i tromboplastinave me ISI të ulët (~1.0) konsiston në faktin se ofron një gjerësi më të madhe të intervalit terapeutik të

mjekimit me antikoagulant. Saktësia e testimit të PT tenton të jetë më e madhe në rastet e një ISI të ulët ( $\sim 1.0$ ).[7]

Megjithatë, reagentët e ndryshëm të tromboplastinave tregojnë një variabilitet dhe diferenca të konsiderueshme të INR-së, veçanërisht në ditët e para të trajtimit me atikoagulant. Për të eliminuar këto diferenca rekomandohet kalibrimi i ISI në një sërë qendrash standardizimi, por kjo është qartësisht jo praktike në nivel të spitalit lokal. Për reagentët komercialë të tromboplastinës me frekuencë të gjatë përdorimi është i rëndësishëm kalibrimi lokal i ISI për të siguruar besueshmëri të INR-së.[3]

Plazmat e liofilizuara të certifikuara nga organizata ndërkombëtare mund të përdoren për kalibrimin e sistemit lokal të matjes së kohës së protrombinës. Kalibrimi lokal i INR-së, duke përdorur numrin minimal të plazmave të liofilizuara, prodhon një deviacion të pranueshëm të vlerave të INR-së. Megjithatë, pak studime janë bazuar në kalibrimin lokal të ISI të sistemeve të testimit të PT-së. Në zëvendësim të kalibrimit lokal, laboratorët janë mbështetur në vlerat e ISI të ofruara nga prodhuesit e reagentëve të tromboplastinës. [3]

Për të përmbushur kërkesat e mëdha për administrimin e antikoagulantëve janë zhvilluar procedura analitike të reja që përfshijnë testimin POC. Këto janë tepër popullore, sepse mund të përdoren dhe nga personel i patrajnuar dhe madje nga vetë pacientët. Siguria e INR e matur me anë të POC nuk mund të verifikohen lehtësisht, sepse nuk mund të kalibrohet në bazë të vlerës së ISI-së. Vlerësimi i jashtëm i cilësisë së monitorëve POC shkon përtej kapaciteteve të skemave kombëtare dhe rajonale të vlerësimit të cilësisë për shkak të numrave masiv të instrumenteve të përdorur.[4]

Qëllimi, për t'ju rikthyer këtij studimi, është që të vlerësohet dhe stabilizohet metodika e kalibrimit të ISI-së në laboratorët lokal duke përdorur plazma pool përfaqësuese të popullatës shqiptare.

## II. Metodat

Gjatë këtij eksperimenti janë ekzaminuar 36 kampionë nga të cilët 18 prej tyre u përkisnin individëve (të shëndoshë) pa patologji të rrugëve të koagulimit,

ndërsa 18 të tjerët ishin të individëve nën terapi me antikoagulante oral për të paktën 6 javë. Kampionët biologjikë, të cilët janë përdorur gjatë këtij eksperimenti janë plazma me citrat natriumi 3.8% të mbledhur me anë të sistemit VACUTANER BD. Emrat e pacientëve janë mbajtur anonim duke ruajtur etikën dhe konfidencialitetin. Çdo mostre biologjike i është përcaktuar një numër rendor identifikues. Kampionët biologjikë të ndarë nga elementët e gjakut janë ruajtur në ngrirje gjatë një interval kohor prej 12 orësh.

### Faza 1.

Gjatë seancës së parë të këtij eksperimenti është bërë matja në sekonda e kohës së formimit të klotit të fibrinës duke përdorur reagentin e CYPRESS DIAGNOSTICS me numër reference HC00200. Përgatitja e reagentit është bërë sipas instruksioneve të këtij duke kombinuar volumin e plotë të bufferit të dhënë nga prodhuesi me volumin e liofilizatatit. Përzierja është lënë në temperaturë ambiente për një interval kohor prej 20-30 min, kohë gjatë së cilës reagenti është miksuar lehtë.

**Skema e reaksionit përmban:** 1ml pjesë kampion (plazma) me 2 pjesë reagent. Në këtë eksperiment është rritur në mënyrë subjektive sasia e volumit të kampionit dhe të reagentit në mënyrë që të vizualizohet me lehtë momenti i formimit të klotit. Skema e kombinimit të reagentit me kampionin biologjike është paraqitur në tabelën 1.

**Tabela 1.**

Kampion	125 µl (mikrolitra)
Inkubohet 2 minuta në 37°C në banjo mari. Shtohet reagenti Tromboplastinë( CYPRESS DIAGNOSTICS).	
Reagent	250 µl (mikrolitra)
Startohet menjëherë kronometri. Provëza tundet lehtësisht provëza. Observohet koha e formimit të klotit.	

## Faza 2.

Gjatë seancës së dytë të këtij eksperimenti është bërë matja në sekonda e kohës së formimit të klotit të fibrinës duke përdorur reagentin e standardizuar të OBSH. Përgatitja e këtij reagenti është bërë sipas instruksioneve të këtij duke kombinuar volumin e plotë të reagentit (standard sipas OBSH) me 10 ml ujë të bidistiluar. Përzierja është lejuar të qëndrojë për 30 minuta në termostat në temperaturën 37°C duke u miksuar lehtas.

**Skema e reaksionit përmban:** 1 pjesë kampion (plazma) me 2 pjesë reagent. Në këtë eksperiment është rritur në mënyrë subjektive sasia e volumit të kampionit dhe të reagentit në mënyrë që të vizualizohet me lehtë momenti i formimit të klotit. Skema e kombinimit të reagentit me kampionin biologjik është paraqitur në tabelën 2.

**Tabela 1.**

Kampion	125 µl (mikrolitra)
Inkubohet 2 min në 37°C në banjo mari. Shtohet reagenti (standard sipas OBSH).	
Reagent	<b>250 µl (mikrolitra)</b>
Startohet menjëherë kronometri. Tundet lehtësisht provëza. Observohet koha e formimit të klotit.	

Në bazë të rezultateve të mësipërme, dhe historisë mjekësore të pacientëve të përfshirë në këtë eksperiment u izoluan të dhënat përkatëse vetëm të pacientëve të shëndoshë. Gjatë këtij observimi vetëm 18 pacientë, përkatësisht me numrat 003, 004, 010, 011, 013, 014, 016, 020, 021, 022, 023, 024, 026, 028, 029, 030, 032, 035, u analizuan për të përlllogaritur MNPT( mesataren gjeometrike të kohës së protrombinës) përfaqësuese të popullatës shqiptare.

Selektimi i individëve të shëndoshë u bë i mundur pas një procesi të kujdesshëm për të skrinuar vetëm ato individë pa koagulopati dhe me histori familjare negative të ndonjë deficence të mundshme të faktorëve të koagulimit. Formula matematikore e përdorur gjatë këtij studimi për të gjeneruar MNPT është dhënë si më poshtë:

$$n\sqrt{14 \times 9 \times 11 \times 10 \times 11 \times 14 \times 12 \times 12 \times 13 \times 14 \times 12 \times 14 \times 14 \times 14 \times 15 \times 14 \times 14 \times 15}$$


*n = numri i individëve të përfshirë.*

Në përputhje me përlogaritjet e mësipërme, MNPT e gjeneruar është = 12.76 sekonda, vlerë kjo përfaqësuese e popullatës shqiptare.

Duhet theksuar se gjatë këtij studimi është vlerësuar mundësia që përlogaritja e MNPT nga plasma pool shqiptare të zëvendësohej me standard human plasma të përgatitur, e cila shoqërohet me një vlerë të përcaktuar nga laboratorët referues. Megjithatë, ky studim ka për qëllim të përcaktojë strukturën e duhur që duhet të ndiqet në rastet e llogaritjes së MNPT nga plasma pool e një popullate specifike.

Përlogaritja e vlerave të ISI së reagentit të CYPRESS DIAGNOSTICS është gjeneruar gjatë analizës së paraqitur në **grafikun 1**, nga ku pjerrësia (**m**) e drejtëzës së ndërtuar nga analiza e regresionit linear të thjeshtë është e barabartë me vlerën e ISI-së. Grafiku i mëposhtëm paraqet çiftet e matjeve të formimit të kohës së klotit përfundimtar, kohë e dhënë në sekonda dhe e paraqitur në boshtin (y) për reagentin e OBSH dhe në boshtin (x) për reagentin e CYPRESS DIAGNOSTICS. Analiza e rezultateve është bërë sipas specifikave të testit statistikor të përdorur gjatë këtij eksperimenti.

**Grafiku 1.**



Krahas eksperimentit përgjithësues të ndërmarrë në laborator janë observuar dhe vlerat e publikuara të prodhuesit të reagentit të CYPRESS DIAGNOSTICS. Vlera këto te paraqitura në tabelën 3.

**Tabela 3.**

<b>MASTER CURVE</b>			
<b>COURBE DE RÉFÉRENCE</b>			
<b>Lot 920214</b>			
		<b>%</b>	<b>sec</b>
<b>CYANCoag</b>	<b>ISI</b>	100	13,3
	1,20	50	21,0
	<b>MNPT</b>	33	28,5
	13,3	25	37,7
		<b>%</b>	<b>sec</b>
<b>Optical Optique</b>	<b>ISI</b>	100	13,7
	1,14	50	20,7
	<b>MNPT</b>	33	28,0
	13,7	25	34,9
		<b>%</b>	<b>sec</b>
<b>Mechanical Mécanique</b>	<b>ISI</b>	100	14,1
	1,20	50	22,0
	<b>MNPT</b>	33	30,2
	14,1	25	37,8

### III. Analizë të dhënash dhe konkluzione

Gjatë përpunimit statistikor vërehet që vlera e MNPT përfaqësuese e popullatës shqiptare është e ndryshme nga vlerat e publikuara të prodhuesit të reagentit CYPRESS DIAGNOSTICS. Një diferencë e tillë dhe pse jo shumë domethënëse, ilustron dhe një herë rëndësinë e gjenerimit të MNPT-së sipas popullatave specifike. Gjithashtu duhet theksuar se gama e aparaturave të testuara nga prodhuesi limiton përdorimin e këtij reagenti me pajisje te tjera që gjenden në tregun vendas.

Gjatë analizës së regresionit linear gjenerohen të dhëna mbi përputhshmërinë analitike të reagentit CYPRESS DIAGNOSTICS dhe reagentit të standardizuar sipas OBSH. Ky krahasim i domosdoshëm analitik është dhënë nëpërmjet statistikës least square  $R^2=0.9241$ , e cila tregon për një homogjenitet analitik pothuajse të kënaqshëm ndërmjet dy reagentëve të cilësuar më lart. Megjithatë, standardet ndërkombëtare cilësojnë si përputhshmeri analitike një vlerë të least square që kufizohet nga intervali ( $R^2=0.98-1.0$ ). Analiza e regresionit, bazuar në formulën

$Y=mx + B$ , përlogarit një vlerë të ISI të barabartë me 1.27 vlerë, e cila përkon me pjerrësinë e drejtëzës( $m$ ) të sipërpërmendur. Krahasimi i kësaj vlere kundrejt vlerave të gjeneruara nga prodhuesi në listën e kurbës master të kalibrimit tregon për një mospërputhje domethënëse që ndikon kryesisht në vlerat e larta të INR (duke i mbivlerësuar ato) së pacientëve nën terapi me antikoagulantë oral. Nga pikëpamja analitike, matja e kohës së protrombinës në njësinë e INR kërkon përdorimin e reagentëve që përmbushin kriterin e mëposhtëm:

**1. 0 H"ISI d"1.3.** Nga eksperimenti observohet që reagenti CYPRESS DIAGNOSTICS është në limitin e sipërm të kriterit përzgjedhës së performancës analitike të pranueshme.

INR-t e sigurta brenda targetit terapeutik janë thelbësore për një terapi të sigurtë dhe efikase me antikoagulate oral. Skema e kalibrimit të ISI sipas OBSH nuk ka rezultuar në ndonjë standardizim absolut universal të PT. Kjo ndodh për shkak të vështirësive në implement,, sepse kalibrimi lokal i ISI kërkon ekspertizë të veçantë laboratorike. Kërkesa minimale për kalibrimin konvencional të ISI sipas OBSH është kryerja e një studimi multiqendror në 60 pacientë të stabilizuar me antikoagulantë oral afat gjatë dhe 20 pacientë normale

Gjatë këtij studimi vihet re që është e nevojshme, ashtu sikundër rekomandohet, që të kryhet standardizimi i PT/INR sipas popullatës shqiptare. Për zhvillimin e eksperimentit janë përdorur një numër i pranueshëm pacientësh. Gjithashtu kushtet e zhvillimit të eksperimentit kanë qenë optimale duke siguruar të dhëna laboratorike të besueshme. Sipërmarrja e iniciativave të tilla nga institucionet mjekësore shqiptare mund të bëjnë të mundur standardizimin e analizave në përgjithësi dhe në veçanti standardizimin e PT/INR duke përdorur plasma pool nga popullata shqiptare. Zhvillimi i saktësisë lokale përmes përdorimit të verifikimit lokal të ISI shton besueshmëri më të madhe në raportimin e saktë të vlerave të INR-së. Metodatat për verifikimin e ISI lokale sapo kanë filluar të përdoren në disa vende. Kjo kërkon dokumentacionin përkatës për të vërtetuar nëse ISI-të janë të vlefshme dhe të përdorshme klinikisht. Metodatat mund të duken komplekse dhe me llogaritje matematikore të vështira, por prodhuesit e kitit ndihmojnë në kryerjen e këtyre përlogaritjeve.

Ky studim përmbush qëllimin e tij duke shërbyer si udhëzues mbi mënyrën e kalibrimit/verifikimit të vlerave të ISI dhe MNPT për popullatën shqiptare.



## BIBLIOGRAFIA

1. Altman R., Rouvier J., Gurfinkel E. *Comparison of two levels of anticoagulant therapy in patients with substitute heart valves.* J Thorac Cardio-vascular Surgery 1991.
2. *British Society for Haematology 1990 Guidelines on oral anticoagulation, 2nd edn.* J. Clin Pathol 1990.
3. Guidelines for thromboplastins and plasma used to control oral anticoagulant therapy. In: *WHO Expert Committee on Biological Standardization. Forty-Eighth Report. Annex 3. WHO Technical Report Series, no. 889.* Geneva: World Health Organization, 1999.
4. Leaning KE, Ansell JE. *Advances in the monitoring of oral anticoagulation: point-of-care testing, patient self-monitoring, and patient self-management.* J. Thromb Thrombolysis 1996.
5. Poller L., Barrowcliffe TW., van den Besselaar AMHP, Jespersen J., Tripodi A., Houghton D. *The European Concerted Action on Anti-coagulation (ECAA) evaluation of a set of lyophilized normal plasmas to establish the normal prothrombin time for coagulometer systems.* Thromb Haemost 1998.
6. Poller L., Thomson JM, Taberner DA. *Effect of automation on the prothrombin time test in NEQAS surveys.* J. Clin Pathol 1989.
7. Poller L. *A simplified method for international normalised ratio (INR) derivation based on the prothrombin time/INR line - an international study.* Clin Chem 2010.
8. Poller L. *The prothrombin time/international normalized ratio (PT/INR) Line: derivation of local INR with commercial thromboplastins and coagulometers - two independent studies.* J Thromb Haemost 2011.
9. Poller L. *International Normalized Ratios (INR): the first 20 years.* J Thromb Haemost 2004
10. Quick AJ. *The prothrombin in hemophilia and in obstructive jaundice.* J. Biol Chem 1935.

## SUMMARY

Coagulation is a complex process which requires thorough studying to understand the full spectrum of blood clotting disorders affecting a large number of patients. The study of the coagulation cascade is even more important in patients treated with anticoagulants like Warfarin, Sintrom and similar medications. WHO 's scheme for local standardization of the prothrombin time ( PT ) has limited application in many laboratories due to strict demands requiring specialized workforce laboratory network. However, this study has laid the foundation of the experimental framework which encompasses the calibration of thromboplastin and standardization of prothrombin time using plasma pool from Albanian population.

Plasma with sodium citrate was collected from 36 patients and the samples were analyzed in parallel fashion by using both reagents, Cypress Diagnostcis, and standard thromboplastin solution calibrated and produced according to WHO. Plasma from 18 healthy patients with no history of blood clotting disorders were used to calculate the MNPT( *Mean Normal Prothrombin Time* ). Data collected from the entire experiment was plotted and analyzed by using simple linear regression to generate the best fit line of the form  $y=mx+b$  and least square statistics. The slope of the line ( $m$ ) equals the ISI( *International Sensitivity Index*) of the thromboplastin solution marketed as Cypress Diagnostics..

Careful analysis, clearly shows important discrepancies between Cypress Diagnostics values of MNPT and ISI as provided in the insert accompanying the reagent and practical values generated using plasma pool from Albanian population. Also, correlation statistics, as provided by least square value, indicates questionable analytical performance of tested thromboplastin solution as compared to WHO standardized solution. The actual

values of ISI are at the upper borderline of what is today accepted as the optimal range of performance in many laboratories worldwide. This being the case, it appears that Cypress Diagnostics reagent has the tendency to overestimate the INR values of patient under oral therapy of anticoagulants.

The entire set of experimental data indicates that is necessary to carry out standardization of PT/INR at the local level by using population specific plasma pool. Furthermore, local verification of ISI values add more to the clinical accuracy and credibility of INR results reported by labs

# KORRELACIONI ME IgE-TOTALE DHE EOZINOFILISË NË SËMUNDJET ALERGIKE

**Msc. Alketa Bakiri**<sup>1,2</sup>, **Dr. Alma Barbullushi**<sup>1,3</sup>,  
**Xhevahire Gaxha**<sup>1</sup>, **Dr. Ervin Mingomataj**<sup>3,4</sup>

## ABSTRAKT

**Hyrje:** Sëmundjet alergjike janë ndër sëmundjet më të shpeshta që trajton mjeku në praktikën e përditshme (rreth 9% të aktivitetit ambulator). Nga të dhënat statistikore vërehet një rritje e numrit të rasteve të reja për çdo vit.

Qëllimi i kësaj teme është të njihemi me rolin e ekzaminimeve për sëmundjet alergjike me qëllim diagnostikimin dhe trajtimin e tyre.

### ***Materiale dhe metoda:***

U morën në studim pacientët me moshë nga 0- 60 vjeç, të të dyja gjinive të paraqitur gjatë periudhës maj-qershor 2015, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalit “Hygeia”.

Për çdo pacient u vlerësua numri i leukociteve në përqindje nëpërmjet ekzaminimit të gjakut periferik dhe aparaturave si cell counter dhe IgE-ve totale serike.

- 
1. Universiteti Logos, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, Departamenti i Teknikëve të Lartë të Laboratorëve Mjekësorë
  2. Hygeia Hospital
  3. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Departamenti i Alergologjisë dhe Imunologjisë Klinike, Tirana, Albania
  4. Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Infermierisë, Tirana, Albania

Pas mbledhjes së të dhënave moshë, gjini, leukocite, eozinofile, IgE-të totale respektive për çdo pacient u ndërtuan tabelat përmbledhëse dhe u përpunuan rezultatet.

**Rezultate:** Moshë mesatare e pacientëve të marrë në studim ishte  $28.8 \pm 3.3$  (SE). Vlera mesatare e përqindjes së eozinofileve në grupin e pacientëve të marrë në studim ishte  $5 \pm 0.8\%$ , ndërsa vlera mesatare e matur në këta pacientë e IgE-ve totale ishte  $243 \text{ IU/ml} \pm 55$ . Koeficienti i korrelacionit mes vlerave të pranisë së eozinofileve në gjak dhe IgE-ve totale serike rezultoi 0.16.

Diskutim: Sipas studimeve të ndryshme prevalenca e sëmundjeve alergjike rezulton 5-20 %, ndërsa në studimin tonë subjektet me eozinofili dhe IgE totale të larta përbënin 35% të adultëve. Natyrisht kjo mund të shpjegohet dhe me praninë e patologjive të tjera te këta pacientë, siç janë parazitozat, apo nxjerr gjithashtu nevojën e kryerjes së studimeve në popullata më të gjera. (mendoj që diskutimi të hiqet nga abstrakti të mbahet vetëm në fund të artikullit. Këtu të qëndrojnë vetëm konkluzionet).

**Konkluzione:** Në pacientët e marrë në studim u vërejt një lidhje e lehtë mes rritjes së nivelit të eozinofileve në gjak dhe rritjes së nivelit të IgE-ve totale. Në të gjithë pacientët adultë me eozinofili u vërejt një rritje e IgE-ve totale. Rritja e eozinofileve dhe e IgE-ve totale ishte më e shprehur te femrat. Këto të dhëna mund të shërbejnë si indikatorë të pranisë së sëmundjeve alergjike tek pacientët e ekzaminuar.

## I. Hyrje

**D**ihet tashmë që prevalenca e sëmundjeve alergjike po rritet në mënyrë dramatike nga viti në vit në të gjithë botën<sup>1,4,7</sup>.

Studimet e kryera në 1960 dhe 1970 treguan se reaksionet alergjike ndërmjetësoheshin nga imunoglobulina IgE dhe eozinofilet. Lidhja e IgE në sipërfaqe të bazofileve dhe mastociteve inicion një kaskadë aktivizimi dhe çlirimi mediatorësh qelizore.

Eozinofili i përshkruar për herë të parë nga Paul Ehrlich në 1879 është një granulocit prominent në astma, rinitin alergjik, infeksionet parazitare helmintike, neoplazi etj. Faktorë nxitës të diferencimit dhe të rritjes së jetëgjatësisë janë IL3, GM-CSF, apo dhe IL5.

Përqindja e tyre në gjakun periferik në një subjekt normal është më pak se 5%<sup>12</sup>. Rritja e numrit të eozinofileve quhet eozinofili<sup>3,5</sup>. Eozinofilia klasifikohet në disa forma, e lehtë (500 në 1500 eozinofile/μL), e mesme (1500 në 5000 eozinofile/μL) dhe e rëndë (mbi 5000 eozinofile/μL) duke ju referuar numrit absolut të tyre në gjak për mm<sup>3</sup>.

### **Testet e diagnostikimit të sëmundjeve alergjike:**

Vlerat e IgE-specifike mund të maten me anë të dy testeve të cilat kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre.

Testet e lëkurës, skin prick test (SPT):

- Kanë sensitivitet më të lartë.
- Përmbajnë një numër të madh alergenësh.
- Japin rezultate të menjëhershme.
- Kërkojnë më pak kohë.
- Kushtojnë më pak.

### **Testet imunologjike ( imunoenzimologjike):**

- Nuk përbëjnë risk për reaksione alergjike te pacientët.
- Rezultatet nuk ndikohen nga medikamentet.
- Rezultatet nuk ndikohen nga gjendja e lëkurës.
- Janë më komode për pacientin.
- Janë më të përshtatshëm për fëmijët.
- Dokumentohen më lehtë rezultatet dhe cilësia.

### **Testet in Vivo në sëmundjet alergjike**

Janë teste të kryera direkt në lëkurë, ato janë më pak të kushtueshme dhe kanë specifitet të lartë. Në testet kutane, vendosen alergenë në lëkurë dhe realizohet penetrimi i alergjenit përmes lancetës. Testi lexohet pas 15 minutash. Përqendrimi antigjenik i përdorur është i vogël ndaj dhe përgjigjja anafilaktike është e reduktuar.

### **Imunoglobulina E-totale**

Përfaqëson vlerën totale të IgE në një moment të dhënë.

Matja e IgE-totale si një test në diagnostikimin e sëmundjeve alergjike ka pak vlerë, pasi vlerat normale të saj kanë një diapazon të gjerë, por vlerat e saj të larta janë të lidhura ngushtë me një probabilitet të rritur për astma bronkiale. Megjithatë vlerat e IgE-totale në serum mund të rriten edhe jashtë spektrit të sëmundjeve alergjike (jo atopike).

### **Imunoglobulina E-specifike**

IgE-specifike janë imunoglobulina E të prodhuara nga limfociti B, nga kontakti i sistemit imun me një alergjen specifik në një moment të dhënë. Këto antitropa quhen specifike pasi sulmojnë në mënyrë konkrete dhe specifike vetëm atë alergjen që nxiti prodhimin e kësaj popullate IgE<sup>2</sup>.

## **2. Qëllimi dhe Objektivat**

Meqenëse disa nga mediatorët kryesorë, pjesëmarrës në sëmundjet alergjike, çlirohen prej eozinofileve, atëherë qëllimi i këtij studimi është vleresimi i numrit të eozinofileve në pacientet e moshave të ndryshme në gjakun periferik. Objektivat tjetër është të shihet nëse ka korrelacioni mes eozinofilisë dhe rritjes së IgE-ve totale në adultë dhe fëmijë për të vlerësuar përfshirjen e këtyre komponenteve në subjektet atopike.

Gjithashtu do të vlerësohen lidhja mes moshës dhe rritjes së markuesve të patologjive me natyrë alergjike siç janë IgE-të dhe eozinofilet dhe nëse ka lidhje mes gjinisë dhe rritjes së markuesve të sëmundjeve alergjike.

## **3. Materiale dhe metoda**

### **Mbledhja e të dhënave**

U morën në studim pacientët me moshë nga 0- 60 vjeç, të të dyja gjinive të paraqitur gjatë periudhës maj-qershor 2015, pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” dhe Spitalit “Hygeia”.

Për çdo pacient u vlerësua numri dhe përqindja i leukociteve nëpërmjet ekzaminimit të gjakut periferik dhe aparaturave si cell counter dhe IgE-ve totale respektive. U ndërtuan tabelat përmbledhëse dhe grafikët dhe u përpunuan rezultatet.

### **Përpunimi statistikor**

Të dhënat e përfutuara janë paraqitur gjatë studimit si vlera në përqindje apo si vlera mesatare, kurse krahasimet u kryen me testin **t** për korrelacionin dhe MS Office Excel 2007. Vlerat mesatare janë paraqitur  $\pm$  SE. Gjithashtu për krahasimin e rezultateve u përdor testi **t** i studentit sipas [www.socscistatistics.com/tests](http://www.socscistatistics.com/tests). Ndryshimi u konsiderua i rëndësishëm për vlera të  $p < 0.05$ .

### **Materialet dhe metodat laboratorike**

Materialet:

Ngjyrues Gimsa Romanovski, alkool 70 %, alkool metilik, lama, tuba me EDTA, garzë sterile. Aparatura si: cell counter, ImmunoCAP dhe reagentet përkatës.

Metodologjia:

Pasi pastrohet lëkura me alkool 70 %, merret gjaku nga pacienti përmes një flebotomie. Ky do të përdoret për një sërë procedurash të cilat përshkruhen në vijim.

### **Hemograma (analiza e gjakut komplet) nëpërmjet cell counter**

Përmes numëruesve elektronik është thjeshtuar mjaft kryerja e kësaj analize. Cell counter përmban 3 solucione: 1. lizuesin që shkatërron rruazat e kuqe dhe kështu mund të vlerësohen leukocitet 2. izotonikun - mundëson përcaktimin numerik të rruazave të kuqe 3. pastruesin.

Gjatë studimit u përdor cell counter me 18 parametra, vlerësimi i formulës leukocitare konsistente në 3 popullata (limfocite, monocite, granulocite). Si kampion u përdor gjak venoz i vendosur në tuba me antikoagulantë EDTA.

Për përcaktimin e numrit të eozinofileve, meqënëse metoda elektronike nuk na e siguronte këtë parametër u përdor metoda klasike<sup>16</sup>.



### **Teknika e përgatitjes së strishos së gjakut**

Lama vendoset mbi një sipërfaqe të sheshtë pasi mbi të është vendosur pika e gjakut. Një lamë tjetër vendoset mbi të parën në një kënd 30°. Kjo shërben për përhapjen e pikës së gjakut. Kur gjaku shpërndahet në 2/3 e gjerësisë, bëhet hapja e gjakut duke shtyrë lamën përpara në mënyrë uniforme. Duhet që gjaku, duke ju drejtuar fundit të lamës të jetë i hollë si bisht dallëndysheje.

### **Ngjyrimi i strishove me metodën Giemsa – Romanovski**

Romanovski e përdori për herë të parë këtë teknikë ngjyrosjeje në vitin 1881, për këtë arsye quhet dhe ngjyrimi sipas tij. Ishte një përzierje ngjyruesh me natyrë acide dhe bazike si blumetileni dhe eozina. Përmes ngjyritimit dallohen elementët e ndryshëm të figuruar të gjakut nga njëri-tjetri.

Elementët e identifikueshem do të ishin granularë si: shkop, segment, eozinofil, bazofil dhe jogranularë si monocite dhe limfocite. Pasi janë numëruar 100 elemente atëherë mund të nxjerrim vlerat në përqindje të leukociteve, siç janë vlerësuar gjatë leximit.


*Protokolli:* Për leximin përdoret mikroskop me dritë me kontrast faze, identifikohen fushat më të pastra me okularin 10x, ndërsa identifikimi i elementëve bëhet me 100x, duke përdorur vaj cedri për të realizuar kontaktin e lamës me mikroskopin. Eozinofilet dhe leukocitet e tjerë lexohen duke lëvizur fushën majtas dhe poshtë ose djathtas dhe lart duke mbajtur një kah leximi. Pra leximi bëhet në mënyrë zigzage për të evituar kontaktin e të njëjtit element<sup>16</sup>.

Në vijim marrim gjakun e pacientit dhe e centrifugojmë atë për të përftuar serumin. Për nivelin e IgE totale janë përdorur metoda imunoenzimologjike, të cilat do të përshkruhen në vijim<sup>17</sup>.

### **Testet in Vitro: IgE totale**

Këto teste masin si IgE totale ashtu edhe IgE-antigjen-specifike. Këto teste kanë sensitivitet më të ulët se testet in vivo por janë më pak traumatike. Testi i parë që vlerësonte nga ana sasiore IgE totale ishte radioimunosorbenti konkurrues ( RIST ). Testi ndërmjetësohej nga IgE të lidhur me shënues radioaktive që konkurronin me IgE - të e pacientit gjatë fazës solide, për të njëjtat vende lidhjeje. Shumë shpejt u zëvendësua ky ekzaminim me teste jo-

konkurruese duke parë vështirësitë gjatë punës me radioaktivitetin. Në metodat e dozimit të këtij antitropi, IgE-antihumane është e lidhur me fazën solide në një disk letre ose celulozë, më pas shtohet serumi i pacientit. Një anti IgE e markuar (një enzimë fluoeshente) shtohet për të dedektuar IgE e pacientit, të lidhur tashmë. IgE fluoeshente ka vend lidhjeje (epitop) të ndryshëm nga anti-IgE e parë. Në fund do të matet fluoeshenca, e cila është proporcionale me përqendrimin e IgE-ve që ndodhen në serum in e pacientit (Fig. 1).



**Fig.1** Dozimi i IgE-ve totale

**Interpretimi i rezultateve të IgE totale**

Vlerat normale të IgE totale variojnë nga laboratoritë në laboratoritë:

P.sh vlerat normale të IgE-ve totale në disa laboratorë vlerësohen si vijojnë:

1) te të rriturit <158 IU/ml

2) te fëmijët <1 vjeç 1.4-52.3 IU/ml

3) te fëmijët 1-4 vjeç 0.4-351.6 IU/ml

4) te fëmijët 5-10 vjeç 0.5-393 IU/ml

5) te fëmijët 11-15 vjeç 1.9-170 IU/ml

Pra nëse te adultët vlerat rriten mbi 100 kU/L atëherë mund të mendohet se kemi të bëjmë me sëmundje alergjike.

#### 4. Rezultatet

Në studim u përfshinë gjithsej 24 pacientë dhe pas ekzaminimeve të kryera u morën këto rezultate, në lidhje me nivelin e IgE –ve totale dhe përqendrimin e eozinofileve (tabela 1).

Mosha vjeç	Meshkuj	Femra	Eos %	Mono %	Limf %	Neutr %	Baso %	IgE IU/ml
32	1	0	1%	13%	21%	65%	0%	43
56	0	1	2%	5%	39%	54%	0%	62
42	1	0	6%	14%	39%	42%	1%	236
12	0	1	8%	4%	35%	53%	0%	377.2
48	1	0	3%	11%	51%	35%	0%	80
45	0	1	6%	8%	35%	50%	0%	602
40	1	0	4%	6%	22%	68%	0%	110
1	0	1	2%	4%	47%	47%	0%	15.7
27	1	0	1%	4%	42%	52%	1%	72.1
55	1	0	2%	12%	51%	35%	0%	24.3
22	0	1	8%	8%	36%	48%	0%	162
37	0	1	12%	11%	25%	53%	0%	172
40	1	0	2%	9%	24%	62%	1%	121
20	1	0	3%	5%	48%	43%	1%	30.1
2	1	0	3%	8%	51%	38%	0%	596
28	0	1	15%	6%	44%	35%	0%	112
8	1	0	4%	5%	39%	52%	0%	135
28	0	1	15%	7%	31%	49%	1%	619
2	1	0	2%	8%	43%	47%	0%	973
11	1	0	6%	7%	35%	52%	0%	306
40	1	0	1%	3%	9%	89%	0%	68.7
30	0	1	1%	7%	35%	57%	0%	68.7
34	0	1	2%	6%	36%	55%	1%	763
31	0	1	4%	5%	24%	66%	1%	94.6

**Tabela 1.** Të dhënat e pacientëve

Mosha mesatare e pacientëve të marrë në studim ishte  $28.8 \pm 3.3$  (SE). Vlera mesatare e përqindjes së eozinofileve në grupin e pacientëve të marrë në studim ishte  $5 \pm 0.8\%$ , ndërsa vlera mesatare e matur në këta pacientë e IgE-ve totale ishte  $243\text{IU/ml} \pm 55$ .

Vlerat e koeficientëve të korrelacionit mes pranisë në përqindje të eozinofileve dhe qelizave të tjera të gjakut për pacientët e marrë në studim paraqiten si vijojnë (tabela 2):

Eos/Mon	Eos/Lim	Eos/Neut	Eos/Ba	<b>Eos/IgE</b>	Ba/IgE	Mo/IgE
0.066733	-0.03321	-0.296	0.000934	<b>0.1688103</b>	0.0809436	0.0198319

**Tabela 2.** Koeficientet e korrelacionit


Pra në popullatën e marrë në studim vërehet një lidhje e lehtë, apo një korrelacion i lehtë mes rritjes së numrit të eozinofileve dhe të IgE-ve totale në gjithë popullatën e pacientëve të marrë në studim.

Te pacientët që i përkasin gjinisë femërore, mosha mesatare e pacientëve ishte  $29.4 \pm 4.4$ , vlera mesatare e eozinofileve në gjakun periferik ishte  $7\% \pm 0.01$ , ndërsa vlera mesatare e IgE-ve totale ishte sipas studimit  $277\text{IU/ML} \pm 80.4$ .

Koeficienti i korrelacionit mes pranisë së eozinofileve në përqindje dhe vlerave të IgE-ve totale ishte 0.16, vlerë kjo që dëshmon për një lidhje të lehtë mes rritjes së numrit të eozinofileve dhe IgE-ve totale në pacientet femra.


Tek pacientet që i përkasin gjinisë mashkullore, mosha mesatare e pacientëve ishte  $28.2 \pm 4.6$ , vlera mesatare e pranisë së eozinofileve në gjakun periferik ishte më e ulët -  $3\% \pm 0.004$  ( $p < 0.02$ ), ndërsa vlera mesatare e IgE-ve totale ishte po ashtu më e ulët se te femrat -  $215\text{IU/ML} \pm 71$  (n.s.).

Në qoftë se do t'i referohemi vlerave të IgE-ve totale dhe përqindjes së eozinofileve të gjetura në pacientët si tregues të mundshëm të sëmundjeve alergjike atëherë mund të themi se këto patologji me natyrë atopike janë më të shpeshta te femrat (Grafiku 1).



**Grafiku1.** Përqindja e qelizave në gjakun periferik në pacientët meshkuj dhe femra

Po kështu në grupet meshkuj/femra të pacientëve të marrë në studim vërehet që vlerat e IgE-ve totale janë më të larta në subjektet femra. Ashtu sikurse u përmend dhe më lart vlerat e IgE-ve totale rriten në pacientët me sëmundje atopike, kështu që vlerat e rritura të këtyre antitropave te femrat, janë treguese të shpeshtësisë më të lartë të këtyre sëmundjeve në këtë gjini, e cila pasqyrohet në grafikun në vijim (Grafiku 2).




**Grafiku 2.** Përqindja e IgE-ve totale në pacientët femra dhe meshkuj

Po kështu nga studimi u vlerësua që të 7-të pacientët adultë që paraqiteshin me eozinofili kishin dhe IgE totale të larta.

Duke ju referuar sërish studimit: në pacientët adultë nga 9 subjekte me IgE të larta, 7 prej tyre kishin eozinofili.


Të gjitha këto rezultate flasin për mundësinë e bashkëpranisë së vlerave të rritura të IgE-ve totale dhe eozinofileve në subjektet me sëmundje alergjike, por që natyrisht nuk përjashtohet të vërehet dhe në individët e prekur nga infeksione parazitare.

Sipas këtij studimi, duke ju referuar gjithmonë përqindjes së eozinofileve në subjektet e marrë në studim dhe vlerave të IgE-ve totale, një përqindje e vogël e individëve preken nga sëmundjet alergjike. Por natyrisht në Shqipëri si dhe në shumë vende të tjera në ndryshim vërehet tendenca për tu rritur numri i këtyre patologjive nga viti në vit <sup>6,7</sup>.



**Grafiku 3.** Pacientët me probabilitet për patologji alergjike

Ndër 5 fëmijët e marrë në studim u vërejt se veç një prej tyre kishte eozinofili, dhe po ky pacient rezultoi të kishte dhe IgE totale të larta. Pra përsëri nëse ju referohemi treguesve: përqindje eozinofileshe e vlera të rritura të IgE-ve totale të fëmijët e marrë në studim rezultojnë se 20% e tyre mund të jenë të prekur nga sëmundje alergjike (Grafiku 4).



**Grafiku 4.** Fëmijët me eozinofili dhe IgE të larta, probabël me sëmundje alergjike

## 5. Diskutim

Nëse niveli i IgE-ve totale është minimal, atëherë kjo vlerë shumë e vogël e IgE-ve totale mund të përjashtojë praninë e sëmundjeve alergjike. Është e rëndësishme të theksohet që vlera të larta të IgE-ve totale mund të jenë treguese dhe për vlera të larta të IgE-ve specifike, por jo gjithmonë vlerat e larta të IgE-ve specifike të drejtuara ndaj një alergjeni të caktuar e aq më pak ato të IgE-ve totale kanë vlerë klinike domethënëse për sëmundje alergjike.

Prania e reaksioneve të kryqëzuara të IgE-ve me alergenët, të përcaktuesve antigjenike të përbërë nga karbohidrate që gjenden në to, jo gjithmonë korrelojnë me manifestime klinike respiratore apo alergji ushqimore. Kështu shpeshherë për diagnostikimin e tipit të I të mbindjeshmërisë na vjen në ndihmë historia klinike dhe testet kutane in vivo.

Edhe pse rritja e vlerave të IgE-ve totale te adultët mbi 100IU/ML sugjeron për sëmundje alergjike, vlerësimi i IgE-ve totale nuk është parametri i vetëm dhe i duhur për përcaktimin e këtyre patologjive.

Sipas literaturës vërehet një variacion i madh i vlerave normale të IgE-ve totale dhe atyre domethënëse për patologji, aq më tepër që këto vlera ndryshojnë edhe me moshë.

Një nivel i rritur i IgE-ve zakonisht shoqërohet me atopi apo dispozitë atopike. Pacientët me IgE ndaj alergenëve inhalatorë zakonisht kanë nivele të larta të IgE-ve totale, veçanërisht nëse flitet për alergji ushqimore. Vetëm alergjia ushqimore në mungesë të sensibilizimit ndaj alergenëve inhalatorë rezulton në një vlerë lehtësisht ose pak të rritur të IgE-ve totale.

Nivelet e IgE-ve rriten gjithashtu dhe në infeksione parazitare. Përveç kësaj sëmundje të caktuara autoimune si Churg Strauss, pemfigus, sklerodermia rezultojnë me vlera të larta të IgE-ve. Po kështu në sindromat hipereozinofilike ku bëjnë pjesë mielomat, sindroma Wiskott-Aldrich, di George, Nezelef mund të rriten vlerat e IgE-ve totale.

Sipas studimeve të ndryshme prevalenca e sëmundjeve alergjike rezulton <5 % deri mbi 20 % për astmën bronkiale në Evropë. Ndërsa në studimin tonë subjektet me eozinofili dhe IgE totale të larta përbënin 35% të adultëve (Grafiku 3) dhe vlerat mesatare të IgE-ve ishin 243IU/ML. Kjo mund të shpjegohet dhe me praninë e patologjive të tjera te këta pacientë, siç janë parazitizat, apo nxjerr gjithashtu nevojën e kryerjes së studimeve në popullata më të gjera.

Sipas studimeve të tjera rezulton që prekja e individëve në bazë të gjinisë dhe konkretisht e meshkujve vërehet më tepër gjatë fëmijërisë, më pas të dyja gjinitë kanë probabilitet të njëjtë për t'u prekur nga këto patologji. Ndoshta ndjekja e subjekteve në vijim dhe thellimi i studimit në vitet pasues mund të hedhë dritë mbi këtë çështje<sup>15</sup>.

Por natyrisht meqenëse prevalenca e sëmundjeve alergjike po rritet ndjeshëm dhe kryesisht te të rinjtë dhe fëmijët, ato duhen vlerësuar e diagnostikuar me kujdes të veçantë, për ti hapur rrugë më pas terapive të reja p.sh me antitropa anti IgE apo omalizumab.



## 6. Konkluzione

Sipas studimit u vërejt një lidhje e lehtë në pacientët e marrë në studim mes rritjes së nivelit të eozinofileve dhe rritjes së nivelit të IgE-ve totale.

Në të gjithë pacientët adultë me eozinofili u vërejt një rritje e IgE-ve totale.

Rritja e eozinofileve dhe e IgE-ve totale ishte më e shprehur te femrat. Këto të dhëna mund të shërbejnë si indikatorë të pranisë së sëmundjeve alergjike tek kjo gjini.

Sipas studimit një përqindje e vogël adultësh rezultuan në bazë të ekzaminimeve me eozinofili dhe IgE totale të larta. Duke u mbështetur në këto të dhëna rezulton që një numër i kufizuar pacientësh të marrë në studim mund të paraqesin sëmundje alergjike.

Një përqindje e vogël e fëmijëve në bazë të ekzaminimeve patën eozinofili dhe rritje të vlerave të IgE-ve totale, pra përsëri rezulton që një numër i vogël fëmijësh probablisht mund të jenë prekur nga sëmundjet alergjike.

Po kështu të gjithë fëmijët tek të cilët vërehej rritje e numrit të eozinofileve në gjakun periferik ndeshje gjithashtu dhe rritje të vlerave të IgE-ve totale.

Sigurisht që përfshirja e një numri më të madh subjektsh në studim, apo dhe vlerësimi i eozinofilisë jo vetëm në gjakun periferik, por edhe në sekrecionet nazale dhe sputum, do të na jepte të dhëna më të plota për pacientët, por dhe për vlerësimin real të pranisë së eozinofileve.

Të dhënat klinike do të shërbenin gjithashtu në diagnostikimin e saktë të tyre, por natyrisht që studimi mund të thellohet në drejtim të aspekteve të përmendura më sipër në të ardhmen.

## BIBLIOGRAFIA

1. Langen U., Schmitz R., Steppuhn H. Prevalence of allergic diseases in Germany. Results of the German Health Interview and Examination Survey for Adults, Department of Epidemiology and Health Monitoring, Robert Koch Institute, Berlin.

2. *Middleton's Allergy* 7<sup>th</sup> edition Principles&Practice p. 295 - 307, 455 - 460, 545 - 851.

3. Priftanji A. *Alergologjia*, Shblu 2005, f. 2 - 6, 15.
4. Wüthrich B. Epidemiology of the allergic diseases: are they really on the increase? *Int Arch Allergy Appl Immunol*. 1989;90 Suppl 1:3-10.
5. Çeka Xh. *Histologjia*. Albpaper, Tiranë 2002, f. 90.
6. Mingomataj E., Bakiri A., Mingomataj D. The magic eosinophil: a breaker of biological barriers. In Walsh GM. *Eosinophils: structure, Biological properties and role in Disease*, Nova Science Publishers Inc. 2012; chapter 14, p. 221-256.
7. Mingomataj E. The changing world as principal reason for atopy rising trend. *Internet J Asthma, Allergol Immunol* 2007; 5: 2.
8. Mingomataj E. Eosinophil-induced prognosis improvement of solid tumors could be enabled by their vesicle-mediated barrier permeability induction. *Med Hypotheses* 2008; 70: 582-4.
9. Khoury P., Grayson P., Klion A. Eosinophils in vasculitis: characteristics and roles in pathogenesis. *Nature Reviews Rheumatology*, August 2014, Volume 10, No 8.
10. Leick E., Prado C, Milton A. Eosinophilic inflammation in allergic asthma. *Front. Pharmacol.*, 17 April 2013.
11. Hogan S., Rosenberg H, Moobel R, Phipps S, Foster P, Lacy P, et al. Eosinophils: Biological properties and role in health and disease. *Clinical and experimental allergy* 2008 Blackwell Publishing Ltd, p 1-42.
12. Weller P, Klion A. Approach to the patient with unexplained eosinophilia. *Wolters Kluwer Health Clinical Solutions*. Up to date 2015.
13. Hogan SP, Rosenberg HF, Moqbel R., Phipps S., Foster PS, Lacy P., Kay AB, Rothenberg ME. Eosinophils: biological properties and role in health and disease. *Clin Exp Allergy*. 2008 May; 38(5):709-750.
14. Greer J. et al. *Wintrobe's Clinical Hematology*. Lacy P. Thirteenth edition 2014 The human eosinophil. Chapter 8. 160-181.
15. Grammer L, Greenberger P. *Patterson's Allergic Diseases* 7<sup>th</sup> Edition 2009. Allergic rhinitis. Chapter 26. 467-500.

16. Goxharaj A., Liçaj S., Dhana B. Praktikum i biokimisë, hematologjisë dhe mikrobiologjisë mjekësore. Hemograma (analiza e gjakut komplet). Kapitulli VII. f. 88 -92.

17. Charlotte Wirl, Prevalences of asthma and allergy in children. European Environment and Health information system. WHO May 2007.

18. Sulcebe G. *Imunologjia*. Teknikat që përdorin shënues. Kapitulli 35. Tiranë 2005, p. 243-255.

## SUMMARY

In this study we evaluated eosinophilia in periferic blood in children and adults. Patients enrolled in the study were 1 to 60 year old and the study period comprised two months May and June 2015.

Data from 24 patients were analyzed: 11 of which were females and 13 males. The medium age of the patients was  $28.8 \pm 3.2$  SE.

The range of the percentage of eosinofiles in periferic blood was 1 to 15%, the medium range was 5%. In 9 of 23 subjects the percentage of eosinophils exceeded 5%.

In 13 of 23 patients the levels of IgE were above 100IU/ML. The mean value of the total IgE level in serum of these individuals was  $243\text{IU} / \text{ml} \pm 54.6$  SE.

So the study revealed that 39% of individuals had eosinophilia and increased serum levels of IgE. High total IgE serum level was found to be associated with female gender. In a study, a slight positive correlation between total IgE serum levels and total blood eosinophil counts was observed.

Concluding we can say that the eosinophilia and raised serum IgE levels are important indicators of such pathologies like allergic rhinitis, asthma, parasitic infections, etc.

Obviously other data and further studies are needed to shed light on inflammatory pathologies and their markers.

# DIFERENCA MES TESTIMIT TË GLICEMISË NË LABORATOR DHE TESTIMIT ME GLUKOMETËR

**Msc. Blerina Resulaj<sup>1</sup>, Rigerta Veseli<sup>2</sup>, Msc. Ariol Rama<sup>1</sup>.**

## ABSTRAKT

*Hyrje:* Testet ekstralaboratorike bëjnë të mundur testimin dhe monitorimin e disa sëmundjeve apo gjendjeve shëndetësore përtej laboratorit. Saktësia e këtyre testeve është e variueshme, por gjithsesi e rregulluar nga DTS duke përdorur udhëzimet e lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) 15197:2013. Standardi ISO kërkon që për vlerat e glicemisë  $>/ 75 \text{ mg/dl}$ , 95% e rezultateve nga glukometri të jenë brenda  $\pm 15\%$  të vlerës së matur në laborator.

*Qëllimi i Studimit:* Matja e glukozës me dy mënyra: spektrofotometër dhe glukometër, për të parë nëse ka ndryshime midis këtyre metodave, pra nëse rezultatet e marra nga glukometri bien brenda  $\pm 15\%$  të vlerës së vërtetë.

*Materiale dhe Metoda:* Janë realizuar matjet e vlerës së glicemisë me dy metoda, spektrofotometrin Humalyzer Primus dhe glukometër OneTouch përkatësisht duke përdorur si kampione

---

<sup>1</sup> Departamenti Teknik i Iartë Labororë Mjekësorë, Shkolla e Iartë Private "Logos",

<sup>2</sup> Studente Shkolla e Iartë Private "Logos"

gjakun venoz dhe atë kapilar. Mostra e gjakut dhe të gjitha analizat janë kryer në ambientet e SHLP Logos.

*Rezultate* :Në studimin tonë u vu re një ndryshim mes rezultateve të matura me glukometër dhe atyre të matura me spektrofotometër. Por duke qenë se vlera e  $p$  rezulton  $> 0.05$  do të thotë se ndryshimi i gjetur midis dy metodave nuk është i rëndësishëm nga ana statistikore.

*Konkluzione*: Testet ekstralaboratorike janë kosto-efektive, të shpejta dhe konfidenciale. Është e rëndësishme që personat e interesuar (individët me diabet) të dinë të kryejnë mirë procedurën për të shmangur sa më shumë gabimet e mundshme. Sipas studimit tonë, nuk ka ndryshime statistikisht të rëndësishme midis vlerës së glicemisë së matur me glukometër dhe asaj laboratorike. Ka raste në të cilat si pasojë e mos respektimit të kushteve higjieno-sanitare dhe të ruajtjes të setit të aparatit, mund të rezultojnë vlera të gabuara, të cilat shmangen gjithnjë e më tepër me respektimin e protokollit të punës hap pas hapi.

## 1. Hyrje

**T**estet ekstralaboratorike bëjnë të mundur testimin dhe monitorimin e disa sëmundjeve apo gjendjeve shëndetësore përtej laboratorit. Ato janë kosto-efektive, të shpejta dhe konfidenciale.

Diabeti mellitus është shndërruar në një prej sëmundjeve më shqetësuese në të gjithë botën veçanërisht vitet të fundit. Për personin me diabet, monitorimi i glukozës në gjak jep feedback të menjëhershëm mbi efektet e aktiviteteve të përditshme të tilla si marrja e medikamenteve, aktiviteti fizik ose ushqyerja, në nivelet e glukozës në gjak.

Monitorimi i glukozës në gjak ndihmon për të vlerësuar kontrollin glicemik dhe veçanërisht identifikimin e hipoglicemisë dhe hiperglicemisë, të cilat lidhen me ndërlikimet afatshkurtra dhe afatgjata të diabetit mellitus. Vetëmonitorimi i glukozës në gjak nga individët me diabet mellitus është një nga mënyrat më efikase për të menaxhuar gjendjen e tyre. Kjo ndihmon në shmangien e

ndërlikimeve të diabetit dhe në kontrollin e efektshmërisë së trajtimit në mbajtjen e nivelit të sheqerit në gjak në parametra normale.

Vetëmonitorimi realizohet përmes një pajisjeje të quajtur glukometër. Sigurisht që saktësia e glukometrit është një temë e zakonshme e shqetësimit të përdoruesve. Pajisjet për matjen e glukozës në gjak (glukometrat) të rregulluara më parë nga Food and Drug Administration (FDA), dhe janë riparë nga “*Diabetes Technology Society*” (DTS) duke përdorur udhëzimet e lëshuara nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO) 15197:2013. Standardi ISO kërkon që për vlerat e glicemisë  $>/ 75 \text{ mg/dl}$ , 95% e rezultateve nga glukometri të jenë brenda  $\pm 15\%$  të vlerës së matur në laborator.

Qëllimi i këtij studimi është matja e glukozës në gjak më dy mënyra: spektrofotometër dhe glukometër, për të parë nëse ka ndryshime midis këtyre metodave, pra nëse rezultatet e marra nga glukometri bien brenda  $\pm 15\%$  të vlerës së vërtetë.

## 2. Materiale dhe metoda

Për realizimin e këtij studimi, janë përdorur kampione gjaku venoz dhe kapilar përkatësisht sipas metodës që nevojitej. Mostrat janë marrë nga studentët e shkollës në ambientet e SHLP Logos. Përzgjedhja e rasteve për studimin ishte rastësore. Asnjë nga individët e përzgjedhur nuk referonte për çrregullime të glukozës në gjak.

Vlerat e matura të glicemisë ishin të rastësishme. Individët nuk iu nënshtruan kushteve të veçanta si privimi i ushqimit, matja e glicemisë esëll apo postprandiale. Në individë të shëndetshëm, nivelet e glukozës nuk ndryshojnë shumë gjatë ditës. Nëse nivelet e glukozës ndryshojnë kjo tregon për një çrregullim të mundshëm.

## Matja e glicemisë kapilare me anë të glukometrit.



**Figura 1.** Glukometër One Touch

Arsyeja pse vetëmonitorimi i glukozës në gjak është kaq efikas është se ofron rezultate të vazhdueshme, mund të përdoren të dhënat që merren nga ky kontroll për të bërë ndryshimet e duhura për mjekimet që po merren, dozën e insulinës, ushqimet që konsumohen në dietën ditore dhe nivelin e aktivitetit fizik.

Një glukometër tipik vjen me shiritat e testimit, pajisjen për shpimin e gishtit, dhe lancetat që janë të sterilizuara.

### *Procedura e punës*

- Në çdo rast të testimit sigurohet që duart të jenë të lara dhe të thara siç duhet.
- Pastrohet zona që do shpohet me alkool.
- Vendi që do të shpohet është maja e gishtit.
- Merret pika e gjakut duke shpuar gishtin.
- Vendoset pika e gjakut në strip testin.
- Ndiqen udhëzimet për vendosjen e strip testit në glukometër.
- Pritet deri sa të shfaqet vlera e glukozës në gjak në ekran.


### **Matja e glicemisë në laborator me anë të spektrofotometrit:**

Përcaktimi i glukozës në gjak përdoret për diagnozën dhe monitorimin e diabetit mellitus dhe çrregullime të tjera të metabolizmit glucidik. Kampioni i

përdorur është gjaku venoz, i cili është centrifuguar me 4500 rrot për 10 min. Më pas kampioni u analizua në spektrofotometrën Humalyzer Primus.

#### *Principi i metodës*

Glukoza transformohet nga glukozë oksidazë (GOD) në acid glukonik dhe peroksid hidrogjeni, i cili, në prani të peroksidazës (POD), reagon me phenolin dhe 4-aminoantipirinë për një kompleks të kuq, intensiteti i të cilit në 505 nm është proporcional me përqëndrimin e glukozës në mostrën e marrë.



#### *Përbërja*

##### **Reagenti A:**

Buffer fosfat ph 7.4	25 g/l
Fenol	<0.9 g/l
4-Aminoantipirine	0.4 mmol/l
GOD	e" 30 kU/l
POD	e" 1 kU/l
NaN3	0.95 g/l

##### **Standardi:**

D-glukozë	1x5 ml
Acid benzoik	100 mg/dl (5.55 mmol/l)

#### *Ruajtja dhe qëndrueshmëria*

Ruajtja bëhet në temperaturën 2-8 °C. Reagentët nuk futen në ngrirje! Reagentët janë të qëndrueshëm deri në datën e skadimit të vendosur në etiketë, nëse shmangen ndotja dhe avullimi dhe ruhen në një vend të mbrojtur nga drita.

#### *Mostra*

Serum, plazmë (EDTA, monojodoacetat).

Qëndrueshmëria:



Temperatura		
15-25 °C		4-8 °C
Serum/plazëm ( pas shtimit të inhibitorëve glikolitik si NaF, KF):	1 ditë	7 ditë

**Tabela 1.**

### *Procedura analitike*

Reagentët duhet të arrijnë temperaturën e punës përpara përdorimit.

	Blank	Standart	Kampion
Reagent A	1000 µl	1000 µl	1000 µl
H <sub>2</sub> O i distiluar	10 µl		
Standart	-	10 µl	-
Kampion	-	-	10 µl

Përzjehen dhe inkubohen për 10 min në 37 °C.  
Lexohet absorbanca e standartit dhe e kampionit në 505 nm kundrejt blankut.  
Ngjyra është e qëndrueshme për 60 min, e mbrojtur nga drita.

### *Vlerat e referencës*

Serum/plazëm

Të rriturit: 70 -110 mg/dl

Të sapolindurit: 20 - 80 mg/dl

Fëmijët < 5 vjeç: vlera 10-15% më të ulëta se te të rriturit

### *Lineariteti*

Analiza është lineare deri në 500 mg/dl (28mmol/l).

### *Ndjeshmëria*

Ndjeshmëria e testit në drejtim të kufirit të zbulimit, është 1 mg/dl (0.05 mmol/l).


## **3. Rezultate**

Matja e glukozës u realizua me dy metoda: spektrofotometër HumanLyzer Primus dhe glukometër One Touch. Vlerat e referencës sipas laboratorit, në të


cilin u kryen matjet janë 70-110 mg/dl. Nga 28 raste të marra në studim u nxorën këto rezultate:

Individët në studim	Vlera e glicemisë në laborator	Vlera me glukometër One Touch	Njësia mg/dl
A.B	121 mg/dl	81 mg/dl	40
F.D	160 mg/dl	99 mg/dl	61
R.H	104 mg/dl	95 mg/dl	9
S.T	106 mg/dl	87 mg/dl	19
P.T	84 mg/dl	88 mg/dl	4
F.L	93 mg/dl	91 mg/dl	2
A.D	92 mg/dl	82 mg/dl	10
M.B	92 mg/dl	69 mg/dl	23
K.L	76 mg/dl	86 mg/dl	10
M.P	87 mg/dl	81 mg/dl	6
B.N	72 mg/dl	89 mg/dl	17
V.J	84 mg/dl	88 mg/dl	4
U.F	123 mg/dl	113 mg/dl	10
D.V	92 mg/dl	89 mg/dl	3
M.G	116 mg/dl	122 mg/dl	6
K.N	82 mg/dl	84 mg/dl	2
S.L	131 mg/dl	124 mg/dl	7
B.T	217 mg/dl	226 mg/dl	9
Z.P	180 mg/dl	196 mg/dl	16
J.M	144 mg/dl	124 mg/dl	20
H.B	178 mg/dl	177 mg/dl	1
M.F	82 mg/dl	78 mg/dl	6
A.L	75 mg/dl	79 mg/dl	4
D.H	83 mg/dl	91 mg/dl	8
N.G	85 mg/dl	87 mg/dl	2
G.L	78 mg/dl	88 mg/dl	10
D.G	81 mg/dl	88 mg/dl	7
S.C	102 mg/dl	105 mg/dl	3

**Tabela 2.** Rezultatet e përqëndrimeve të glukozës në gjak të matura me dy metodat.



**Grafik 1.** Krahasimi i përqendrimeve të glukozës në gjak të matura me dy metodat, me ngjyrë të kuqe janë matjet e realizuara nëpërmjet aparatit OneTouch dhe me ngjyrë blu matjet e kryera në laborator, me spektrofotometrin HumaLyzer Primus.



**Grafik 2.** Paraqitja grafike e vlerave mesatare të glukozës në gjak me dy metodat glukometër, spektrofotometër dhe diferenca midis tyre.

	Spektrofotometër	Glukometër	Diferenca	Vlera e p
Vlera Mesatare	102.86	108.82	11.39	0.06

**Tabela 3.** Ndryshimi në vlerën e glicemisë midis dy metodave.

Si test statistikor për analizën e rezultateve është përdorur t-TEST.

Nëse vlera e p në këtë test rezulton më e vogël ose e barabartë me 0.05 atëherë themi që rezultati i gjetur ka rëndësi statistikore, ose ndryshimi është statistikisht i rëndësishëm.

Në studimin tonë, vlera e p rezulton  $> 0.05$  dhe si e tillë do të thotë se ndryshimi i gjetur midis dy metodave nuk është i rëndësishëm nga ana statistikore.

#### 4. Diskutime

Ky studim është realizuar duke kryer matjet e glicemisë së rastësishme tek 28 persona, me anë të dy metodave të ndryshme.

Vlera e  $p > 0.05$  hedh poshtë hipotezën tonë se ka ndryshim midis saktësisë së metodave. Kjo do të thotë që vlera e matur e glicemisë kapilare është ekuivalente me atë të matur në spektrofotometër. Këto përfundime korrespondojnë me të dhënat e literatures megjithatë duhen marrë parasysh disa kufizime të studimit tone. Së pari, studimi u krye në një popullatë të shëndetshme, e cila paraqet pak a shumë glicemi të qëndrueshme gjatë ditës. Në individët me diabet mellitus ka luhatje të skajshme të vlerave të glicemisë nga hipoglicemi në hiperglicemi të shprehur.

Si rrjedhim, do të duheshin të dhëna të tjera nga kjo popullatë për të arritur në një përfundim.

Së dyti, faktorë të tjerë mund të ndikojnë ndjeshëm në rezultatet e marra nga glukometrat krahasuar me ato të laboratorit, si p.sh.:

- Kur personi nuk lan duart paraprakisht.

- Nëse ka prekur një frut apo një ëmbëlsirë më parë dhe kryen matjen e glicemisë kapilare, vlera do të rezultojë fals pozitiv me rezultat më të lartë.
- Nëse kutia e fishave është lënë për një kohë të gjatë hapur.
- Nëse fishat janë vjetëruara.
- Madhësia dhe cilësia jo e duhur e mostrës së gjakut.
- Glukometër i pakalibruar.
- Pacientët me anemi ose të dehidruar.

Këto raste janë të parashikuara nga prodhuesit e glukometrave, dhe për këtë arsye vendosen në fletën përshkruese të aparatit në mënyrë që të shmangen gabimet.

## 5. Konkluzione

- Testet ekstralaboratorike janë kosto-efektive, të shpejta dhe konfidenciale.
- Është e rëndësishme që personat e interesuar (pacientet diabetike) të dijnë të kryejnë mirë procedurën për të shmangur sa më shumë gabimet e mundshme.
- Sipas studimit tonë, nuk ka ndryshime statistikisht të rëndësishme midis vlerës së glicemisë së matur me glukometrin “One Touch” dhe asaj laboratorike.
- Ka raste në të cilat si pasojë e mos respektimit të kushteve higjieno-sanitare dhe të ruajtjes e konservimit të setit të aparatit, mund të rezultojnë vlera të gabuara, të cilat shmangen gjithnjë e më tepër me respektimin e protokollit të punës hap pas hapi.

## BIBLIOGRAFIA

- [http://www.gdsrl.com/upload/prodotti/ga4575\\_00\\_-\\_glucose\\_0.pdf](http://www.gdsrl.com/upload/prodotti/ga4575_00_-_glucose_0.pdf) Accessed 06.06.2015
- <http://www.cancer.gov/cancertopics/diagnosis-staging/understanding-lab-tests-fact-sheet> Accessed 17.04.2015.
- <http://www.einsten.net/pdf/1350246072.pdf> Accesed: 24.05.2015.

• L.Sharifa Alghamdi, L.Ashwag Bukhari, L.Nesreen Tarabah, L.Nouf Alshereef, L.Bahiya Osrah, and L.Wedam Alghazzawi, *Clinical Biochemistry Lab BIOC 416, 2012.*

• <http://www.southend.nhs.uk/pathology-handbook/test-directory/test-directory-b-index/bone-profile> Accessed 02.05.2015.

• <http://www.fda.gov/MedicalDevices/ProductsandMedicalProcedures/InVitroDiagnostics/HomeUseTests/> Accessed 03.05.2015.

• <https://www.diabeticpick.com/blog/home-blood-pressure-monitor> Accessed 09.05.2015.

• <http://rcnhca.org.uk/clinical-skills/observation/urine-testing> Accessed 15.06.2015.

• <http://www.nursingtimes.net/home/specialisms/cardiology/urine-testing/199377.article> Accessed 17.06.2015.

• <http://www.livestrong.com/article/32490-check-cholesterol-home> Accessed 17.06.2015.

• <http://www.healthline.com/health/pregnancy/tests#Overview> Accessed 23.06.2015.

• <http://theexdiabetics.com/blood-glucose-meters-for-monitoring-diabetes> Accessed 23.06.2015.

• [http://www.gdsrl.com/upload/prodotti/ga4575\\_00\\_glucose\\_0.pdf](http://www.gdsrl.com/upload/prodotti/ga4575_00_glucose_0.pdf) Accessed 06.06.2015.

## SUMMARY

Background: Outside laboratory tests enable testing and monitoring of certain diseases or health conditions beyond the laboratory. The accuracy of these tests is different but still regulated by the DTS, using guidelines issued by the International Organization for Standardization (ISO) 15197: 2013. ISO standard requires 95% of results within range or slightly higher, be within / - 15% of true value.

Aim of the study: Measurement of glucose by two methods: spectrophotometers and the glucometer “One touch”, to see if there are differences between these methods, so if the results obtained from glucometer fall within +/- 15% of the true value.

Method: Measurements of the glyceic values were conducted using two methods: spectrophotometer Humalyzer Primus and the glucometer One Touch, using respectively samples as venous and capillary blood. Blood samples and all tests were conducted at the premises of HPS Logos.

Result: In our study, we have found a difference in the measured results with spectrophotometer and glucometer. However, the resulting p values  $<0.05$ , it means the difference found between the two methods is not statistically significant.

Conclusions: Extra laboratory tests are cost-effective, fast and confidential. It is important that the persons concerned (eg. Diabetic patients) know to perform well the procedure to avoid as much as possible errors. According to our study, no statistically significant differences between the value of glycemia measured with glucometer or spectrophotometer (in the laboratory). There are cases in which as a result of not respecting sanitary conditions

RIPËRDORIMI I TË DHËNAVE TË INTERNETIT  
PËRMES KALIMIT NGA NJË PLATFORMË SOFTUERIKE  
NË NJË TJETËR

**Msc. Luan Sinanaj<sup>1</sup>, Dr. Valmira OSMANAJ<sup>2</sup>**

ABSTRAKT

Në ditët e sotme, kur progresi teknologjik avancon me ritme të shpejta, përdorimi i teknologjisë web për të komunikuar me botën e jashtme është bërë mëse i rëndësishëm. Ky komunikim vjen shpesh nëpërmjet publikimit të të dhënave në faqet e internetit, siç mund të jetë një gazetë e përditshme on-line ose nëpërmjet forumeve, blogjeve, çateve e shumë medime të tjera. Në përgjigje të kësaj dinamike kompani dhe organizime ekspertësh në fushën e teknologjisë zhvillojnë sisteme të menaxhimit të përmbajtjes, CMS, të cilat mund të mundësojnë krijimin dhe menaxhimin e faqeve web.

Qëllimi i këtij punimi është që të realizohet migrimi i një faqeje web nga një platformë softuerike në një platformë tjetër. Faqja

---

1. Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.

2. Departamenti i Informatikës së Zbatuar, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, ShLP "Logos". .



web e marrë në studim është gazeta e përditshme on-line [piazzadellenotizie.it](http://piazzadellenotizie.it), e implementuar në platformën WordPress, një CMS pa pagesë. Objektivi i migrimit është që të implementohet një faqe web me ndërfaqe, funksionalitete dhe përmbajtje të njëjtë me faqen ekzistuese web, por duke përdorur platformën Drupal si CMS. Për më tepër, gazeta mund të qaset edhe nëpërmjet mediumeve të tjera, si tabletë dhe telefona të zgjuar, për t'iu përgjigjur kërkesës për informacion “në lëvizje”.

Implementimi i këtij projekti u realizua në tri faza kryesore: analiza dhe mbledhja e specifikimeve të faqes ekzistuese web, studimi i CMS Drupal si dhe projektimi e ndërtimi i faqes së re web me anë të platformës Drupal si dhe migrimi i të dhënave nga platforma e vjetër në atë të re. Faqja e re web aksesohet si nga mediumet klasike, desktop dhe laptop, ashtu dhe nga pajisjet e reja tabletë dhe telefonat e zgjuar.

**Fjalë kyçe: Migrim, faqe web, WordPress, Drupal, ripërdorim të dhënash.**

## Hyrje

Tanimë, web-i është bërë mëse i rëndësishëm në përdorimet nga më të ndryshmet, përfshirë edhe gazetat e përditshme on-line të cilat ofrojnë komoditet dhe menaxhim kohe më të mirë për lexuesit.

Gjithashtu vlen të themi që sot e kësaj dite është rritur edhe përdorimi i CMS-ëve për ndërtimin e faqeve web, sepse janë të shpejtë në ndërtimin e tyre, të thjeshtë dhe komod. Qëllimi i studimit të këtij projekti është kalimi i një faqeje web nga një platformë softuerike CMS në një tjetër më të mirë. Gjatë kalimit do të mbahet e njëjta paraqitje grafike me faqen e vjetër dhe mbi të gjitha do të migrohen në faqen e re të dhënat e faqes së vjetër. Për punimin e faqes e së re u zgjodh Drupal si platformë softuerike CMS. Drupal u zgjodh, sepse është i orientuar në menaxhimin e më shumë tipeve të dhënash, shumë fleksibël në

prezantimin e të dhënave, ofron mënyra të ndryshme të aksesit në bazën e të dhënave dhe shumë funksionalitete të tjera. Gjithashtu, Drupal ofron stabilitet, siguri, performancë dhe konsiderohet si një ndër CMS-të pa pagesë më performante dhe fleksibël nga ato që janë në dispozicion. Ky studim është organizuar në pesë çështje [1,2,3]:

- *në pjesën e parë është prezantuar metodologjia e punës;*
- *në pjesën e dytë është realizuar analiza e faqes së vjetër në paraqitjen e saj grafike dhe të dhënat që e përfaqësojnë;*
- *duke u nisur nga analiza, në pjesën e tretë përshkruhet ndërtimi i faqes së re duke përdorur platformën Drupal;*
- *në pjesën e katërt shpjegohet migrimi i të dhënave nga faqja e vjetër në të reën;*
- *kurse në pjesën e fundit paraqiten konkluzionet e studimit dhe referencat.*

## **1. Metodologjia**

Bazuar në natyrën e problemit të marrë në studim, qasja e zgjedhur për kërkimin është studimi i rastit (Myers, 1997; Boudreau, et al., 2001) [4, 5]. Faqja web e marrë në studim është gazeta e përditshme on-line [piazzadellenotizie.it](http://piazzadellenotizie.it), e implementuar në platformën WordPress, një CMS pa pagesë. Objektivi i migrimit është që të implementohet një faqe web me ndërfaqe, funksionalitete dhe përmbajtje të njëjtë me faqen ekzistuese web, por duke përdorur platformën Drupal si CMS.

Nërkohë mbledhja e të dhënave është realizuar nëpërmjet intervistave si dhe studimit të të dhënave nga faqja ekzistuese web e gazetës së përditshme. Gjatë fazës së analizës dhe mbledhjes së specifikimeve të faqes ekzistuese web është grumbulluar i gjithë informacioni i nevojshëm për projektimin dhe ndërtimin e faqes së re web me anë të platformës Drupal si dhe migrimi i të dhënave në platformën e re.

Duke qenë se funksionalitet e paraqitura në rastin në studim janë të njëjta me ato të paraqitura në çdo faqe tjetër informuese elektronike, mund të aplikohet e njëjta qasje e paraqitur në këtë punim.

Gjithashtu, kjo qasje mund të shfrytëzohet edhe për faqe të tjera web, të cilat kanë karakter informues dhe që ofrojnë funksionalitete të ngjashme me ato të faqes së marrë në studim.

## 2. Analiza e faqes ekzistuese

Faza e parë e projektit është analiza e detajuar e faqes web *piazzadelle-notizie.it*, me objektivin për të përshkruar dhe për të nxjerrë kërkesat. *Piazzadellenotizie.it* është një faqe interneti që përmban informacion në lidhje me lajmet, sportin, kulturën, aktivitetet, si dhe informacione të interesit publik dhe kuriozitete. Të gjitha këto informacione janë të menaxhuara nga redaksia dhe janë të ndara në katër zona gjeografike: *Italia dhe Bota, Toskana, Firenze, Muxhello dhe Valdisieve*.

### 2.1. Tipet e të dhënave

Gjatë fazës së analizës u identifikuan dy tipe kryesore të të dhënave: **artikulli** dhe **faqja statike**. Një **artikull** është informacioni i prodhuar nga redaktorët e faqes së internetit dhe është objekt i përditësimeve të shpeshta. Artikulli mund t'i përkasë njëres prej këtyre kategorive: *Cronaca, Cultura, Curiosità, Pubblica utilità, Eventi, Sport* dhe përbëhet nga fushat: *Titulli, Data, Autori, Teksti, Kategoria, Tregues gjeografik (Zona), Foto, Tags dhe Komente*.

Ndërkohë, **faqja statike** përfaqëson një të dhënë të faqes së internetit që nuk është objekt i përditësimeve të shpeshta, të tilla si faqet **Rreth Nesh (About us)** dhe **Kontakttoni (Contacts)**. Një faqe statike përbëhet nga fushat: *Titulli, Data, Autori, Teksti dhe Komente*.

### 2.2. Flukset e navigimit në portal

Navigimi përshkruan rrugët që përdoruesi ka në dispozicion për t'u konsultuar me të dhënat e portalit. Menutë e navigimit të faqes së internetit janë:

- **Menu kryesore:** e pranishme në çdo faqe, mundëson akses në seksionet e tjera të portalit: *Cronaca, Cultura, Curiosità, Eventi, Pubblica utilità, Sport, Firenze, Italia e Mondo, Mugello e Valdisieve, Toscana*.

Në figurën e mëposhtme është paraqitur menuja kryesore:



Fig. 1: Menu kryesore.

• **Menu Categorie:** është një menu me përzgjedhje që shfaqet në kolonën 1 (fig. 3) të çdo faqeje. Implementimi i kësaj menuje është realizuar duke përdorur modulën **Jump**, siç tregohet në figurën e mëposhtme:



Fig. 2: Menu *Categorie*.

### 2.3. Prezantimi i të Dhënave dhe Modeli i Faqeve

Faqet ofrojnë shfaqjen relative të të dhënave. Ndër faqet kryesore janë: *Home, Cronaca, Cultura, Curiosità, Eventi, Pubblica utilità, Sport, Italia e Mondo, Mugello e Valdiseive, Toscana, Chi siamo* dhe *Contatti*.

#### a. Paraqitja (Layout) Standarde e Faqeve

##### Header i faqes

Prezantimi i përbashkët për të gjitha faqet është përshkruar në figurën e mëposhtme:




Fig 3:  
Skema e pjesëve të përbashkëta të të gjitha faqeve.

Layout standard i faqes përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

- **Header-i i faqes:** përbëhet nga logoja e faqes, menuja kryesore e navigimit dhe forma Kërko:



Fig 4: Header i faqes.

- **Kolona 1:** përmban një filtër kërkimi për të dhënat sipas kategorisë, një bllok për shfaqjen e artikujve të fundit të seksionit kronikë (*Cronaca*) dhe një bllok për shfaqjen e publikimeve të fundit të seksionit të kulturës (*Cultura*).

- **Kolona 3:** përmban lloje të ndryshme të zonave të informacionit, duke përfshirë: banner reklamash, filtër kërkimi për artikujt e fundit, seksioni i motit të rajonit të Toskanës dhe lidhjet me rrjetet sociale kryesore.

- **Footer-i i faqes:** është e përbërë nga disa informacione mbi faqen e internetit dhe të drejtën e autorit.

Të dhënat dhe prezantimi i **trupit qendror (kolona 2)** ndryshojnë në varësi të seksionit të faqes ose të të dhënave që do të paraqiten.

#### ***b. Prezantimi i Faqes Kryesore***

Homepage është faqja kryesore e aksesit në seksionet dhe të dhënat e portalit. Ajo është e strukturuar si vijon: **Trupi qëndror** (kolona 2) në Homepage, i cili përbëhet nga një bllok për shfaqjen e aktiviteteve të fundit, një bllok për shfaqjen e artikujve të fundit të seksionit *Sport* dhe një bllok për shfaqjen e publikimeve të fundit të seksionit të kurioziteteve. Ndërkohë, kolona 1 dhe 2 nuk ndryshojnë.

#### ***c. Prezantimi i Artikullit***

Prezantimi i të dhënës **Artikull** bëhet në **trupin qendror** (Fig. 3) të faqes ku shfaqet përmbajtja e artikullit, komentet mbi artikullin dhe një form për të shkruar një koment.

#### **d. Prezantimi i Faqes Statike**

Prezantimi i **faqes statike** gjithashtu bëhet në **trupin qendror** (Fig.3) ku shfaqet përmbajtja e faqes dhe ndonjë koment, në qoftë se janë të aktivizuar nga redaktori.

Faqet statike janë: Rreth nesh (*Chi siamo*) dhe Kontaktoni (*Contatti*) që përmbajnë informacione për portalin dhe se si të kontaktoni redaktorët e tij.

### **2.4. Menaxhimi i Përdoruesve**

Bazuar në analizën e bërë në faqen *piazzadellenotizie.it* u vendos që të përcaktohen tri kategori të përdoruesit:

- përdorues administrator: për të menaxhuar faqen;
- përdorues të autentifikuar: redaktorët apo gazetarët;
- përdorues anonim: vizitorët e faqes.


## **3. Projektimi dhe ndërtimi i faqes së re**

Gjatë kësaj faze u projektua dhe ndërtua faqja *piazzadellenotizie.it*, duke përdorur Drupal si CMS si dhe u përcaktuan elementët e ndryshëm, që e karakterizojnë faqen: paraqitja (layout), modulet shtesë, të dhënat, taksonomia, menutë e navigimit, format (view) dhe konfigurime të tjera. Për secilën nga këto çështje të trajtuara do të evidentohen zgjedhjet e bëra dhe problemet e hasura.

### **3.1. Paraqitja e Faqes**

Tema e zgjedhur për projektin tonë është **Corolla 7.x-2.2 [6]**, që rrjedh nga tema **Adaptivetheme 7.x-2.2**, e cili nuk bën pjesë në paketat bazë të platformës Drupal, por duhet të instalohet më vete.

Kjo temë u zgjodh për shkak se ajo ofron shumë zona në paraqitjen e faqes (Fig. 5) dhe mbi të gjitha ajo ofron mundësinë e përshtatjes së faqes për **tabletë** dhe **telefonat e zgjuar**.



**Fig 5:** Zonat e temës **Corolla**.

Tema është modifikuar duke krijuar një paraqitje të personalizuar (*piazzadellenotizie.css*) për faqen: mundësia e modifikimit të temës me CSS të personalizuar mundëson që të mos ndryshojmë versionin zyrtar të temës dhe të mos humbasim modifikimet kur të përditësohet tema.

### 3.2. Të dhënat

Në fazën e analizës u evidentuan dy tipet kryesore të të dhënave: **Faqja statike** dhe **Artikulli**, të përfaqësohen në drupal nga elementët e mëposhtëm:

- Për **faqen statike**, u konfigurua e dhëna **“Basic page”**, e karakterizuar nga **fushat**: Titulli, Data, Autori, Teksti, Mundësia për të aktivizuar ose ç’aktivizuar komentet normale ose komentet e lidhura me rrjetin social Facebook dhe Mundësia për të lidhur një faqe statike me një menu të navigimit.

- **Për Artikullin, u konfigurua e dhëna “Article”, e karakterizuar nga fushat e mëposhtme:** Titulli, Nën-titulli, Teksti, Foto, Kategoria, Treguesi gjeografik (Zona), Tags, Autori, Data, Mundësia për të aktivizuar ose çaktivizuar komentet normale ose komentet e lidhura me Facebook dhe mundësia për të lidhur një artikull me një menu të navigimit.

### 3.3. Taksonomia

Drupal ofron modulën e taksonomisë (*Taxonomy [7]*) për të krijuar klasifikimin dhe kategorizimin e të dhënave. Nga analiza e faqes *piazzadellenotizie.it* dhe nga klasifikimi i të dhënave të përdorura janë krijuar tre fjalorë me specifikimet e tyre si më poshtë:

**Fjalori Kategoria:** *Cronaca, Cultura, Curiosità, Eventi, Naviga tra le categorie, Pubblica utilità, Sport.*

**Fjalori Zona:** *Firenze, Italia e Mondo, Mugello e Valdisieve, Toscana.*

**Fjalori Tags:** i lejon përdoruesit redaktor të vendosë fjalë çelës (Tags), gjatë krijimit apo modifikimit të një artikulli.

Përcaktimi dhe përdorimi i fjalorëve aplikohet te moduli **Views [8]**, i cili mundëson përdorimin e specifikimeve të fjalorëve si filtra kërkimi për të përzgjedhur të dhënat e faqes.

### 3.4. Menutë e Navigimit

Nga analiza e bërë në faqen e vjetër, kjo faqe interneti është e përbërë nga tri menu të navigimit:

**a. Menuja kryesore (Main Menu):** menuja kryesore e navigimit, e cila është prezente në kokën e secilës faqe dhe përbëhet nga linqet e mëposhtme: *Cronaca, Cultura, Curiosità, Eventi, Pubblica utilità, Sport, Firenze, Italia e Mondo, Mugello e Valdisieve, Toscana.*

**b. Navigimi nëpër kategori:** është një menu me përzgjedhje që shfaqet në kolonën 1 (fig. 3) të çdo faqeje. Implementimi i saj është realizuar duke përdorur modulën **Jump** (fig. 6).



### 3.5. Format

Moduli i formave (**Views [8]**) në thelb është një gjenerues i zgjuar pyetjesh (**query**), i cili ju lejon të përcaktoni parametrat e pyetjes që do të ekzekutohet për të kërkuar informacion në bazën e të dhënave të faqes. Ndër të tjera, **Views** mund të përdoren për të gjeneruar raporte, të krijojë përmbledhje dhe të shfaqë koleksione fotosh dhe të dhënash të tjera. Për të instaluar dhe përdorur modulën **Views** është e nevojshme të instalohet paketa e mjeteve të nevojshme, moduli **Chaos tool suite (ctools [9])**.

Për faqen e re u krijuan katër lloje të View-ve:

i. Një **View** që implementon një pyetje (**query**) për të kthyer të dhënat që lidhen me fjalorin “Kategoria”. Për shembull: View me emrin *Kronikë* kthehen nga baza e të dhënave të gjithë të dhënat e lidhura me termin “*Kronikë*”.

ii. Një **View** që implementon një pyetje (**query**) që kthen 10 artikujt e fundit të lidhur me fjalorin “Kategoria”.

iii. Një **View** që implementon një pyetje që kthen të gjithë të dhënat e publikuara që i përkasin fjalorit “Kategoria” dhe fjalorit “Zona”.

iv. Një **View** që implementon një pyetje që kthen 10 artikujt e fundit të postuara, pa marrë parasysh termin e lidhur me to.

### 3.6. Modulet Shtesë

Për të pasur funksionalitetet e nevojshme për të realizuar faqen e internetit, janë instaluar module shtesë, si më poshtë:

- **JUMP [10]**: ky modul është instaluar për relizimin e një menuje me përzgjedhje, si në figurën 6. Në këtë modul janë bërë modifikime, në praktikë është hequr butoni “**Go**”, dhe në vend të tij është implementuar ngjarja *OnChange* kur zgjidhet një element në menunë me tendinë:

```

/** Form constructor for the jump form.
 * @param array $form_state
 * @param array $options
 * @param integer $active
 * @return array */
function jump_quickly_form($form, &$form_state, $options, $active) {
  $default = "";
  if ( $active ) {
    if ( isset ( $options[ $GET['q'] ] ) ) { $default = $GET['q']; }
  }
  $form = array( );
  $form['#submit'] [] = 'jump_quickly_form_submit';
  $form['#theme'] = 'jump_quickly_form';
  $form['#attributes'] ['class'] = 'jump-quickly';
  $form['#attributes'] ['onchange'] = 'this.submit( )';
  $form['jump_goto'] = array( '#type' => 'select', '#default_value' => $default, '#options' => $options );
  $form['submit'] = array( '#type' => 'submit', '#value' => t('Go') );
  return $form;
}

```



Fig. 6: Menu me përzgjedhje “Naviga tra categorie”.

- Pathauto [11]: ky modul gjeneron automatikisht emërtimet (alias) URL-Path për lloje të ndryshme të të dhënave (si nyjet, termat e taksonomisë, përdoruesit) pa kërkuar që përdoruesi të specifikojë në mënyrë manuale emërtimin e path-it. Kjo mundëson që të kemi emërtime URL të tipit / *kategoria/my-node-title* në vend të /*node/123*, që jep më shumë fleksibilitet në kërkim e të dhënave. Emërtimet janë të bazuara në një sistem “pattern” (model) që përdor shenja (token), të cilat mund të konfigurohen nga administratori. Për ta bërë funksional modulën Pathauto, duhet që të jetë instaluar më parë moduli Token.

- **IMCE [12]:** ky modul shërben për të bërë ngarkimin (upload) e fotove.
- **WYSIWYG [13]:** ofron një editor për të redaktuar tekstin e artikujve dhe faqeve statike. Moduli WYSIWYG është i përshtatshëm për çdo lloj editor *Client-Side*. Në këtë projekt kemi integruar dy editorë, që realizojnë funksionalitetet e tyre, konkretisht:

- a. **CKEditor [14]:** për ta vënë në punë ju duhet të shkarkoni dhe të vendosni në folderin *sites/all/libraries* edhe modulën Colorbox [15];

- b. **TinyMCE [16].**

- **IMCE Wysiwyg bridge [17]:** mundëson përdorimin e modulit ICME me modulën Wysiwyg.

- **Backup and Migrate [18]:** thjeshtëzon rezervimin (backup) dhe rivendosjen e bazave të të dhënave të Drupal apo kopjes së të dhënave nga një faqe interneti Drupal në një tjetër.

- **Imagefield Crop [19]:** ofron mundësinë për të prerë fotot pasi t'i ngarkoni (upload). Kur redaktori ngarkon një foto, ajo i paraqitet brenda një kornize prerjeje ku mund të zgjedhë dhe ndryshojë madhësinë a saj.

- **Facebook Comments Social Plugin [20]:** i lejon përdoruesit të komentojë të dhënat duke përdorur llogarinë e tij në Facebook. Ky modul është i bazuar në *plugin-in* zyrtar të Facebook për komente (*Facebook comments Plugin Social*).

- **Site map [21]:** ky modul ndërton një hartë të faqes me të cilën i ofrohet përdoruesve një pasqyrë e plotë e faqes. Përveç kësaj, mund të aktivizohen dhe të shfaqen *RSS feeds* për të gjitha të dhënat dhe karakteristikat e fjalorëve.

- **XML Sitemap [22]:** ky modul krijon një skedar *XML Sitemap* që përputhet me specifikat e *sitemaps.org*. Kjo ndihmon motorët e kërkimit për të ekzekutuar një skanim në një faqe web në mënyrë inteligjente. *Sitemap* i krijuar nga ky modul mund të dërgohet automatikisht në motorët e kërkimeve ASK, Google, Bing dhe Yahoo.

### 3.7. Përdoruesit dhe Rolet

Drupal menaxhon veprimet që i lejohen përdoruesve nëpërmjet roleve dhe të drejtave që lidhen me to. Për të menaxhuar përdoruesit ekzistues ose për të krijuar llogari të reja, shërben seksioni **People** i Drupal [23].

Për këtë faqe interneti janë përcaktuar tre lloje të përdoruesit:

**a. Administratori:** i cili menaxhon faqen e internetit.

**b. Përdoruesit e Regjistruar:** janë redaktorët të cilët mund të krijojnë, modifikojnë dhe të publikojnë të dhënat në këtë faqe interneti.

**c. Përdoruesi Anonim:** thjesht një përdorues që viziton faqen e internetit mund të lexojë të dhënat, të cilat ai mund edhe t’i komentojë nëse komentet janë të aktivizuara nga redaktori.

#### 4. Migrimi i të dhënave

Qëllimi kryesor i kësaj faze është migrimi i të dhënave nga platforma Wordpress në atë të Drupal. Këto janë hapat e ndjekur për të bërë migrimin e të dhënave:

*a. Eksportimi në formatin XML i të dhënave prezente në instalimin e faqes web WordPress, duke përdorur instrumentin “Export” i dhënë në platformën softuerike Wordpress.*

*b. Importimi i skedarit XML rezultat i fazës së mëparshme në CMS-në Drupal: për të bërë këtë është e nevojshme të instalohen dhe aktivizohen modulet “Migrate WordPress [24]” dhe “Migrate [25]” të Drupal si dhe përdorimi i instrumenteve të importit që janë vënë në dispozicion (Drupal ! Content ! WordPress Migration).*

Instrumentet e importit të përdorura ju lejojnë të konfiguroni aspekte të ndryshme të konvertimit të të dhënave nga një platformë në një tjetër, për shembull: si të interpretojmë *taget* HTML në fushën e tekstit, si të hartojmë kategoritë dhe taget në taksonominë e re të faqes së internetit.

Gjatë kësaj faze janë hasur shumë vështirësi për shkak të prezencës së gabimeve në skedarin XML të prodhuar nga Wordpress: duke lypsur korrigjimin manual të tij, çdo herë që funksioni i importimit të Drupal haste një gabim.

#### 5. Konkluzione dhe rekomandime

Migrimi i gazetës së përditshme on-line *piazzadellenotizie.it* nga Wordpress në CMS-në Drupal ishte një mundësi e mirë për ne dhe kompaninë për të mësuar

më shumë rreth kalimit të një faqeje web nga një platformë pa pagesë në tjetrën dhe për të njohur më hollësisht një nga CMS-të më të vlerësuara në botë. Gjithashtu i ofron pronarit të faqes së internetit mundësi për të përdorur një produkt të besueshëm dhe të sigurt për punën e tij, e cila i lejon të qëndroj me hapin e kohës me përditësimet e vazhdueshme.

Produkti i realizuar i plotëson kërkesat e përcaktuara fillimisht në fazën e analizës:

- krijimi i një faqeje interneti me të njëjtën paraqitje grafike të faqes së internetit origjinale, por e realizuar në një platformë softuerike të ndryshme;
- ofrimi i mundësisë për të menaxhuar lloje të ndryshme të përdoruesve: administrator, përdorues të regjistruar në faqen e internetit, përdorues anonim;
- mundësinë për të punuar dhe publikuar të dhëna të reja ose të modifikoni dhe fshini të dhënat ekzistuese;
- mundësinë për të përshtatur paraqitjen e faqes së internetit në bazë të pajisjes së përdorur: PC, tabletë ose telefonat e zgjuar (smartphone).

Projekti mundësoi thellimin e studimit të tematikave të ndryshme që lidhen me web-in si analiza e faqeve të internetit, përcaktimi i të dhënave të një faqeje dhe klasifikimi i tyre; gjithashtu janë përmirësuar edhe njohuritë e PHP, HTML, CSS dhe Javascript. Krijimi i faqes së internetit ishte mundësia për të studiuar Drupal dhe më në përgjithësi përdorimin e CMS-së për të krijuar dhe menaxhuar faqet e internetit.

Një fazë e rëndësishme e projektit ishte faza e testimit, e dedikuar për të shqyrtuar pajtueshmërinë e faqes së internetit me shfletuesit më të popullarizuar si Firefox, Chrome, Internet Explorer, të instaluar në sisteme të ndryshme operative. Gjithashtu, u verifikuan prezantimi korrekt dhe funksionalitetet e faqes në tableta dhe telefonat e zgjuar, nëpërmjet përdorimit të simulatorëve. Këto teste mundësuan verifikimin, korrigjimin dhe përmirësimin e skedarit të stilizimit CSS i krijuar posaçërisht për faqen e internetit.

Në të ardhmen, do të studiojmë migrimin e një faqeje web nga një platformë softuerike me pagesë në një platformë tjetër pa pagesë ose anasjelltas. Studimi i migrimit të faqeve nga një platformë në tjetrën si dhe përcaktimi i standardeve dhe udhëzimeve përkatëse do ti vinte në ndihmë bizneseve që të shfrytëzojnë

sa më mirë teknologjitë e reja web si dhe të qasen nga përdoruesit dhe klientët e tyre duke shfrytëzuar medime të ndryshme komunikimi.

## REFERENCA

- [1] Berry, A., Byron, A. & De Bondt, B., 2012. "Using Drupal". O'Reilly Media.
- [2] Drupal - Open Source CMS. (10.02.2015). Marrë nga: <https://www.drupal.org/>
- [3] Drupal for Web Content Management. (02.03.2015). Marrë nga: <https://www.drupal.com/product/web-content-management>
- [4] Myers, M. D., 1997. "Qualitative Research in Information Systems". MIS Quarterly, 21(2), pp. 241-242.
- [5] Boudreau, M. C., Gefen, D. & Straub, D. W., 2001. "Validation in information systems research: A state of the art assessment". MIS Quaterly, 25(1), pp.1-16.
- [6] "Themes Corolla". (15.03.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/corolla>
- [7] "Taxonomy". (26.03.2015). Marrë nga: <https://www.drupal.org/getting-started/6/admin/content/taxonomy>
- [8] "Views". (02.04.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/views>
- [9] "Chaos tool suite (ctools)". (02.04.2015). Marrë nga: <https://www.drupal.org/project/ctools>
- [10] "Jump". (10.04.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/jump>
- [11] "Pathauto". (12.04.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/Pathauto>
- [12] "IMCE". (20.04.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/IMCE>
- [13] "Wysiwyg".(20.04.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/Wysiwyg>

- [14] “Ckeditor”.(20.04.2015). Marrë nga: <http://ckeditor.com/download>
- [15] “Colorbox” .(20.04.2015). Marrë nga: <https://www.drupal.org/project/colorbox>
- [16] “TinyMCE”. (24.04.2015). Marrë nga: <http://www.tinymce.com/download/download.php>
- [17] “IMCE Wysiwyg bridge”.(24.04.2015). Marrë nga: [http://drupal.org/project/imce\\_wysiwyg](http://drupal.org/project/imce_wysiwyg)
- [18] “ Backup and Migrate. (30.04.2015). Marrë nga: [http://drupal.org/project/backup\\_migrate](http://drupal.org/project/backup_migrate)
- [19] “Imagefield Crop”. (04.05.2015). Marrë nga: [http://drupal.org/project/imagefield\\_crop](http://drupal.org/project/imagefield_crop)
- [20] “Facebook Comments Social Plugin”.(08.05.2015). Marrë nga: [http://drupal.org/project/facebook\\_comments](http://drupal.org/project/facebook_comments)
- [21] “Site map”. (15.05.2015). Marrë nga: [http://drupal.org/project/site\\_map](http://drupal.org/project/site_map)
- [22] “ XML sitemap”. (15.05.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/xmlsitemap>
- [23] “ Users, roles and permissions”. (25.05.2015). Marrë nga: <https://www.drupal.org/node/120614>
- [24] “WordPress\_Migrate”. (17.06.2015). Marrë nga: [http://drupal.org/project/wordpress\\_migrate](http://drupal.org/project/wordpress_migrate)
- [25] “Migrate”. (17.06.2015). Marrë nga: <http://drupal.org/project/migrate>

## SUMMARY

### **Reuse of content through migration of websites from one software platform to another**

Nowadays, when technological progress advances rapidly, the usage of web technology to communicate with the outside world has become very important. This communication comes often

through publication of data on the website, such as on-line daily newspaper or through forums, blogs, chatting rooms and through many other means of communication. In response to this dynamic change companies and organized experts in the field of technology, develop various content management systems, CMS, which enable the implementation and management of websites.

The main purpose of this paper is to attain the migration of a website from one software platform to another. In our research, we have considered the online daily newspaper [piazzaellenotizie.it](http://piazzaellenotizie.it) that is implemented on WordPress platform, an open source CMS. The objective of the migration is to implement a website that has the same interface, functionality and content of the existing website, but that uses Drupal as CMS platform. Moreover, the website may be accessed through other mediums, such as tablets and smartphones in response to the request for information “on move”.

The project was implemented following three main phases: analysing and collecting specifications from the existing website, studying the Drupal CMS and designing and implementing the new website using Drupal platform and migrating the data from the existing platform to the new one. The new website is accessible from both the classic mediums, such as desktops and laptops, but also from the new mediums such as tablet devices and smartphones as well.

**Keywords:** Migration, website, WordPress, Drupal, Reuse of data



# ANALIZA E KRIMIT NË SHQIPËRI PËRMES APLIKIMIT TË METODAVE TË GRUPIMIT DATA MINING

**Msc . Olta Petritaj<sup>1</sup>, Prof. asc. Ana Ktona<sup>2</sup>, Msc. Gazmira Brahusi<sup>2</sup>**

## ABSTRAKT

Data mining përfshin procesin e zbulimit të modeleve dhe marrëdhënieve midis informacionit të fshehur. Gjithashtu na lejon të bëjmë parashikime të sakta dhe të besueshme të ngjarjeve të ardhshme, duke u bazuar në identifikimin dhe karakterizimin e këtyre modeleve në të dhënat historike. Përdorimi kryesor i data mining është që të zbulojë informacionin që askush nuk e dinte më parë.

Në këtë punim ne do të përdorim metodat e grupimit data mining për analizimin e të dhënave që regjistrohen në lidhje me krimet e kryera. Metodat e grupimit data mining i krahasojmë teorikisht dhe praktikisht pas zbatimit të tyre mbi të dhënat e grumbulluara në ambjentet e paraburgimit në Tiranë dhe Kavajë. Disa tipare të të dhënave të grumbulluara janë mosha, gjinia, statusi i punësimit, koha e ndodhjes së krimit, lloji i krimit, vendi i krimit etj.

---

1. Departamenti i Informatikës së Zbatuar, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara, ShLP "Logos".

2. Departamenti i Informatikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës .

Ne zbulojmë që metodat e grupimit data mining kontribuojnë në identifikimin e zonave ku mund të ndodhin krime, si dhe tipareve të personave që kryejnë krime të ndryshme. Në këtë mënyrë kontribuojnë në parashikimet mbi gjasat e ndodhjes së krimit dhe parandalimin e tij.

***Fjalë kyçe:** Data Mining, Parashikimi i krimit, Parandalimi i krimit*

## Hyrje

### 1. Krimi dhe parandalimi i tij në Shqipëri

**N**ë ditët e sotme, shumica e agjensive të zbatimit të ligjit përballen me volum të madh të të dhënave që duhet të jenë të përpunuara dhe të transformuara në informata të dobishme. Analiza e këtyre të dhënave është me të vërtetë e rëndësishme për të zbuluar dhe parandaluar krimet. Informacioni në kohë është çelësi për zgjidhjen e kësaj çështjeje të rëndësishme. Kohët e fundit për të analizuar të dhënat në mënyrë që të ketë parashikime të sakta dhe ngjarje të besueshme në të ardhmen, bazuar në identifikimin dhe karakterizimin e këtyre modeleve në të dhënat historike, është përdorur data mining. Data mining përfshin procesin e gjetjes së modeleve të fshehura dhe marrëdhënieve midis të dhënave të papërpunuara. Data mining ndihmon në zgjidhjen e një problemi: sa më shumë të dhëna të kemi, aq më e vështirë dhe aq më shumë kohë efektive konsumojmë për të analizuar dhe për të nxjerrë kuptimin e të dhënave me metoda tradicionale. Përdorimi kryesor i data mining është që të zbulojë informacionin që askush nuk e dinte më parë.

Baza të ndryshme të dhënash mund të përdoren në sistemin tonë të parashikimit dhe të parandalimit të krimit për të analizuar krimin në mënyrë inteligjente. Këto baza të dhënash mund të jenë baza të dhënash të veçanta, të tilla si bazat e të dhënave për vrasje apo vjedhje, ose të shoqëruara me një model të krimeve. Sistemi i Menaxhimit i Bazës së të Dhënave nuk është bërë për të kryer analizën e informacionit. Përkundrazi ai është krijuar për menaxhimin e rasteve dhe numërimin e përgjithshëm të krimeve. Duke shtuar në sistemin e

menaxhimit të bazës së të dhënave metodat data mining është bërë e mundur që të kemi një sistem që të funksionojë si një ekspert në kriminalistikë.

## **2. Përdorimi i data mining në kriminalistikë**

Kriminalistika është një fushë, e cila fokusohet në studimin shkencor të krimit si dhe në sjelljen kriminale dhe zbatimin e ligjit është një proces që synon të identifikojë karakteristikat e krimit. [1] Analiza e Krimit, një pjesë e kriminalistikës, ka një detyrë që përfshin eksplorimin dhe zbulimin e krimit dhe marrëdhëniet e tij me kriminelë. Identifikimi i karakteristikave të krimit është hapi i parë për zhvillimin e analizave të mëtejshme. Njohuritë që janë fituar nga qasjet e data mining janë një mjet shumë i dobishëm, i cili mund të ndihmojë dhe të mbështesë agjensitë e zbatimit të ligjit. Shumë njerëz mendojnë se data mining është thjesht përdorimi i softuerëve. Megjithatë, ai është më tepër një proces që përfshin një sërë hapash për të transformuar të dhënat, duke vlerësuar dhe interpretuar rezultatet e modelimit.

Data mining është procesi i zbulimit të modeleve të dobishme në sasi të madhe të të dhënave që shpjegojnë ngjarjet e kaluara në një mënyrë të tillë që rezultatet e modelit të mund të përdoren për të parashikuar në të ardhmen. Ky proces përfshin analizë sistematike të të dhënave dhe nxjerrjen e modeleve që janë të mbledhura në sasi të mëdha të të dhënave duke përdorur metoda të automatizuara. Njohja e modeleve është e nevojshme për të kthyer të dhënat në një rrjedhë të menaxhueshme të informacionit të dobishëm.

Në fushën e kriminalistikës gjenerohet një vëllim i madh të dhënash. Përveç trajtimit të vëllimit të të dhënave, teknikat data mining ndihmojnë gjithashtu që të merren me kompleksitetin dhe natyrën dinamike të sjelljes kriminale. Duke përdorur metodat data mining përmirësojmë analizën e krimit dhe ndihmojmë reduktimin dhe parandalimin e krimit. Aktivitetet data mining mund të ndahen në dy kategori të mëdha, në përputhje me qëllimin kryesor të analizës, interpretim dhe parashikim.

Interpretimi bën identifikimin e modeleve të rregullta të të dhënave dhe paraqet ato me anë të rregullave dhe kritereve që mund të kuptohen lehtë nga

ekspertët në fushën e aplikimit [2]. Rregullat e krijuara duhet të jenë origjinale dhe jo të parëndësishëm për të rritur nivelin e njohurive dhe kuptuar sistemin.

Parashikimi [2] bën parashikimin e vlerës që do të ketë një ndryshore e rastit dhe vlerëson mundësinë e ngjarjeve të ardhshme. Aktualisht, teknikat data mining paraqesin parashikimet e tyre në vlerën e një sërë variablash të shoqëruara me subjektet në bazën e të dhënave. Në varësi të ekzistencës së mundshme të një variabli qëllim, ka një dallim thelbësor midis procesit të mbikëqyrur dhe jo të mësuarit të mbikëqyrur.

Ashtu si çdo problem tjetër për zgjidhjen e metodave, detyra e data mining duhet të fillojë me një përkufizim të problemit. Identifikimi i problemit data mining mundëson përcaktimin e procesit data mining dhe teknikën e modelimit.

## **2.1 Klasifikimi**

Për të bërë një klasifikim janë në dispozicion një sërë vëzhgimesh, zakonisht të përfaqësuara nga bashkësia e të dhënave (data set), ku klasa “output” e tyre nuk është e njohur [2]. Çdo vëzhgim është përshkruar nga një numër i caktuar atributesh vlera e të cilëve nuk është e njohur. Një algoritëm klasifikimi përdor vërejtje të vlefshme që janë mbledhur në të kaluarën për të identifikuar një model që parashikon klasën e vërejtjeve të ardhshme për të cilat vlerat e attributeve nuk janë të njohura. Vlen për t’u përmendur se atributi output, vlera e të cilit do të sigurohet, është një atribut kategorik në problemet e klasifikimit dhe për këtë arsye merr një numër të caktuar vlerash (zakonisht një vlerë të vogël). Në shumicën e aplikimeve atributi output është i përfaqësuar nga një ndryshore binare. Natyra kategorike e atributit output përcakton dallimin ndërmjet klasifikimit dhe regresionit.

## **2.2 Rregullat e shoqërimit**

Rregullat e shoqërimit, të njohura gjithashtu si “grupimet prirje”, janë përdorur për të identifikuar marrëdhënie interesante ndërmjet grupeve të rekordeve të bashkësisë së të dhënave (data set) [3].

### 3. Metodologjia

Në krahasojmë teorikisht metodat e grupimit data mining për të zbuluar metodën më të përshtatshme për natyrën e të dhënave tona. Metodat u krahasuan duke aplikuar algoritme data mining me të dhëna konkrete në mjedisin Weka. Metodatat e grupimit janë aplikuar në këto të dhëna për të përcaktuar efektivitetin e tyre në parandalimin e krimit. Të dhënat e analizuar janë mbledhur me anë të pyetësoreve në qelitë e paraburgimit të Tiranës dhe Kavajës. Numri i pyetësoreve që u mbushën ishte 87. Të dhënat kanë të bëjnë me zonat ku ndodhin krimet dhe të dhënat e personave që kryejnë ato. Disa nga tiparet që kemi marrë në shqyrtim janë mosha, gjinia, statusi i punësimit, koha e ndodhjes së krimit, lloji i krimit, vendi i krimit, etj.

#### 3.1 Clustering (grupimi)

Termi “cluster” i referohet një nëngrupi homogjen që ekziston në një popullsi heterogjene. Teknika “Clustering” [9,11] bën segmentimin e popullatave heterogjene në një numër nëngrupesh që kanë karakteristika të ngjashme (figura 1). Vëzhgimet që u përkasin grupimeve të ndryshme kanë karakteristika të ndryshme. Ndryshe nga klasifikimi, “clustering” nuk ka klasa të paracaktuara apo shembuj të referencës që tregojnë klasën “output”, në mënyrë që objektet të jenë të grupuara së bashku në bazë të homogjenitetit të tyre të përbashkët. Ndonjëherë identifikimi i grupimeve përfaqëson një fazë paraprake në procesin data mining në kuadër të analizës së të dhënave. Kjo lejon që të dhënat të jenë të përpunuara sipas rregullave homogjene dhe teknikave të duhura dhe madhësia e të dhënave origjinale të reduktohet, pasi aktivitetet pasardhëse të




Fig. 1: Paraqitja skematike e clustering

data mining zhvillohen në mënyrë të pavarur në secilin prej grupimeve të identifikuar.

Metodat e grupimit data mining janë krahasuar për të gjetur metodën më të përshtatshme për natyrën tonë të të dhënave. Një krahasim i këtyre metodave është paraqitur në vijim.

### 3.1.1 Metodat hierarkike të grupimit

Këto metoda ndërtojnë grupin sipas një ndarjeje rekursive të instancave nga lart-poshtë ose poshtë-lart. Metodat hierarkike [3,4] nuk kanë nevojë të specifikojnë me parë numrin e grupimeve. Këto metoda ndahen në :

“Agglomerative hierarchical clustering”, çdo objekt paraqitet fillimisht si një grup më vete. Grupet shkrihen derisa të merret struktura e dëshiruar e grupimit. Algoritmet poshtë-lart trajtojnë çdo dokument si një grup “Singleton” në fillim dhe më pas në mënyrë të njëpasnjëshme bashkojnë grupimet derisa të gjithë grupimet të jenë shkrirë (bashkuar) në një grup të vetëm që përmban të gjitha dokumentet.

“Agglomerative” (poshtë- lart) [12]

1. Fillon me 1 pikë (Singleton).
2. Shtojmë në mënyrë të njëpasnjëshme dy ose më shumë grupime të përshtatshme.
3. Ndalo kur numri  $k$  i grupimeve është arritur.

“Divisive hierarchical clustering”, të gjithë objektet fillimisht i përkasin një grupimi. Grupi është i ndarë në nën-grupe, të cilët ndahen në nën-grupe të tyre. Grupimi lart-poshtë kërkon një metodë për ndarjen e një grupi. Ky proces vazhdon derisa të merret struktura e dëshiruar e grupimit.

“Divisive” (lart- poshtë) [12]

1. Fillon me një grup të madh.
2. Ndahet në mënyrë të njëpasnjëshme në grupe të vogla.
3. Ndalo kur numri  $k$  i grupimeve është arritur.

Grupimi hierarkik mund të përfaqësohet nga një diagram dy dimensionale e njohur si “dendrogram” që ilustron bashkimet ose ndarjet e bëra në çdo fazë të njëpasnjëshme të analizës.

### 3.1.2 Metodat ndarëse të grupimit

Metodat e ndarjes [3,4] zhvendosin instancat nga një grup në një tjetër, duke filluar nga një ndarje fillestare. Metoda të tilla zakonisht kërkojnë që numri i grupeve të jetë i parapërcaktuar nga përdoruesi. Për të patur një optimalitet global në metodat e ndarjes është i nevojshëm një proces numërimi për të gjitha ndarjet e mundshme. Metodat e ndarjes përdorin një sërë grupimesh dhe një objekt i përket një grupi. Secili grup mund të përfaqësohet nga një “centroid” ose nga një grup (cluster) përfaqësues: ky është një përshkrim i të gjithë objekteve të përfshirë në një grup. Ky përshkrim do të varet nga lloji i objektit i cili është grumbulluar. Në vlerësimin e të dhënave mesatarja aritmetike e vektorëve atribut për të gjithë objektet brenda një grupi ofron një përfaqësues të duhur, ndërsa llojet alternative të “centroideve” mund të kërkojnë në raste të tjera.

Një nga algoritmet më të përdorur për zbulimin automatik të grupimit është [4,5,6] EM (Expectation–Maximization). Ky algoritëm ka tendencë të punojë me grupe të izoluar dhe kompakte. Ideja themelore është për të gjetur një strukturë grupimi (clustering) që minimizon një kriter të caktuar gabimi, i cili mat “distancën” e çdo instance për vlerën e saj përfaqësuese. Algoritmi EM përdoret për të gjetur parametrat në një model. Ai merr në mënyrë arbitrare vlerat për një grup dhe përdor këto vlera për të vlerësuar grupin e dytë, më pas përdor këto vlera për të vlerësuar grupin e parë dhe kjo do të vazhdojë derisa vlerat të konvergojnë në një pikë fikse.

“K-means clustering” [4,7] në data mining është një metodë e analizës së grupimit, e cila bën ndarjen e  $n$  vëzhgimeve në  $k$  grupe ku çdo vëzhgim i përket grupit më të afërt. Algoritmi K-mean [6,8,10] është një ide përsëritëse në gjetjen e  $k$  grupimeve bazuar në distancë. Grupi fillestar ndahet në mënyrë të njëpasnjëshme në grupime të veçanta duke ndërtuar një pemë grupi. Grupimet “Cluster” fillojnë me shumë grupe të vogla dhe kombinohen gradualisht derisa të mbetet një grup i vetëm. Ndarja dhe grupimi i grupeve lejon që të dhëna të veçanta të përdorin kritere të jashtme për të përcaktuar se cili nivel i pemës së grupit “output” është më i dobishëm për një aplikim të caktuar. Ky algoritëm është i lehtë në interpretim, i thjeshtë në zbatim dhe në krahasim me metodat hierarkike është më i shpejtë kur kemi një numër të madh variablash.

Një algoritëm tjetër i metodave ndarëse është edhe “K-medoids” [4] ose (PAM -Partition Around Medoids). Ky algoritëm është shumë i ngjashëm me algoritmin K-means. Ai ndryshon nga ky i fundit kryesisht në përfaqësimin e tij të grupimeve të ndryshme. Procesimi i këtij algoritmi është më i kushtueshëm se algoritmi k-mean. Të dy metodat i kërkojnë përdoruesit të specifikojë  $k$ , numrin e grupimeve.

### 3.1.3 Metodatat e grupimit të bazuara në densitet (density –based)

Këto metoda bazohen në nocionin e densitetit. Metodatat “density-based” [3,4] supozojnë se pikat që i përkasin çdo grupi janë tërhequr nga një probabilitet i një shpërndarjeje të caktuar. Shpërndarja e përgjithshme e të dhënave është supozuar të jetë një përzjerje e disa shpërndarjeve. Ideja kryesore e metodave “density-based” është se për çdo instancë të një grupi zona afër një rrezeje të caktuar (EPS) duhet të përmbajë një numër minimal instancash (MinPts). Këto metoda identifikojë grupimet dhe shpërndarjen e parametrave të tyre. Ideja është që të vazhdojë të rritet një grup për aq kohë sa dendësia (numri i objekteve ose pika e të dhënave) tejkalon disa pragje. Më gjerësisht, në afërsi të një rrezeje të caktuar duhet të përmbajë të paktën një numër minimal të objekteve. Algoritmi DBSCAN (Density-Based Spatial Clustering of Applications with Noise) [6] zbulon grupet dhe format arbitrare dhe është efikas për bazat e mëdha të të dhënave. Ky algoritëm gjen një numër të grupimeve duke filluar nga densiteti i shpërndarjes së vlerësuar të nyjeve përkatëse. Ai nuk kërkon që ne të dimë numrin e grupimeve në të dhënat apriori dhe gjejmë grupimet në formë arbitrare. Me anë të këtij algoritmi gjejmë edhe grupimet të rrethuar plotësisht nga (por jo e lidhur me) një grup tjetër. DBSCAN kërkon vetëm dy parametra dhe është kryesisht i pandjeshëm për renditjen e pikave në bazat e të dhënave.

Algoritmi OPTICS (Ordering Points to Identify the Clustering Structure) [6] është proceduralisht identik me algoritmin DBSCAN. OPTICS është ndërtuar mbi DBSCAN duke futur vlerat që janë ruajtur me çdo objekt të të dhënave; një përpjekje për të kapërcyer nevojën për të furnizuar parametrat hyrës (input). Në mënyrë të veçantë, referohet si distancë bazë, vlera më e vogël *epsilon* që e bën një të dhënë në objekt të kundërshtojë një objekt bazë, dhe të arrijë aftësinë-distancë, e cila është një kufi ose njësi matëse e distancës midis dy objekteve të caktuara.



### **3.1.4 Metodat e grupimit të bazuara në model (model-based)**

Këto metoda bëjnë optimizimin e të dhënave dhe disa modeleve matematikore. Ndryshe nga grupimi konvencional, i cili identifikon grupet e objekteve, metodat e grupimit të bazuara në model (model-based) [2,4] gjejnë përshkrime karakteristike për secilin grup, ku secili grup përfaqëson një koncept apo klasë. Metodatat më të përorura janë pemët e vendimit dhe rrjetet neurale.

Në një pemë vendimi, të dhënat përfaqësohen nga një pemë hierarkike, ku secila gjethe i referohet një koncepti dhe përmban një përshkrim probabilistik të atij koncepti. Disa algoritme prodhojnë pemë klasifikuese për të përfaqësuar të dhënat. Algoritmi COBWEB [6] supozon se të gjithë atributet janë të pavarura. Ai bën që të arrijmë një parashikueshmëri të lartë të vlerave të variablave nominale, duke pasur parasysh një grup. Ky algoritëm nuk është i përshtatshëm për grupimin e të dhënave, për baza të dhënash të mëdha. COBWEB përdor një njësi matëse orientuese të vlerësimit për të udhëhequr ndërtimin e pemës të quajtur kategoritë e shërbimeve. Ai siguron bashkimin dhe ndarjen e klasave të bazuara në kategorinë e shërbimeve, kjo lejon që COBWEB të jetë në gjendje të bëjë një kërkim dy-drejtues.

Rrjetet neurale [4]: Kjo metodë përfaqëson çdo grup nga një neuron apo "prototip". Të dhënat input përfaqësohen edhe nga neuronet, të cilat janë të lidhura me neuronet prototip. Një algoritëm shumë i përdorur për grupimin është SOM (Self-Organizing Map). Ky algoritëm ndërton një rrjet me një shtresë dhe është i dobishëm për vizualizimin e të dhënave me dimension të lartë në hapësirën 2D ose 3D.


## **4. Rezultatet eksperimentale**

Për të kryer këtë studim kemi përdorur softuerin Weka duke u nisur nga qasja dhe familjariteti në përdorim që ajo ka. Paketa softuerike Weka ka programe të ndryshme për teknika dhe algoritme të ndryshëm. Në tabelën 1 është paraqitur një krahasim i rezultateve të algoritmeve të aplikuara mbi të dhënat tona në Weka.

Emri i algoritmit	Nr. i grupeve	Instanca të grupuara	Nr. i iteracioneve	Koha e ndërtimit të një modeli	Log Likelihood	Instanca të pa grupuara
EM	3	0: 33(38%) 1: 12(14%) 2: 42(48%)		0.47 sekonda	-7.60647	0
COBWEB	122	1: 1(1%) 68: 4(5%) 120: 5(6%)		0.04 s		0
DBSCAN	3	0: 6(26%) 1: 11(48%) 2: 6(26%)		0.03 s		64
Hierarchical Clusterer	2	0: 86(99%) 1: 1(1%)		0.05 s		0
Make Density Based Clusterer	2	0: 35(40%) 1: 52(60%)	5	0.02 s	-7.89747	0
K-Mean	2	0: 38(44%) 1: 49(56%)	5	0 s		0

**Tabela 1.** Krahasimi i rezultateve të algoritmeve të aplikuara në Weka

Megjithatë, në këtë studim kemi përdorur algoritmin K-mean, i cili është një algoritëm që zbatohet në metodat ndarëse të grupimit data mining. Ky algoritëm është përdorur sepse ai siguron një rezultat të qartë dhe të lehtë për t'u



**Fig. 2:** Algoritmi K-mean

interpretuar. Ndërtimi i modelit është bërë duke modifikuar vlerat e parametrave dhe ky algoritëm grupon të dhënat mbi krimin në më pak kohë për të ndërtuar modelin. Ne konvertuam të dhënat tona në formatin CSV. Algoritmi K-mean u zbatua në këto të dhëna. Vizualizimi dhe ajo çfarë doli nga ky algoritëm paraqiten në figurat 2 dhe 3.



**Fig. 3:** Rezultati i algoritmit K-mean

Numri i grupimeve është dy (0 dhe 1) dhe instancat janë grupuar sipas kësaj skeme:

Në “clusterin” 0 janë grupuar 38 instanca ose 44%, ndërsa në “clusterin” 1 janë grupuar 49 instanca ose 56%. Numri i iteracioneve është 5. Sipas rezultateve të algoritmit K-mean personat që kryejnë më shumë krime janë pa punë dhe me arsim të mesëm.

Zbatimi i këtij algoritmi ka grupuar të dhënat mbi krimin në disa nivele të krimit (të lartë, të mesëm dhe të ulët) në më pak kohë për të ndërtuar një model, saktësisht 0 sekonda. Duke e krahasuar këtë kohë me kohën e algoritmeve të tjerë për të njëtin numër instancash (87), ky algoritëm ka kohën më të vogël, pra është më i shpejtë.

## 5. Konkluzione

Rezultatet e eksperimenteve të kryera në këtë studim duke përdorur metodat e grupimit data mining kanë zbuluar se këto metoda janë të zbatueshme në parandalimin e krimit.

- Metoda e grupimit K-mean grupon të dhënat mbi krimin në disa nivele të krimit (të lartë, të mesëm dhe të ulët) në më pak kohë për të ndërtuar një model, krahasuar me metodat e tjera.

- Kjo teknikë tregon rezultate premtuese për problemin e parandalimit të krimit sepse shkalla e saktësisë është e lartë në eksperimentet tona.

- K-mean krijon grup (cluster) me cilësi kur përdorim dataset të mëdha.

- Algoritmi i grupimit k-mean është i lehtë në interpretim, i thjeshtë në zbatim dhe në krahasim me metodat hierarkike dhe me metodat e tjera është më i shpejtë kur kemi një numër të madh variablash (instancash).

- Algoritmet e grupimit të bazuar në dendësi nuk janë të përshtatshëm për të dhëna me mospërputhje të lartë në dendësi.

Metodat e grupimit data mining japin një kontribut të madh në identifikimin e fushave të krimit dhe karakteristikave të autorëve të cilët janë të përfshirë në nivele të ndryshme të krimit. Ajo që është më e rëndësishme është se metodat e grupimit data mining përdoren në procesin e vendimmarrjes. Shtimi i këtyre metodave në bazat e të dhënave të specializuara (rreth krimit) bën të mundur që të ketë një sistem që të funksionojë si një ekspert në kriminalistikë. Në këtë mënyrë këto metoda kontribuojnë në parashikimin për mundësinë e ndodhjes së krimit dhe si rezultat në parandalimin e tij.

## BIBLIOGRAFIA

[1] Bruin, J.S. , Cocx, T.K. , Kosters, W.A. , Laros, J. and Kok, J.N. (2006) Data mining approaches to criminal career analysis.

[2] J. Han, M. Kamber and Jian Pei (2011) Data Mining: Concepts and Techniques, Morgan Kaufmann.

[3] Abraham, T. and de Vel, O. (2006) Investigative profiling with computer forensic log data and association rules.

[4] Maimon Oded, Rokach Lior(2010) Data mining and knowledge discovery handbook Chapter 15 clustering method <http://www.ise.bgu.ac.il/faculty/liorr/hbchap15.pdf>.

[5] Prajwala T R1, Sangeeta V I “Comparative Analysis of EM Clustering Algorithm and Density Based Clustering Algorithm Using WEKA tool.” (2014).

[6] Sharma,N. , Bajpai,A., and Litoriya, R. 2012.Comparison the various clustering algorithms of weka Tools, *International Journal of Emerging Technology and Advanced Engineering*, Volume 2, Issue 5, May 2012.

[7] Z. Huang. 1998 “Extensions to the  $k$ -means algorithm for clustering large data sets with categorical values”. *Data Mining and Knowledge Discovery*, 2:283–304.

[8] Jinxin Gao, David B. Hitchcock “James-Stein Shrinkage to Improve K-means Cluster Analysis University of South Carolina,Department of Statistics November 30, 2009.

[9] Han J. and Kamber M.: “Data Mining: Concepts and Techniques,” Morgan Kaufmann Publishers, San Francisco, 2000.

[10] Sapna Jain, M Afshar Aalam and M N Doja, “K-means clustering using weka interface”, Proceedings of the 4<sup>th</sup> National Conference; INDIACOM-2010.

[11] Jiawei Han and Micheline Kamber, “Data Mining: Concepts and Techniques”, Morgan Kaufmann Publishers,second Edition, (2006).

[12] Manish Verma, Maulay Srivastava, Neha Chack, Atul Kumar Diswar and Nidhi Gupta, “A Comparative Study of Various Clustering Algorithms in Data Mining”, *International Journal of Engineering Research and Applications (IJERA)* Vol. 2, Issue 3, May-Jun 2012, pp.1379-1384.

## SUMMARY

Data mining it is known as the process of detecting hidden patterns and relationships in data recorded in a computer. It also allows us to make accurate and reliable forecasts of future events, based on the identification and characterization of these models on historical data. The main use of data mining is to reveal information that no one knew before.

In this paper we will study data mining clustering methods that can be used for analyzing the recorded data about the crimes committed. We will identify the most appropriate data mining clustering method to analyze the data collected from sources specialized in crime prevention by comparing theoretically and practically since their implementation on the data collected in detention facilities in Tirana and Kavaja. The data that will be analyzed are data related to the area where crime occurs and people(s) who commit this crime. Some features of these data are: age, gender, employment status, person(s) with whom they live, the time of occurrence of the crime, type of crime, crime place, etc. Methods will be applied on these data to determine their effectiveness in detecting and preventing crime.

We expect that the data mining clustering method will contribute in identifying the characteristics of areas where crimes occur, as well as the characteristics of persons who commit specific crimes. In this way these methods will contribute to the predictions on the possibility of occurrence of the crime and as a result in its prevention.

# ASPEKTE TË MODELIT TË MENAXHIMIT TË EMIGRACIONIT “TOLERANCË DHE LAICIZËM” NË FRANCË

Leonora ZOTO, PhD  
SHLP “Logos”

## 1. Hyrje

Francia është një shtet i cili historikisht ka pritur emigrantë që në periudhën e pasluftës II Botërore. Emigrantët e këtij vendi kryesisht vijnë nga ish-kolonitë e saj në vendet arabe, në Afrikë e më gjerë. Me kalimin e viteve këtyre komuniteteve iu bashkuan dhe grupe të tjera më të vogla si të ardhurit nga Turqia, Portugalia, Italia.

Francia është një komb-shtet, që është konsideruar si një shtet besnik ndaj parimeve të barazisë dhe identitetit kombëtar francez, i cili refuzon mundësinë e diversitetit kulturor. Krahasuar me vendet e tjera evropiane, Francia ka traditë të gjatë si një shtet me emigracion. Megjithatë, pavarësisht nga historia e gjatë e emigracionit, kornizës franceze i mungon ideologjia për menaxhimin e pluralizmit etnik. Në sistemin francez, nuk është e lehtë për emigrantët të fitojnë nenshtetësinë, e cila në parim fal barazi të plotë të të drejtave.

Parimet universale të republikanizmit, megjithatë mbështesin vetëm barazinë e individit, dhe kërkojnë që të gjitha veçoritë individuale (të tilla si feja) të jenë të kufizuara në sferën private. **Kështu, të ardhurve (emigrantëve) u lejohej të bashkohen me komunitetin vetëm nëse ata janë në përputhje me rregullat e politikës dhe janë të gatshëm t’i përmbahen kulturës kombëtare të vendit pritës.** (Abdel-Hady, Dalia 2006,)

Modeli francez i menaxhimit të diversitetit kulturor dhe të emigracionit në veçanti ka ndryshim nga ai i vendeve të tjera që kanë qenë vende pritëse të emigracionit. Ka veçoritë e veta që e karakterizojnë dhe mbi të gjitha është toleranca kulturore e fetare që u atribuoi të ardhurve. Nëse modeli francez shihet në teori është vërtet për t'u vlerësuar dhe për t'u marrë shembull nga vendet e tjera. Por e rëndësishme mbas kaq e kaq vitesh politike emigracioni është të shihet se si kjo teori me parimet e saj më të larta univiersale të të drejtave të njeriut, u vu në praktikë, cilat ishin rezultatet e saj në të vërtetë në bashkejetesën e të "ndryshmes" me "homogjenen" franceze. Për të përmbushur qëllimin e këtij studimi do të na duhet të bëjmë një analizë fillimisht të politikës franceze të integritit të emigrantëve, duke nxjerrë në pah karakteristikat më të forta të saj, do të bëjmë një udhëtim historik për të parë si ka evoluar që prej Luftës II Botërore deri në ditët e sotme, dhe së treti atë që përbën edhe tezën e këtij studimi: **Si u aplikua në praktikë modeli francez i menaxhimit të emigracionit dhe cilat janë realisht rezultatet e tij.** Për të përmbushur këtë analizë do të na duhet të analizojmë faktorë përbërës të bashkejetesës midis francezëve dhe emigrantëve dhe të përditshmërisë së emigranteve në Francë siç janë: ambientet dhe zonat ku banojnë, arsimimi i fëmijeve, përqindjet e punësimit/të papunësisë, gjendja e tyre ekonomike, përkushtimi që kanë ndaj fesë në jetën private etj.

Materialet dhe bibliografia për realizimin e këtij studimi janë marrë nga faqe zyrtare të qeverisë franceze, nga studime të kryera nga institute prestigjioze në Francë dhe nga artikuj të ndryshëm analistësh, që kanë shprehur idetë e tyre mbi realitetin francez të menaxhimit të emigracionit.

## 2. Menaxhimi i çështjeve të emigracionit

Dallimi ndërmjet sferës private dhe publike është karakteristikë e këtij modeli, i cili vendos dallimet kulturore në sferën private, ndërsa shteti mbron barazinë e të gjithëve dhe unitetin e kombit francez. Modeli i menaxhimit të emigrantëve dhe diversitetit kulturor gjen legjitimitetin e tij te natyra laike e shtetit francez, e cila është e bazuar në sekularizmin, i cili nënkupton pavarësinë nga feja dhe



përmban parimet themelore të lirisë, barazisë dhe vëllazërisë (Alain Touraine, 1997, 290).

Shteti republikan francez, i ka themelet e tij në historinë politike të ideve të Jean Jacques Rousseau deri te Francois Miterand, te jakobinët e vitit 1793, demokratët e 1848, Komuna e Parisit etj. Në këtë shqyrtim, parimi qendror i sovranitetit popullor lidh rolin krijues të kontratës sociale me vizionin individualist dhe universal të ekzistencës njerëzore, e cila shkatërron forcat e ndërmjetme, si fuqitë e parapërcaktuara dhe monarkitë e ligjit hyjnor. Ideja republikane, siç është paraqitur nga Touraine i përket lëvizjes së madhe të zëvendësimit të autoritetit fetar të pushtetit shekullor politik, i cili tronditi themelet e fuqive absolute të regjimit të vjetër. Ideja e demokracisë në përbërjen republikane të shtetit modern francez kombinon parimet e lirisë, barazisë dhe vëllazërisë, sovranitetin e popullit, shtetësinë, dhe idenë e të drejtave të njeriut. Përbërja e shtetit republikan francez kombinon shtetësinë me individualizmin dhe demokracinë me laicizmin dhe është më shumë se një ideologji, ishte frymëzim për të gjitha institucionet dhe praktikatat politike.

Edhe pse ka pasur interpretime të ndryshme të republikanizmit francez, parimi themelor është zhdukja e të gjitha dallimeve dhe asimilimi i tyre në një kulturë të vetme legjitime. Kjo ideologji e 'rreptë' republikane, në praktikë, mori formën e asimilimit të dallimeve kulturore për të krijuar barazi. Sekularizmi dëshiron të forcojë këtë barazi në sferën publike në lidhje me fenë, përmes eliminimit të të gjitha "simboleve" fetare nga institucionet publike, për të kapërcyer të gjitha grupet fetare, një prirje që është përforcuar nga ndarja kishës nga shteti në vitin 1905. Ideja republikane vendos arsimin në qendër të programit të integritit, pra përmes një arsimit laik, fëmijët edukohen që të jenë qytetarë të barabartë. Shkolla ka qenë gjithmonë faza e parë në krijimin e identitetit kombëtar të fëmijëve dhe integrimin e tyre.

Bazuar në një qasje teorike, bashkëjetesa në një shoqëri multikulturore ndan jetën publike nga ajo private nën të njëjtat ligje dhe të gjithë mund të besojnë e të jetojnë si dëshirojnë. **Kjo është forma e menaxhimit të multikulturalizmit e quajtur ndryshe: tolerancë dhe laicizëm.**

Nëse bëjmë një introspeksion në rrjedhën e menaxhimit të emigracionit në Francë praktikatat politike kanë ndryshuar formë disa herë. Në periudhën e

pasluftës, emigrantët u trajtuan vetëm si punëtorë. Në vitet 70 ' ku emigracioni filloi të jetë një problem i madh social u vunë re politika të ndarjes kulturore. Menjëherë pas kësaj, praktikat politike filluan të priren më shumë drejt asimilimit dhe kjo vazhdoi për një kohë të gjatë. Gjatë viteve 1990 praktikat ndryshuan dhe kanë marrë formën që kanë tani, pra **si politikë liberale e integritit**.

Koncepti francez i integritit i bindet një logjike të barazisë, që nuk e njeh ekzistencën e minoriteteve. Parimet e identitetit dhe barazisë që burojnë nga Revolucioni Francez dhe Deklarata e të Drejtave të Njeriut dhe të Qytetarit theksojnë barazinë e qytetarëve para ligjit, pavarësisht nga origjina e tyre, raca, feja apo klasa sociale.

### **3. Periudhat historike të politikës së emigracionit në Francë**

Historikisht janë konstatuar tri periudha të politikës dhe strategjisë franceze mbi emigracionin. Periudha e parë 1944-1974, e dyta 1974-2005, dhe e treta 2005-deri më sot.

#### **- Periudha e parë 1944-1974**

##### **(Les trentes glorieuses) Tridhjetë vjet lavdi**

Emigracioni i kësaj periudhe ka ndikuar pozitivisht dhe në mënyrë të konsiderueshme për rritjen ekonomike të vendit, mbushjen e boshllëqeve të tregut të punës, zgjidhjen e problemit demografik të vendit etj. Qeveria franceze deri në atë kohë, edhe pse fillimisht kishte shmangur sistemin e punëtorëve të huaj, në fakt dëshironte të mbante emigracionin për një kohë të pacaktuar të pasigurt, pra, për aq kohë sa të ishte e nevojshme për ekonominë franceze pa hapur çështje të tjera integriti ose jo në shoqëri. Fakt është që të gjithë emigrantët e kësaj periudhe ishin meshkuj beqarë pa preokupime dhe kjo e bënte më të thjeshtë punën për francezët. Fakti është se kjo periudhë ishte tridhjetë vitet e lavdisë, "les trentes glorieuses për Francën, por ne nuk mund të themi se kjo ishte e njëjtë për emigrantët.

Ndoshta Franca kërkoi punëtorë, por anashkaloi faktin që atje shkuan njerëz. Perceptimi i emigrantit si person pa të drejta ka qenë dominues gjatë kësaj periudhe.

#### **- Periudha e dytë 1974 - 2005**

Në këtë periudhë emigracioni nuk është më vetëm një fenomen i lidhur me ekonominë dhe tregun e punës, por është transferuar në një kontekst shoqëror, duke e kthyer atë në një fenomen të madh shoqëror që kërkon zgjidhje dhe menaxhim. **Konflikti social fokusohet në çështjen e integritit të emigrantëve dhe mënyrën e zbatimit të tij.**

Rrjedha migratore nuk varet nga kërkesat e punëdhënësve, por nga kërkesat e vetë emigrantëve dhe të drejtave të tyre gjithmonë duke u bazuar në atë që kushtetuta franceze vendos mbi çështjet e bashkimit familjar dhe azilit.

#### **- Periudha e tretë 2005 - deri më sot**

Ndryshimi kryesor në krahasim me periudhën e mëparshme është se emigrantët nuk janë më të përkohshëm, ata janë vendosur në Francë, tashmë, kanë krijuar familjet e tyre dhe fëmijët e brezit të dytë e të tretë të emigrantëve janë tashmë nëpër shkollat franceze. Kjo e detyron qeverinë franceze për të ndërmarrë një proces të formimit të një politike më të vendosur për sa i përket emigracionit.

Fakti është se, për sa i përket menaxhimit të migrimit, shteti francez konkretisht është fokusuar në integrimin e njëanshëm të emigrantëve në mënyrë që ata të gëzojnë atë që ofron ligji i përbashkët.

Qëllimi i politikës, nga ana tjetër, është për të krijuar një politikë të mirëfilltë emigracioni, bazuar në interesat e Francës dhe vendeve të origjinës dhe në promovimin e emigracionit ekonomik me zgjedhje, i cili duhet të shoqërohet me kontroll më të madh të punës së paligjshme.

#### **4. Si u zbatua në praktikë modeli francez i menaxhimit të emigracionit dhe cilat janë realisht rezultatet e tij.**

Per të realizuar këtë çëshje të rëndësishme duhet të fokusohemi te zonat ku banojnë familjet e emigrantëve, si jetojnë në jetën e përditshme, si ndihen në tregun e punës kryesisht brezi i ri, si është organizuar sistemi arsimor, lidhjet e tyre me fenë islame etj.

##### **• Zonat e banimit**

Praktikë e qeverisë franceze qysh në periudhën e pasluftës ka qenë që emigrantët të banonin në zona të veçanta - periferi ose “banlieu”<sup>1</sup>, siç quhen në frëngjisht, larg qendrave të qyteteve, krijuan dashje pa dashje zona me përqendrim të lartë banorësh të së njëjtës kombësi ose të përfarët, që flasin pak a shumë të njëjtën gjuhë dhe kanë të njëjtat zakone p.sh., emigrantët me origjinë afrikano-veriore banojnë në të njëjtën zonë. Fillimisht kjo ishte një zgjidhje e mirë, sepse këto zona u ndërtuan nga vetë emigrantët për ta që në vitet 50, por më pas ajo që nuk u parashikua si duhet ishte krijimi i fenomenit të getoizmit në këto zona.

Edhe pse e drejta e strehimit është garantuar, ajo që nuk është e garantuar është përmirësimi i kushteve të jetesës. Zonat në të cilat banojnë emigrantët vazhdojnë të mbeten jashtë qytetit, në të cilat përqindja e familjeve emigrante sa vjen e rritet. Politikat qeveritare nuk kanë bërë asgjë për të ndryshuar gjendjen. Te rinjtë ndihen jo vetëm qytetarë të kategorisë së dytë, por dhe të braktisur në këto geto. Ajo që vështirëson gjendjen është niveli ekonomik i këtyre familjeve. Nga ana tjetër, për t’u diskutuar qëndron shpërndarja e banesave sociale. Ato u

---

##### **1. France. Conseil d’analyse économique**

*Ségrégation urbaine et intégration sociale* ; rapport, Jean-Paul Fitoussi, Éloi Laurent et Joël Maurice ; commentaires, Jacques Freyssinet, Béatrice Majnoni d’Intignano; compléments, Salima Benhamou, Thierry Debrand, Dominique Dujols... [et al.]. Paris, La documentation Française, 2004. 327 p. (Les rapports du Conseil d’analyse économique:

<http://lesrapports.ladocumentationfrancaise.fr/BRP/044000057/0000.pdf>.

adresohen kryesisht emigrantëve. Ndarja e tyre bëhet gjithmonë me bazë të një hierarkie dhe, si rezultat, kemi përqendrimin në zona të caktuara të familjeve me karakteristika të ngjashme etnike e kulturore në kushte të njëjta banimi. Praktika e përgjithme e tolerancës dhe e liberalizmit, që karakterizon modelin francez, është që ata emigrantëqë tregohen të zotë, të aftë për t'u përshtatur, shteti francez, demokracia franceze u jep mundësinë të integrohen në shoqëri me të njëjtat kushte, të tjerët duhet të mundohen për të arritur nivelin dhe nëse jo, le të mjaftohen me jetesën në banlieu.

- **Përqindjet e punësimit/papunësisë**

Bazuar në shifrat e vitit 2004, emigrantët përbëjnë 8.6% të fuqisë punëtore dhe proporcionalisht 7.6% të popullsisë së përgjithshme. Shkalla e tyre e punësimit është identike me atë të francezëve. Në anën tjetër, normat e punësimit të emigrantëve burra janë më të larta se ato të francezëve (65% vs 62%). Në kontrast me gratë në rastin e të cilave vetëm 46% e grave emigrante janë të punësuar në krahasim me 50% të francezeve. Bazuar në të njëjtat elemente të INSEE, emigrantët përbëjnë vetëm 8% të fuqisë punëtore aktive të kualifikuar.

Gjithashtu nga i njëjti burim është vlerësuar se shkalla e papunësisë për emigrantët është më e lartë sesa te francezet. Në mënyrë të veçantë, vetëm 9% e francezëve janë të papunë, ndërsa kjo përqindje për emigrantët prek pothuajse dyfishin 17%. Për gratë emigrante përqindja rritet në 20%.

Nga të dhenat e vitit 2001, për femrat në moshën **15-24**, 22% e francezeve janë të papuna në krahasim me 34% të bashkëmoshatareve të tyre me origjinë të huaj. Ndërsa për meshkujt, kjo përqindje varion nga 16% për francezët në 27% për emigrantët. Në përgjithësi moshë nga 15-24 vjeç është më e prekura nga papunësia 20 vitet e fundit, përqindja e tyre lëviz nga 27% -50%.

Në tregun e punës brezi i dytë dhe tashmë i tretë i emigrantëve me origjinë arabe dhe jo vetëm, është në gjendje kritike në krahasim me bashkëmoshtarët e tyre vendas. Gjendja e tyre nuk ndryshon edhe kur niveli i tyre rritet. Ata mund të klasifikohen në tre kategori: të punësuar, të punësuar në vende-trajnimi dhe të papunë. Vitet e fundit janë vënë në zbatim një sërë programesh për punësimin e të rinjve të këtij grupi. Ata kanë të njëjtat të drejta me të rinjtë vendas për sa

i përket pjesëmarrjes së tyre në këto programe, por statistikat tregojnë se kur behet fjalë për punësim të vërtetë, përqindjet zvogëlohen.

Për kategorinë e dytë moshore **25-39**, përqindja e papunësisë është tri herë më e lartë se sa ajo e francezëve apo e shtetasve të tjerë evropianë.

Fitimi i nënshtetësisë francize nuk i heq të gjitha pengesat në tregun e punës. E vërteta është se ata të rinj, prindërit të cilëve janë të dy emigrantë, janë më të prirur ndaj papunësisë. Juridiksioni u ofron të drejta të barabarta të rinjve me prejardhje nga familje emigrantësh, por realiteti është më i komplikuar, sepse shpeshherë bien viktima të stereotipeve dhe paragjytimeve në tregun e punës e më gjerë.

Një faktor tjetër që ndikon në statusin në tregun e punës së tyre është dhe niveli i arsimimit të tyre. Nga dy kërkime që janë bërë nga INSEE, INED dhe CEREQ në vitin 2005 është konstatuar se: vetëm 8,9% të tyre kanë diplomë universitare, 45,9% nuk kanë diplomë të shkollës së mesme apo ndonje diplomë tjetër relevante. Por gjithsesi është konstatuar përmirësim i këtyre të dhënave pasi në vitin 1990, vetëm 3,2% deklaronte se kishte një diplomë arsimit të mesëm, dhe vetëm 5,2 kishte diplomë universitare. Por gjithsesi të rinjtë emigrantë me diplomë universitare kanë 3-4 herë më të lartë përqindje papunësie se te shtetasve evropianë të te njëjtës grupmoshe.

#### • **Arsimi**

Në të shkuarën e largët detyrë e shkollës ka qenë të formojë të krishterë të mirë, ndërsa në ditët e sotme detyrë e saj është të edukojë qytetarë. Shkolla është një miniaturë e botës sociale, aty ku shprehen më dinamikisht dallimet sociale në format më të njohura të tyre.

Bazuar në një qasje teorike, bashkëjetesa në një shoqëri multikulturore ndan jetën publike nga ajo private nën të njëjtat ligje dhe të gjithë mund të besojnë e të jetojnë si ata dëshirojnë. **Kjo është forma e menaxhimit të multikulturalizmit e quajtur ndryshe dhe: tolerancë dhe laicizëm.**

Reflektimi i kësaj qasjeje është i dukshëm në sistemin arsimor të Francës. Pavarësisht përpjekjeve për të ruajtur qëndrimin neutral ndaj pakicave, shkolla franceze është përballur vazhdimisht me kërkesat për njohjen e pakicës kulturore dhe elementeve fetare. Kushtetuta franceze që nga viti 1792, i njeh çdo personi

të drejtën për të zgjedhur Perëndinë e tij, besimin e tij, por nuk lejon që të marrë pjesë në shkollë një program që do të shkatërrojë barazinë e prioritetëve sociale, dhe t'u japë doktrinave të ndryshme përparësi (Coryse Ciceri, 1998).

Ligji për arsimin e detyruar i 28 marsit 1882, urdhëroi shkollën për të përqafuar të gjithë fëmijët, pavarësisht origjinës, sipas parimit të barazisë. Sipas Ligjit të 9 gushtit, 1936, "Arsimi fillor është i detyrueshëm për fëmijët e të dyja gjinive, me origjinë franceze apo jo."

Një pikë kthese filloi gjatë viteve shtatëdhjetë, ku, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar u manifestua nevoja për zhvillim të një politike të integritit të fëmijëve me origjinë të huaj si pasojë e ardhjes masive të tyre për shkak të bashkimit familjar.

Pas vitit 1974 ai u bë ndryshim i madh i politikave mbi emigracionin, të cilat i dhanë zyrtarisht fund emigrimit ekonomik. Megjithatë, qëndrimi i shtetit ishte i pandryshuar. Shkolla mbetet një vend ku pabarazitë sociale dhe etnike të fëmijëve duhet të zhduken dhe të hapë rrugën për të ruajtur barazinë e mundësive, socializimin dhe progresin social. Që nga fillimi i viteve tetëdhjetë, shkolla ka përjetuar disa ndryshime në organizimin e saj (decentralizimi, krijimi i zonave prioritare arsimore -ZEP). Prania e të huajve në sistemin shkollor ka arritur nivele të larta në mesin e viteve tetëdhjetë, me pothuajse 1,1 milion nxënës, ose rreth 9% e totalit. Në vitet 1990-1991 pësoi një rënie, në fillim ngadalë, por më pas u përshpejtua (nga viti 1995). Në shtator të vitit 1998, më shumë se 11.8 milionë nxënës, pra 5.8% të tyre kanë shtetësi të huaj. Në vitin 2010 në arsimin fillor, numri i të huajve është tri here më pak se në vitin 1975 dhe pothuajse dy herë më pak se në vitin 1984.

Disa faktorë, efektet e kombinuara të të cilëve mund të shpjegojnë këtë ndryshim, janë përgjegjës për këtë zhvillim: ulja e fluksit të studentëve të rinj me kombësi të huaj dhe rritja e normës së fitimit të kombësisë franceze.

Për sa i përket aspekte të modelit të menaxhimit të emigracionit "Tolerancë dhe laicizëm" në Francë faktorit psikologjik të nxënësve në zonat e emigrantëve, ata, që nga shkolla fillore, u janë bashkuar parimeve të shkollës ndërkohë që përjetojnë një ndjenjë padrejtësie dhe një vetëdije në rritje të dobësive të tyre kur përballen me kritikën negative. Duket se djemtë kanë treguar një ndjenjë ndërgjegjësimi intuitiv të këtyre formave të diskriminimit ndaj tyre. Disa prej fëmijëve janë mobilizuar dhe marrin pjesë në aktivitetet shkollore dhe mësimet,

por shumica e saj është e izoluar, me pasoja të rënda jo vetëm për përparimin e tyre në shkollë, dhe më vonë në shoqëri. Në mënyrë të veçantë, ndjenja e përjashtimit ka ndikuar te të rinjtë që të lënë shkollën pa asnjë kualifikim, duke pasur të ngulitur në ndërgjegje se kërkimi i punës do të jetë zhgënjyes.

## **5. Përkushtimi ndaj fesë islame dhe toleranca fetare franceze**

Franca ka një marrëdhënie të veçantë me popullsinë myslimane, dhe për shkak të kaluarës së saj historike. Marrëdhëniet shoqërore midis francezëve dhe emigrantëve myslimanë të brezit të parë dhe të dytë - të cilët janë kryesisht algjerianë - duket të jenë të ndikuara nga një përplasje nëntokësore e kulturave. Popullata myslimane në Francë përbëhet kryesisht nga arabë, por ka turq, afrikanë, pakistanezë dhe francezë të cilët kanë përqaftuar Islamin. Për këtë arsye, është e papërshtatshme për të folur për Islamin dhe komunitetin mysliman sikur të ishte një njësi e vetme, pasi qëndrimet dhe perceptimet e integritimit ndryshojnë nga një grup në tjetrin. Për shembull, në këtë kontekst tek të rinjtë nga Algjeria është vërejtur humbja e gjuhës amtare dhe një tendencë drejt përdorimit të gjuhës frënge. Llogaritjet statistikore të bëra në lidhje me komunitetin mysliman nuk kanë marrë parasysh ndryshueshmërinë etnike, pasi është konsideruar si faktor diskriminues. Përveç këtyre në një sondazh mbi emigracionin në Francë është vënë re se algjerianët dhe marokenët e fituan me më pak procedura shtetësinë franceze, ndërsa turqit, pakistanezët dhe afrikanët (kryesisht nga Mali), kanë ruajtur mitin e kthimit dhe të traditave kombëtare e familjare.

Organizimi i myslimanëve në Francë, lë hapësirë për përmirësim. E vetmja formë e organizimit që mund të përmendet është Xhamia e Madhe e Parisit, dhe disa xhami të vogla në lagjet që veprojnë me pjesëmarrjen e shtetasve të të njëjtit grup etnik. Shumë herë në debate publike është argumentuar, se nuk janë komunitete islame, por komunitete etnike.

Gjithashtu, sa i përket gjuhës, nuk ka unitet në përvetësimin e gjuhëve amtare. Për më tepër, edhe pse gjuha klasike arabe mësohet në programet shkollore, është ende një gjuhë e huaj, e përdorur pak. Zakonisht në mjediset familjare



përdoret dialekti arab, por gjuha e komunikimit në transaksionet tregtare në mes grupeve dhe me francezët është gjuha frënge.

Megjithatë, në lidhje me praktikën fetare, shumica e emigrantëve nga Algjeria thonë që besojnë All-llahun, por nuk ndjekin praktikën fetare në jetën e tyre të përditshme. Vetëm 11% thonë se janë praktikantë të rregullt dhe 15% shkon rregullisht në xhami (6% për gratë). Në të kundërt, për emigrantët nga Afrika e zezë, 18% thonë se janë ateistë apo thjesht besimtarë pa ndjekur praktikën fetare, ndërsa 65% besimtarë praktikantë. Për më tepër, 82% e tyre respektojnë Ramazanin. Në vend të kësaj, kurdët, të cilët janë 99% myslimanë, pohojnë se i respektojnë më pak këto zakone. (Riva Kastoryano, 2004:1234-1255).

Komuniteti mysliman respekton kuadrin ligjor dhe politik për praktikën e ushtruar. Gjithashtu gëzon dhe të drejtat e njeriut dhe në këtë mënyrë mund të projektojë identitetin e vet fetar, stigmën dhe dëshirën për të mbajtur lidhjet familjare me vendet e origjinës. Si pasojë, rritja e prezencës islame sot në Francë - kryesisht për shkak të ndërtimit të disa xhamive dhe pranisë së grave me burka (shami) - në thelb është një realitet i vërtetë që nuk ka kthim mbrapa.

Duke iu referuar Islamit, duhet të ketë një dallim të qartë mes atyre që e quajnë veten myslimanë, sepse ata janë pasues të Islamit dhe atyre që e quajnë veten myslimanë, sepse janë arabë.

Është vënë re (John Harles, 2005, 36-38), se ka tre nivele të përcaktimit të popullsisë myslimane: i pari është identiteti etnik, përcaktuar nga vendi i lindjes dhe gjuhës së origjinës, i dyti është feja dhe i treti është kriteri i shtetësisë. Gjeneratat e reja kanë qenë të prirura që, për të hequr mitin e kthimit, thyen lidhjet me vendin e origjinës së prindërve të tyre. E identifikojnë veten si arabë dhe jo si myslimanë francezë.

Analistët thonë se janë tre burimet e frymëzimit dhe ndikimit për këto komunitete. Së pari, predikuesit e Islamit që vijnë nga jashtë nganjëherë me ide fundamentaliste, shteti francez që kërkon të ketë kontakte me komunitetin që do të lejojë atë për të kontrolluar islamizimin dhe një elitë të integruar me origjinë arabe, që dëshiron të behet ndërmjetës midis shtetit dhe komunitetit. Për Islamin, të rinjtë, myslimanë ndryshojnë shumë nga prindërit e tyre. Njohuritë teologjike, që u janë transmetuar, në radhë të parë nga familja, janë të dobëta. Marrin pjesë rrallë në vendet e adhurimit dhe praktikës dhe pothuajse tregojnë të njëjtën indiferencë ndaj fesë po ashtu si francezët e se njëjtës moshë.

Zakonisht të rinjtë zhvillojnë një lloj tjetër feje ne jetën e përditshme, e cila përfshin vetëm mbajtjen e shenjave të jashtme, për shembull një varëse, respektimin e Ramazanit etj., por mbajnë qëndrim kritik ndaj vlerave dhe qëndrimeve të caktuara të transmetuara nga parardhësit.

Përtej ekstremizmit, kemi dy qëndrime të rinjtë në lidhje me Islamin. Sipas të parit, Islami në një shoqëri të lirë mund të menaxhohet, sepse çdo individ është i lirë të besojë dhe së dyti, kjo liri është e mbrojtur nga shteti.

Në anën tjetër, të tjerët besojnë se shoqëria franceze dhe praktika e Islamit janë shumë konkurruese me njëra-tjetrën dhe arrijnë në përfundimin se është e pamundur të jesh një mysliman në Francë, për shkak se kërkesat e jetës së përditshme janë më të forta se feja (Coryse Ciceri, 1999: 10-15).

## 6. Konkuzione

Integrimi i emigrantëve në strukturën franceze ka qenë një proces i dyanshëm midis tyre dhe shoqërisë civile franceze. Qëllimi kryesor i praktikave integruese të politikës franceze ka qenë që të mbetet e pacenuar kultura dhe përditshmëria e vendit ndërkohë që, ata emigrantë që do të integrohen tërësisht, do të jenë ata që do të repektojnë parimet bazë të demokracisë franceze, dhe do të përshtaten në jetën sociale dhe ekonomike të vendit, duke ruajtur brenda mureve të “shtëpisë” veçoritë e tyre kulturore dhe fetare. Ky process i dyanshëm ishte dhe një thikë me dy presa, pasi nga njëra anë ato grupe njerëzish të cilët nuk patën cilësitë e duhura për të hyrë tërësisht në sistemin francez mbetën të izoluar në getot rreth Parisit apo rreth Marsejës, duke krijuar një ambient jo të shëndetshëm për gjithë shoqërinë franceze. Kjo gjendje në geto ka krijuar një rreth vicioz, varfërie papunësie, kriminaliteti që rrjedh nga izolimi dhe një ndjenjë padrejtësie tek të rinjtë. **Hendeku i praktikës së tolerancës dhe integritit pikërisht konstatohet aty tek “Banlieux”, sepse pikërisht ajo pjesë është pjesa më e brishtë e Francës së lavdishme. Pikërisht aty nuk u përbushën dot parimet e lirisë, vëllazërisë dhe barazisë. Në këtë kontekst, idealet republikane vepruan më shumë si mite. Premtojnë për të bashkuar në një mënyrë magjike, joreale dhe abstrakte atë që nuk mund të bashkohet në realitet,**

**ndërtuan imazhe artificiale, jo vetëm për të tashmen, por edhe të shkuarën** (Weviorka, 1998: 899).

Ky hendek i krijuar nuk mund të tejkalohet pikërisht për shkak të cilësive të përgjithshme kulturore etnike dhe individuale të grupeve të emigrantëve, por edhe nga disa karakteristika arrogante të sistemit francez individualist të integritit të këtyre grupeve.

Pasojat e këtij hendeku i kemi përjetuar dhe në nëntor 2005, me trazirat rreth Parisit, ku u dogjën institucione shtetërore si kopshte, rajone policie dhe prona private nga të rinj të revoltuar të periferive. Keta të rinj, siç deklaruan nëpër media, nuk ndihen francezë, janë thjesht parizienë, thjesht qytetarë të kësaj bote. Dhe pikërisht aty ku konsistenca shoqërore është më e dobët, aty munden edhe fuqitë e errëta, si fundamentalizmi i islamit politik të gjejnë mbeshtetës dhe të hedhin rrënjët për të keqen e tyre si masakra e nëntorit 2015.

## BIBLIOGRAFIA

1. Alain Touraine, «*Pourrons-nous vivre ensemble? Egaux et différents*», Fayard, Paris 1997 (B Ýññò).

2. Coryse Ciceri *Le foulard islamique a l'école publique : analyse comparée du débat dans la presse française et québécoise francophone (1994-1995)*. Faculté des sciences de l'éducation, Université de Montréal, Septembre 1998.

3. Virginie Guiraudon, «Immigration Policy in France», *U S-France Analysis, National Center for Scientific Research*, January 1, 2002.

4. Jane Freedman, «Secularism as a barrier to integration. The French Dilemma». *International Migration vol. 42 (3) 2004*.

5. Susan Ossman and Susan Terrio, *The French Riots: Questioning Spaces of Surveillance and Sovereignty, International migration, vol. 44 (2) 2006*.

6. Yvonne Yazbeck Haddad and Michael J. Balz, The October Riots in France: A Failed Immigration Policy or the Empire Strikes Back?, *International migration*, vol. 44 (2) 2006 ó. 23-34.

7. Riva Kastoryano, Religion and incorporation: Islam in France and Germany, *International migration studies*, vol. 38, number 3, Fall 2004 1234-1255.

8. Abdel-Hady, Dalia. «A Comparative Analysis of Immigration Policies in Canada, France and the United States» *Paper presented at the annual meeting of the American Sociological Association, Montreal Convention Center, Montreal, Quebec, Canada, Aug 11, 2006 Online <PDF>. 2006-10-05 [http://www.allacademic.com/meta/p105327\\_index.html](http://www.allacademic.com/meta/p105327_index.html)*

#### **France. Conseil d'analyse économique**

• *Ségrégation urbaine et intégration sociale* ; rapport, Jean-Paul Fitoussi, Éloi Laurent et Joël Maurice ; commentaires, Jacques Freyssinet, Béatrice Majnoni d'Intignano ; compléments, Salima Benhamou, Thierry Debrand, Dominique Dujols... [et al.]. Paris, La documentation Française, 2004. 327 p. (Les rapports du Conseil d'analyse économique:

<http://lesrapports.ladocumentationfrancaise.fr/BRP/044000057/0000.pdf>

#### **France. Cour des comptes**

• *L'accueil des immigrants et l'intégration des populations issues de l'immigration : rapport au Président de la République suivi des réponses des administrations et des organismes intéressés* [en ligne]. Paris, Direction des journaux officiels, 2004. 567 p. <http://lesrapports.ladocumentationfrancaise.fr/BRP/044000576/0000.pdf>

#### **France. Haut conseil à l'intégration**

• *Affaiblissement du lien social, enfermement dans les particularismes et intégration dans la cité* ; [La connaissance de

[l'immigration] : rapport au Premier ministre, juin 1997. Paris, La documentation Française, 1997. 120 p. (Collection des rapports officiels)

<http://lesrapports.ladocumentationfrancaise.fr/BRP/984000262/0000.pdf>

### **France. Haut conseil à l'intégration**

• *Liens culturels et intégration : rapport au Premier ministre*, juin 1995 ; Haut Conseil à l'intégration. Paris, La documentation Française, 1995. 163 p. (Collection des rapports officiels) Salle D – Publications officielles – [064.354 HCI I]

<http://lesrapports.ladocumentationfrancaise.fr/BRP/954126500/0000.pdf>

## SUMMARY

France is a nation-state that is considered a state loyal to the principles of equality and the French national identity which denies the possibility of cultural diversity. Compared with other European countries, France has a long tradition as a country of emigration. However, despite the long history of immigration, the French framework lacks management ideology of ethnic pluralism. In the French system, it is not easy for immigrants to gain citizenship, which in principle gives complete equality of rights.

The universal principles of republicanism, however, support only the equality of individuals, and require that all individual characteristics (such as religion) to be limited to the private sphere. Thus, newcomers (immigrants) are allowed to join the community only if they are in accordance with the rules of the policy and are willing to abide by the host country's national culture.

The French model in theory is to be taken as an example by other countries. But important after so many years of politics on immigration is to see how this theory with its principles of universal human rights, was put into practice, what were its results in reality of the co-existence of “different” with “homogeneous” French. To accomplish the goal of this study primarily will have to do an analysis of French policy of integration of immigrants, highlighting the features of its strengths, we will make a historic journey to see how it has evolved since the Second World War until today, and thirdly what constitutes the aim of this study: How was applied in practice the French model of management of immigration and what are its results. To accomplish this analysis, we will need to analyze the ingredient factors of cohabitation between French and immigrants and the everyday life of immigrants in France such as: facilities and areas where they live, the education of children, the percentage of employment/unemployment, their economic situation, their attitudes toward religion in private life etc.

# DINAMIKA SOCIALE DHE JURIDIKE E MINORITETEVE ETNIKE NË RUMANI

Dr. Bledar Ilia

## 1. Konceptet bazë të minoriteteve

Problemi i minoriteteve kombëtare dhe raciale janë evidentuar qartë në disa shoqëri të caktuara dhe në periudha historike, dhe është krijuar nga qeverisjet perandorake dhe regjimet politike totalitare. Në thelb, dallimet midis minoriteteve dhe shumicës dominuese janë bërë edhe më të dukshme në terrenin e luftës për pushtet, në promovimin e vlerave kulturore dhe në arsimimin në gjuhën amtare.

Një përkufizim të termit të minoritetit e gjejmë në literaturën franceze, e cila e paraqet si një grup personash, të cilët dallojnë nga raca, feja, gjuha ose nga kombësia e grupit të mazhorancës në mes të të cilit jetojnë. Duhet të bëjmë dy saktësime: në radhë të parë, një grup nuk përbën një minoritet vetëm atëherë kur është i ndërgjegjshëm në vetvete që ka cilësinë e një grupi të ndryshëm nga të tjerët dhe ka ndjenjën e inferioritetit shoqëror, por edhe atëherë kur konsiderohet kështu. Njerëzit me flokë të kuq janë sot me të pakët se njerëzit me flokë të zinj, por kjo nuk do të thotë se ata formojnë një minoritet, sepse ngjyra e flokut nuk ka ndonjë kuptim shoqëror dhe kështu ata nuk mund të formojnë një grup te veçantë. Nga ana tjetër, termi i minoritetit ka gjithmonë një dimension social dhe politik: Në shumicën e rasteve, minoriteti përbën një grup më të pakët numerik, e vlerësuar në një masë më të vogël dhe me më pak influencë, por megjithatë situata nuk mund të përgjithësohet. Njerëzit me ngjyrë,

të cilët janë mazhoritarë për nga numri në Afrikën e Jugut, përbëjnë megjithatë një minoritet në ierahinë sociale dhe politike”<sup>1</sup>.

## 2. Aspekte sociale të minoriteve

Në qoftë se në plan juridik problemi kryesor i minoriteteve është që të përfitojnë sa më shumë të drejta të barabarta me ato të mazhorancës, nga këndvështrimi sociologjik problemi që u intereson është ai i adoptimit dhe integritit i çdo minoriteti në gjirin e komunitetit human, lokal dhe kombëtar. Rrjedhimisht është e nevojshme që të njohim tipet kryesore të minoriteteve dhe lidhjet ndërmjet tyre dhe rrethit shoqëror.

Dihet se çdo shoqëri, për të ekzistuar, duhet të disponojë një territor, një popullsi aktive, një solidaritet të grupeve të cilat e formojnë, organizimin e aktiviteteve, praninë e një konsensusi për arritjen e objektivave të përbashkëta dhe të përpjekjeve për të vepruar në mënyrë kolektive.

Pranë proceseve të mirëkuptimit reciprok dhe të bashkëpunimit, të harmonisë dhe ekuilibrit, të akomodimit, asimilimit dhe integritit( e cila karakterizon detyrimisht dhe dominon një komunitet njerëzish).

Mendimtari francez me origjinë rumune, Serge Moscovici (drejtori i Shkollës të Studimeve Superioare në Fakultetin e Shkencave Sociale të Parisit), nënvizon ekzistencën e dy tipeve të minoritetit apo grupeve: *të ligjshme* dhe *të paligjshme*. Grupi i parë është shumë aktiv në mbrojtjen dhe promovimin e këndvështrimeve të tyre, ndërkohë që grupet e paligjshme janë më pasive dhe mjaftohen vetëm me mosaprovimin e mendimeve të grupeve të tjera pa e bërë të ditur pozicionin e vet ose opinionet e tij.

Grupet e ligjshme devijojnë nga normat e grupeve të tjerë dhe propozojnë rregulla të kundërt ose rregulla alternative. Duke mbrojtur rregulla alternative, këto lloje grupesh shfaqen në fushën sociale si grupe sociale të pavarura. Çdo grup do të krijojë një prezantim për grupet e tjerë në funksion të lidhjes që zotëron me këto marrëdhënie kooperimi, konflikti, suplementare, koalicioni.

---

1. Larousse. *Dicționar de Sociologie*, Editura Univers Enciclopedic, București, 1996.



Doise (1976) ka vërtetuar se prezantimet sociale, të cilat një grup i harton rreth vetes së tij dhe rreth grupeve të tjera përmbushin funksionet e shpjegimit, parashikimit dhe racionalizimit të marrëdhënieve sociale të cilat ai grup i mban me një grup tjetër. Për shembull, vlerësimi negativ i një grupi mund të jetë një fakt diskriminimi kundër tij dhe anasjelltas. Minoritetet e ligjshme, të cilat veprojnë në fushën sociale provokojnë, gjithashtu dhe një ndërgjegjësim të normave. Kështu, një minoritet mund të krijojë argumente të ndryshëm, për të justifikuar mbrojtjen e pozitave të saj të rregullta, me qëllim për të mos u shfaqur si ndonjë minoritet tjetër ose në të kundërt për t'i adoptuar ato. Mund të themi që marrëdhënia me minoritetet e ligjshme i lënë vendin një prezantimi të ri për grupin dhe për minoritetin në përgjithësi, prezantime të cilat mund të implementojnë një reflektim mbi rregullat dhe rregullat e kundërta<sup>2</sup>.

Në krahasim me grupet nomice, grupet *anomice* devijojnë nga rregullat mazhoritare dhe nuk propozojnë rregulla alternative të tyre.

Kështu, për këto grupe të krijohet ideja se janë më shumë kategori sociale sesa grupe të pavarura. Duke u konsideruar kategori sociale, prezantimi i këtyre grupeve nuk është marrëdhënia sociale e përkufizuar nga minoriteti, por është një efekt i etnocentrimit të mazhorancës, domethënë i tendencës për ta parë tjetrin nëpërmjet prizmit të paragjyqimeve personale. Flitet kështu për një kolektiv pa alternativa të shpjeguara, i cili në vend që të krijojë një konflikt, shtron një problem social dhe në shumicën e rasteve, provokon qëndrime të lënies në harresë dhe te indiferencës.

Duke u nisur nga natyra e aksionit social konsiderohen dy tipe minoritetesh: ato që devijojnë nga rregullat e shumicës dhe ato që përveç faktit që devijojnë kanë mundësi dhe të propozojnë një rregull alternativ<sup>3</sup>.

Sjellja e minoritetit në mbështetje të pozicioneve të veta mundet të jetë, në linja të përgjithshme, jo impresionues, i rreptë, ekstremist (duke manifestuar qëndrime radikale) ose impresionues, i modeluar (i cili infiltron shpirtin

---

2. Juan Antonio Perez, Francisco Dasi, *Reprezentările sociale ale grupurilor minoritare*, în vol. *Psihologie socială. Aspecte contemporane* (coord. Adrian Neculau), Editura Polirom, Iasi, 1996,

3. *Ibidem*

moderator dhe negociator). Është evidente që stili radikal ushqen aspekte konfliktuale dhe paragjykime negative në marrëdhëniet sociale ndërmjet mazhorancës dhe minoritetit, në një kohë që stili miqësor i negociimit favorizon kuptimin dhe sqarimin oportun të divergjencave.

Dorëheqja nga etnocentrizmi në qëndrimin e absolutizimit të normave dhe vlerësimin e disa kulturave duke qenë superiore (thekson qartë që kulturat e tjera janë inferiore) përbën në ditët tona një trashëgimi shpirtërore të botës së civilizuar dhe një objektiv të rëndësishëm të bashkëjetesës paqësore.

Kuptohet se rregullat janë relative, ato mund të azhurnohen dhe të ndryshohen, nëpërmjet negociatave dhe kompromiseve nga ana e agjentëve të jetës sociale, duke u reflektuar kështu në aprovimin nga ana e OKB në *Kartën e të Drejtave të Njeriut në vitin 1955*, i cili në nivel botëror, ka prezantuar një hap përpara për sa i përket raporteve ndërmjet mazhorancës dhe minoritetit kombëtar. Aktualisht, diskriminimi dënohet dhe nuk pranohet në të gjitha shtetet e zhvilluara.

Një ide më të qartë për praninë e minoriteteve në vendin tonë mund ta shohim te të dhënat që rezultojnë në bazë të *Regjistrimit të popullsisë dhe banesave të 18 marsit 2002*<sup>4</sup>. Informacionet paraprake dëshmojnë se popullsia e qëndrueshme ishte 21.698.181 banor, duke qenë kështu me rreth 1 milion (4,2%) më e vogël në krahasim me regjistrimin e vitit 1992 (22.760.449 banorë). Personat të seksit mashkull ishin 48,8% të totalit, kurse ato të seksit femër - 51,2% duke qenë në një rritje të lehtë në krahasim me vitin 1992 (kur popullsia femër ishte 50,8%). Raporti aktual ndërmjet sekseve është 1051 persona të seksit femër për 1000 persona të seksit mashkull.

Në krahasim me vitin 1992, në vitin 2002 është regjistruar, një rritje e popullsisë rurale (nga 45,7% në 47,3%) dhe në të njëjtën kohë, një tendencë në ulje e popullsisë urbane (nga 54,3% në 1992, deri në 52,7% në 2002). Koeficienti i popullsisë urbane është zvogëluar veçanërisht në rrethet Teleorman (me 14,1%), Caras-Severin (me 13,3%), Neamț (me 13,0%), Satu-Mare (me 12,4%), Brasov (me 11,2%), Vaslui (me 10,8%) dhe Hunedoara (me 10,0%). Koeficientët më të ulët të zvogëlimit të popullsisë urbane u regjistruan në pjesën jugore të vendit,

4. [www.Recensământ.ro](http://www.Recensământ.ro).

si për shembull Ilfov (10,2%), Dâmbovița (29,4%), Giurgiu (29,8%), Teleorman (32,1%) si dhe në rrethin Suceava (33,3%).

Rrethet me një koeficient mbi mesataren e vendit janë Hunedoara (75,9%), Brașov (74,0%), Constanța (70,2%), Cluj (67,2%), Sibiu (65,8%), Brăila (64,1%). Në 10 vitet e fundit (1992-2002) është konstatuar një rritje e lehtë e koeficientit të popullsisë urbane në rrethet Alba, Dolj dhe Ilfov. Në të njëjtën kohë, popullsia rurale ka njohur një rritje numerike në dhjetë rrethe, veçanërisht në rrethet Iași (8,6%), Constanța (7,4%), Vaslui (6,0%), Galați (4,5%) i Bacău (4,1%).

Në regjistrimin e marsit 2002, struktura e popullsisë etnike kishte këtë paraqitje në Rumani.

\*) nën 0.05%

ETNIA	2002	
	PERSONA	%
TOTAL	21.698.181	100,0
Rumune	19.409.400	89,5
Hungareze	1.434.377	6,6
Rome (Cigane)	535.250	2,5
Gjermane	60.088	0,3
Ukrainase-Rutene	61.353	0,3
Ruse - Lipovene	36.397	0,2
Turke	32.596	0,2
Tatara	24.137	0,1
Serbe	22.518	0,1
Slllovaqe	17.199	0,1
Bullgare	8.092	*
Kroate	6786	*
Greke	6513	*
Hebreje	5870	*
Çeke	3938	*
Polake	3671	*
Italiane	3331	*
Armene	1780	*
Etni të tjera	18950	0,1
Të padeklaruara	5935	*

Të dhënat statistikore tregojnë se personat që janë deklaruar rumunë, në regjistrim janë mazhoritarë me 89,5% nga popullsia e vendit (në prefekturën e Bukureshtit, 97% e kësaj popullsie është e etnisë rumune) kurse ajo e etnive të tjera përbënte 10,5% të të gjithë popullsisë, raporti i koeficientit është relativ i njëjtë me regjistrimin e vitit 1992. Numri i popullsisë me etni rumune është ulur me 4,9% në dekadën e fundit, ndërkohë që numri i popullsisë me etni të tjera është ulur me 4,7%.

Vlen që të përmendet se tek rubrika “etni të tjera” janë përfshirë kinezët (2.249 persona), hungarezët katolikë (1.370 persona), sllavo-maqedonasit (731 persona), shqiptarët (520 de persona), cara<sup>o</sup>ovenii (207 persona), sllovenët (175 persona), gägãuzii (turq të krishterë 45 persona) etj.

Etnia më e madhe e huaj, e cila jeton në territorin e Rumanisë janë hungarezët (6,6% e popullsisë totale të vendit) dhe romët/ciganët (2,5%). Minoritetet etnike kanë regjistruar një rritje të anëtarëve të tyre në vitin 2002 duke e krahasuar me vitin 1992, janë romët (me 134.163 persona), turqit (me 2764), kroatët (me 2701), grekët (me 2573) dhe italianët (me 1975).

Kurse disa etni të tjera kanë pësuar rënie domethënëse të numrit të anëtarëve të tyre: hungarezët (me 190.582 persona), gjermanët (me 59.374), serbët (me 6.890), ukrainasit (me 4.411), hebrenjtë (me 3.085), sllovakët (me 2.395), rusë-lipovenët (me 2.209), çekët (me 1.859), bullgarët (me 1.759), polakët (me 561), armenët (me 177).

Në 29 rrethe koeficienti i popullsisë të etnisë rumune është mbi mesataren e vendit. Minoriteti më i madh etnik, ai hungarez, ka një koeficient të lartë në rrethet Harghita (84,6%) dhe Covasna (73,8%) ku është mazhoritar, por edhe në rrethe të tjera, koeficienti ndryshon nga 20% deri në 40% të totalit të popullsisë (në rrethet Mure<sup>o</sup> 39,3%, Satu-Mare 35,2%, Bihor 25,9% °i Sălaj 23,1%).

Struktura e popullsisë sipas gjuhës amtare korrespondon me strukturën sipas etnisë, 91% kanë deklaruar se gjuha e tyre amtare është rumanishtja dhe 9% që flasin një gjuhë tjetër të ndryshme nga rumanishtja; 6,7% nga totali i popullsisë kanë afirmuar si gjuhë amtare hungarishten dhe 1,1% kanë deklaruar gjuhën rumune/cigane. Të tjera gjuhë amtare janë deklaruar nga një numër prej 267.664 personash (1,2%), kryesorët duke qenë gjuha gjermane, ukrainase, ruso-lipovane, turke, tartare, sllovaqe.

Të dhënat e regjistrimit të vitit 2002 janë bindëse për njohjen e minoriteteve nga pikëpamja gjuhësore në Rumani, ashtu sikurse vërehet edhe në tabelën e mëposhtme:

GJUHA AMTARE	2002	
	PERSONA	%
TOTAL	21.698.181	100,0
Rumune	19.741.356	91,0
Hungareze	1.447.544	6,7
Rumune (Cigane)	241.617	1,1
Gjermane	45.129	0,2
Ukrainase	57.762	0,3
Ruse	29.890	0,1
Turke	28.714	0,1
Tartare	21.482	0,1
Serbe	20.377	0,1
Sllovake	16.108	0,1
Bullgare	6.747	*
Kroate	6.355	*
Greke	4.146	*
Ceke	3.339	*
Polake	2.755	*
Hebreje	1.100	*
Gjuhë tjetër amtare	18.415	0,1
Të padeklaruara	5.345	*

\*) nën 0,05%

Duhet parë se numri i personave që kanë deklaruar gjuhën rumune si gjuhë amtare është zmadhuar me 332.000 persona në krahasim me ata që kanë deklaruar se i përkasin etnisë rumune. Një situatë e ngjashme është konstatuar dhe te personat që kanë deklaruar etninë hungareze, numri i tyre duke qenë 13000 më i madh.

Duke përdorur të dhënat e të njëjtit regjistrim, në mars të vitit 2002, jemi në gjendje të kuptojmë tipologjinë e popullsisë në Rumani në funksion të bindjeve fetare. Nga totali i popullsisë, 99,8% kanë deklaruar përkatësinë fetare dhe të besimit, situatë që as nuk mund të konceptohej para vitit 1990, atëherë kur regjimi komunist ndërmori një fushatë për zhdukjen e bindjeve fetare (të vlerësuar si obskurantiste dhe jo të dobishme për ndërgjegjen e njerëzve). Vetëm 0,1% (23100 persona) nga totali i popullsisë u deklaruan të pafe dhe ateistë.

Mazhoranca fetare është e përbërë nga të krishterët ortodoksë (86,7%), duke ditur faktin se kulti ortodoks ka një traditë të vjetër në tokat tona. Nga radha e minoriteteve shkëputen si koeficient ata që i përkasin Kishës romano – katolike (4,7%) dhe kulti i reformuar (3,2%). Shpërndarja e personave sipas përkatësisë fetare është si më poshtë vijon:

\*) nën 0,05%

FEJA	2002	
	PERSONA	%
TOTAL	21.698.181	100,0
Ortodokse	18.806.428	86,7
Romano-katolike	1.028.401	4,7
Greko-katolike	195.481	0,9
Reformuar	698.550	3,2
Penticostale	330.486	1,5
Baptiste	129.937	0,6
Adventiste e ditës së 7	97.041	0,4
Unitariane	66.846	0,3
Myslimane	67.566	0,3
E krishterë sipas Evangjeliste	46.029	0,2
E krishterë e ritit të vjetër	39.485	0,2
Evangjeliste luteriane sinodo-presbiteriane	26.194	0,1
Evangjeliste e besimit augustian	11.203	
Mozaike	6.179	*
Të tjera fe	106.758	0,5
Të pafe dhe ateistë	23.105	0,1
Të padeklaruar	18.492	0,1

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se, në vitin 2002, në kuadrin e shoqërisë rumune, mazhoritare ishte popullsia urbane (52,7%), seksi femër (51,2%), popullsia e etnisë rumune (89,5%) dhe gjuha amtare rumanishtja (91%) gjithashtu me popullsi të fesë ortodokse (86,7%). Në përgjithësi, shoqëria jonë përfiton nën aspektin etnik, gjuhësor dhe fetar duke hasur një homogjenitet të theksuar në krahasim me shoqëri të tjera të cilat janë heterogjene. Të tilla karakteristika të përgjithshme homogjeniteti justifikojnë edhe një herë legjitimitetin e nenit.1 të Kushtetutës së Rumanisë, e cila parashikon, se Rumania është shtet kombëtar, sovran dhe i pavarur, unitar dhe i pandarë”.

Marrëdhëniet sociale ndërmjet minoriteteve dhe mazhorancës gëzojnë interesin e privilegjuar nga radhët e shkencëtarëve dhe të specialistëve, por gjithashtu të një interesi të madh dhe të denjë për tu ekzaminuar janë edhe aksionet reciproke ndërmjet minoriteteve (më pak të studiuara), problemet sociale dhe specifike, imazhi përreth vetes dhe grupeve të minoriteteve më të mëdha, perceptimi social i minoriteteve në kontekste të ndryshme sociale, kulturore dhe të momenteve historike. Çdo analizë e problematikës të përmendur duhet të fillojë nga premisa e ekzistencës të grupeve minoritare dhe mazhoritare, gjithashtu dhe nga nevoja e tyre për të bashkëjetuar në një shoqëri unitare dhe multikulturore.

### **3. Aspekte juridike të minoriteteve**

Në mungesë të një kualifikimi profesional dhe mundësive për tu punësuar, shumë emigrantë të etnisë rome kanë mbërritur në vendet evropiane ku kanë kryer edhe vepra penale (vjedhje, plaçkitje etj.) dhe si rrjedhojë janë deportuar nga autoritetet e huaja drejt Rumanisë duke ju ndaluar atyre hyrjen në territoret e shteteve respektive.

Pa dyshim që zgjidhja e dëbimit të romëve nga shoqëritë e Europës Perëndimore është e përkohshme. Ekzistenca e disa kushteve të edukimit, ekonomike dhe materiale me karakter kombëtar, nga e cila të përfitojnë edhe romët, do të mundë të ulë fluksin e emigrimit dhe të japë kontributin në një masë të madhe në integrimin social të këtyre.

Në qoftë se në brendësi të komunitetit të tyre ata udhëhiqen nga rregullat e traditës dhe ligjeve të pashkruara, në raport me legjislacionin e shtetit dhe në marrëdhëniet me shtetasit e tjerë jashtë etnisë së tyre, romët adoptojnë një qëndrim më liberal (veçanërisht kur udhëtojnë nga një vend në tjetrin).

Duke parë efektet sociale dhe politike të vazhdueshme të romëve, e cila është një nga etnitë më të mëdha (pas asaj të hungarezëve), qeveria e Rumanisë ka hartuar *Strategjinë e përmirësimit të situatës të romëve* të vendit tonë, e cila mbështetet në 10 fusha veprimi duke filluar me administratën publike, sigurimet shoqërore, shëndetësia, ekonomia, drejtësia dhe rendi publik, mbrojtja e fëmijëve, edukimi kulturor, komunikimi dhe pjesëmarrja qytetare. Për më tepër në nivelin e ministrive më të rëndësishme ekziston edhe një komision për romët, e cila merret me aplikimin e masave të Planit të aksionit të Strategjisë të lartpërmendur. Gjithashtu në kuadrin e çdo prefekturë dhe bashkie janë punësuar ekspertë për problemet e romëve, me rolin që të ndërmjetësojnë midis administratës, komunitetit rom dhe organizatave jo-qeveritare.

Gjatë vitit 2001 janë zbatuar 34 projekte të organizatave jo-qeveritare në partneritet me autoritetet dhe komunitetin rom, por krahas këtyre projekteve gjithashtu ekzistojnë edhe projekte të tjera në zbatim, financimi i të cilave arrin në shifrën 2 milionë euro.

Duke pasur parasysh pasojat e veprave penale të kryera nga emigrantët romë në Bashkimin Evropian, qeveria e Rumanisë ka marrë masa shtesë për sigurimin e kufijve dhe ka ndaluar përkohësisht të drejtën e lëvizjes për emigrantët e paligjshëm dhe të atyre që kanë shkelur ligjet në territoret e shteteve të tjera. Kështu është *adoptuar një dispozitë emergjente që parashikon rehabilitimin shoqëror të romëve që kthehen në territorin rumun si rrjedhim i akordeve të riatdhesimit*, të cilat janë në fuqi midis Rumanisë dhe shteteve evropiane.

*Marrëveshja për mbrojtjen e minoriteteve kombëtare* paraqet instrumentin e parë multilateral, të detyrueshëm juridik, përkushtuar mbrojtjes të minoriteteve kombëtare në përgjithësi. Qëllimi i kësaj marrëveshje është të specifikojë parimet juridike.

Në këtë marrëveshje janë përkufizuar objektiva të ndryshëm në të cilat shtetet kontraktuese zotohen që t'i ndjekin nëpërmjet legjislacionit të tyre dhe



politikave kombëtare, si për shembull: barazia përpara ligjit; adoptimi i masave për ruajtjen dhe promovimin e kulturave të ndryshme në territorin e tyre; mbrojtja e identiteteve, feve, gjuhëve dhe traditave minoritare; garantimi i aksesit në mjetet e komunikimit në masë; stabilizimi i disa marrëdhënieve transkufitare dhe të bashkëpunimit me disa persona të cilët jetojnë legalisht në territorin e shteteve të tjera<sup>5</sup>.

*Karta evropiane e gjuhëve rajonale ose minoritare* është adoptuar nga Këshilli i Evropës në vitin 1992 në Strasburg dhe ka hyrë në fuqi më datën 1 mars 1998. Shtetet pjesëmarrëse kanë parasysh këto objektiva dhe parime<sup>6</sup>, të përcaktuara në këtë Kartë:

- njohja e gjuhëve rajonale ose minoritare si shprehje e pasurisë kulturore;
- respektimi i zonave gjeografike për secilën gjuhë rajonale ose minoritare, me qëllim që ndarjet administrative ekzistente ose të reja të mos përbëjnë një pengesë për promovimin e gjuhës respektive rajonale ose minoritare;
- domosdoshmëria e ndërmarrjes së një veprimtarie me qëllim promovimin e gjuhëve rajonale ose minoritare në jetën publike dhe atë private;
- zhvillimi dhe mbajtja e lidhjeve (në fushat e parashikuara nga kjo Kartë) ndërmjet grupeve, të cilat përdorin një gjuhë rajonale ose minoritare dhe grupeve të tjerë të të njëjtit shtet, të cilët përdorin në një formë identike ose të përafërt gjuhësore si dhe stabilizimin e lidhjeve kulturore me grupe të tjerë të shtetit respektiv, të cilët përdorin gjuhë të ndryshme;
- lehtësimi dhe inkurajimi i përdorimit oral dhe të shkruar i gjuhëve rajonale ose minoritare, në jetën publike dhe private;
- sigurimi i formave dhe mjeteve të duhura për studimin e këtyre gjuhëve në të gjitha nivelet përkatëse;
- sigurimi i lehtësive të cilat i mundësojnë atyre personave të cilët nuk flasin një gjuhë minoritare (por që jetojnë në zonat në të cilat flitet një gjuhë minoritare) ta studiojnë, n.q.s dëshirojnë këtë gjë;

---

5. *Manualul Consiliului Europei*, Biroul de Informare al Consiliului Europei la Bucuresti, Bucuresti, 2003.

6. Art.7, *Carta europeană a limbilor regionale sau minoritare*.

- promovimi i studimeve dhe kërkimeve shkencore të këtyre gjuhëve në universitete ose në institucione ekuivalente;

- promovimi i shkëmbimeve transnacionale, në fushat e parashikuara në këtë Kartë për gjuhët rajonale ose minoritare të përdorura në një formë identike ose të përafërt në dy ose më shumë shtete.

Në nenin Nr.27 të *Paktit ndërkombëtar, i cili i referohet të drejtave civile dhe politikës* parashikon se „shtetet në të cilat ekzistojnë minoritete etnike, fetare apo gjuhësore dhe personat që i përkasin këtyre minoriteteve nuk mund tu mohohet e drejta për të pasur së bashku me anëtarët e grupit jetën e tyre kulturore, të ushtrojnë dhe të praktikojnë fenë e tyre, si dhe të përdorin gjuhën e tyre”.

*Në mbledhjen e Kopenhagës* të vitit 1990 të OSBE (Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian) mbi dimensionet humane ka trajtuar në mënyrë të veçantë problemin e minoriteteve kombëtare, duke përfshirë në dokumentin final një kapitull që i referohet tërësisht kësaj kategorie personash.

#### 4. Konkluzione

Afirmimi i identitetit të një minoriteti etnik është një e drejtë thelbësore e njeriut dhe çdo anëtar ka të drejtën që të integrohet në shoqërinë mazhoritare ose në grupe të tjera minoritare. Bota në përgjithësi, në kontekstin evropian aktual njih një proces të gjerë integrimi, falë qarkullimit të shpejtë të informacionit, të sendeve dhe të personave, por rezistenca përballë këtij procesi, nga ana e një minoriteti ose komuniteti kombëtar është një problem i përkohshëm. Agjentët e fenomenit të globalizimit janë të pranishëm në pothuajse të gjitha fushat e aktivitetit dhe krijimit: ekonomik, politik, edukues, arsimor, kulturor etj. „Eksperienca historike tregon që minoritete të shumta janë asimiluar totalisht dhe pjesërisht. Në raste të tjera, numri i tyre është ulur ndjeshëm deri në limitin e shpërbërjes. Personat respektive kanë humbur emrat dhe shumë pak flasin gjuhën amtare. Vetëm në disa vende minoritetet kanë mundur të ruajnë gjuhën amtare dhe kulturën e tyre dhe janë zmadhuar në këndvështrimin numerik”<sup>7</sup>.

---

7. Ion Diaconu, *Minoritëpile, Statut, Perspective*, Institutul Român pentru Drepturile Omului, Bucuresti, 1996.

## BIBLIOGRAFIA

1. Diaconu, Ion, *Minoritățile, Statut, Perspective*, Institutul Român pentru Drepturile Omului, Bucuresti, 1996.
2. *Carta europeană a limbilor regionale sau minoritare.*
3. *Carta europeană a limbilor regionale sau minoritare.*
4. *Larousse. Dicționar de Sociologie*, Editura Univers Enciclopedic, Bucuresti, 1996.
5. *Manualul Consiliului Europei*, Biroul de Informare al Consiliului Europei la Bucuresti, Bucuresti, 2003.
6. *Pactul internațional cu privire la drepturile civile și politice.*
7. Perez, Juan Antonio, Dasi, Francisco, *Reprezentările sociale ale grupurilor minoritare*, în vol. *Psihologie socială. Aspecte contemporane* (coord. Adrian Neculau), Editura Polirom, Iasi, 1996.
8. \*\*\* *Revista de Asistența socială*, nr. 4-5, 2002.
9. Sauleanu, Lucian, *Societati Comerciale, Studii*, Universul Juridic, Bucuresti, 2012
10. \*\*\* *Vino mai aproape. Incluziunea și excluziunea romilor în societatea românească de azi*, Bucuresti, 2008.
11. Zamfir, Elena, Zamfir, Cătălin, (coord.), *Biganii între ignorare și îngrijorare*, Editura Alternative, București, 1993.

## SUMMARY

This article represents an image of the social minorities from Romania. A very important role in the analyze of the ethnic minorities has especially the analyze of the roma persons, and the aspects related to them: evolution, social inclusion and exclusion, discrimination, criminality, migration to the developed countries of European Union.

The affirmation of an ethnic minority identity is a fundamental human right and each member of a minority enjoys the freedom to integrate in the majority of the population or other minority groups. World, in general, and the actual European context are in an ample process on integration, thanks to the high-speed transferred information, goods or persons and the endurance in such a process, of a minority or national community, is a temporal problem. The agents of the globalization phenomenon are present in almost all the fields of activity and creation: economic, political, educational, cultural etc. “The historic experience showed us that the numerous minorities have been assimilated totally or partially; in other cases, their number decreased in such an extent that they almost disappeared, those persons losing their names and very few of them are still talking the maternal language; in few countries, the minorities kept their maternal language and their own culture and they increased their number”<sup>8</sup>.

---

8. Ion Diaconu, *Minoritățile, Statut, Perspective*, The Romanian Institute for the Human Rights, Bucharest, 1996 , p. 212.

# KONTRIBUTI I KISHËS ORTHODHOKSE AUTOQEFALE TË SHQIPËRISË NË ARSIM

**Olgert (Kristi) XHAFER<sup>1</sup>**

**PhD. Patris POSHNJARI<sup>2</sup>**

## **1. Ringritja dhe formimi nga themelet**

Ishte data 24 qershor e vitit 1992, kur me propozim të Patriarkut Ekumenik, Vartholomeut të I-rë, Sinodi i Shenjtë i Patriarkanës Ekumenike zgjodhi me votë unanime Kryepiskop të Tiranës dhe të Gjithë Shqipërisë, deri atëherë Ekzark Patriarkal (e ndërkohë të graduar mitropolit të Andrusës), Anastas Janullatosin. Kryepiskopi i ri, pasi dha Lajmin e Madh në Fanar (12.7.1992), u fronëzua në Katedralen e Tiranës më 2 gusht të viti 1992, në praninë e të gjithë klerikëve dhe përfaqësuesve laikë të dioqezave të Shqipërisë, të cilët prej shumë kohësh e prisnin këtë moment të rëndësishëm për Kishën e Shqipërisë. Ky çast do të ishte fundi i asaj periudhe të tmerrshme të Kishës së Shqipërisë, por njëkohësisht dhe fillimi i një periudhe të re për Kishën Orthodhokse në vend. Gjatë qëndrimit të tij njëvjeçar, ai konstatoi rrënimin e Kishës Orthodhokse dhe

---

<sup>1</sup>Ish - student i SHLP "Logos", ekonomist pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

<sup>2</sup>Pedagoge në Fakultetin e Ekonomisë, Departamenti Financë-Kontabilitet pranë SHLP "Logos".

shpërbërjen e strukturave të saj, si edhe punën e madhe, që duhej bërë për ringritjen e Kishës nga themelet.

Kryepiskopi Anastas e pa të domosdoshme hapjen e një shkolle, ku do të hidhnin hapat e parë klerikët dhe teologët e ardhshëm të orthodhoksisë shqiptare. Kjo u bë realitet më 7 shkurt të vitit 1992 me çeljen e dyerve të Seminarit teologjik “Ngjallja e Krishtit”<sup>1</sup>. Duke marrë parasysh kushtet e vështira, në të cilat ndodhej Shqipëria në atë kohë, shumë kandidatë shprehën gatishmërinë e tyre për t’u bërë pjesë e kësaj shkolle për të mësuar mbi besimin Orthodhoks e për të shërbyer si klerikë. Fillimisht seminari u strehua në ambientet e kampit të punëtorëve “Niko Bellojani”, në Durrës. Godina, në të cilën studentët jetonin dhe kryenin studimet ishte pothuajse e pabanueshme. Dhomat ishin me lagështirë dhe nuk ekzistonte sistem ngrohjeje.

Në të tilla kushte ky seminar vazhdoi për 5 vjet me radhë. Më pas, megjithëse u bë një kërkesë në qeveri për dhënien e një trualli për ndërtimin e një shkolle më të përshtatshme, asnjëherë nuk u mor ndonjë përgjigje.

Për këtë arsye u vendos, që ndërtesa e shkollës të ngrihej në territorin e lirë, në Manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Në këtë vend kishin mbetur vetëm gërmadhat e ndërtesave të mëparshme të shkatërruara mizorisht, duke filluar pikërisht me këtë manastir më 2 shkurt 1967 nga sistemi i regjimit totalitar komunist. Por disa qiparisa të moçëm dëshmonin ekzistencën e këtij vendi të shenjtë. Më 19 nëntor të vitit 1994, Fortlumturia e Tij, Kryepiskopi Anastas vendosi gurin e themelit në Kishën e Shenjtë të Shën Vlashit. Në të njëjtin vend dhe në të njëjtën ditë ai bekoji fillimin e punimeve për ngritjen e mjediseve të Shkollës Teologjike Hieratike<sup>2</sup>.

---

1. Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012), Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Tiranë 2013, fq.35-39.

2. Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012), Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Tiranë 2013, fq.35-39.



*Kampi i punëtorëve “Niko Bellojani” dhe (në të djathtë) Akademia Teologjike “Ngjallja e Krishtit” Shën Vlash, Durrës 1992.*

## **2. Përpjekja baritore e vazhdueshme e Kryepiskopit Anastas përgjatë viteve.**

Në statutin e vitit 2006, nene të veçanta i referohen veprës baritore dhe sociale të Kishës, formimit të krishterë të rinisë orthodhokse dhe botimeve të ndryshme. Njëkohësisht me veprën e saj shenjtëruese, predikuese, katekiste e shpirtërore, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë interesohet për përparimin në përgjithësi të shoqërisë shqiptare.

Ardhja e Kryepiskopit Anastas në Shqipëri ishte një dritë, që u kishte munguar prej kohësh besimtarëve orthodhoksë. Me forcimin dhe krijimin e strukturës organizative të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, të shumta janë veprat baritore të Kryepiskopit Anastas edhe pse mes vështirësive, sprovave dhe fyerjeve të njëpasnjëshme të personave dashakeqë. Vëmendje e veçantë iu kushtua edukimit orthodhoks të rinisë dhe pjesëmarrjes së saj aktive në jetën kishtarë.

*Kisha Orthodhokse e Shqipërisë paralelisht me rindërtimin e saj dhe zhvillimin e brendshëm, mori iniciativa të rëndësishme në çështjet e arsimit, shëndetit, përkujdesjes sociale, zhvillimit rural, ekologjisë dhe kulturës. Për kryerjen e aktivitetit të saj janë krijuar dy fondacione të Kishës (të njohura si persona juridikë): 1. Fondacioni “Klinika Orthodhokse e Ungjillëzimit”, 2. Fondacioni “Frymë Dashurie” që koordinon veprat në fushën e arsimit.*

*Ndër këto mund të veçojmë kontributin e vazhdueshëm në arsim.*

Përveç Akademisë Teologjike “Ngjallja e Krishtit” në Manastirin e Hirshëm të Shën Vlashit në Durrës, në Gjirokastrë në shtator të vitit 1998 u themelua Liceu Kishtar “Kryqi i Nderuar” me konvikt dhe nga viti 2007, funksionon një tjetër Lice Kishtar me konvikt në Sukth të Durrësit, me të njëjtin emër. Në vitin 2000 u themelua në Tiranë Instituti i parë i Formimit Profesional “Frymë Dashurie” dhe nga viti 2010 funksionon si ShLP “Logos” me Kartën e Bolonjës, sistemi (3+2) Bachelor dhe Master e një tjetër Institut Professional u themelua në Gjirokastrë (2004). Gjithashtu në Bularat të Gjirokastrës funksionon nga viti 2000, konvikti i vajzave “Trëndafili i Pavyshkur”, në të cilin banojnë dhe arsimohen nxënëse të shkollës së mesme. Në tetor të vitit 2012, nisi për herë të parë funksionimi i Shkollës së Muzikës Bizantine, me konvikt në qendrën “Thavor” në Tiranë pranë malit të Dajtit. Janë ngritur 21 kopshte në qytete të ndryshme të Shqipërisë : Tiranë, Durrës, Kavajë, Cërrik, Berat, Korçë, Elbasan, Pogradec, Lushnjë, Përmet, Sarandë, Gjirokastrë (2), Vlorë, Shkodër, Dërviçan, Tepelenë. Gjithashtu dhe 3 shkolla: një shqiptaro-amerikane “Protagonistët” në Tiranë, që përfshin (kopsht, shkollë nëntëvjeçare, shkollë e mesme) dhe dy shkolla të tjera nëntëvjeçare shqiptaro-greke “Frymë Dashurie”<sup>3</sup>.

### **3. Shpenzimet për arsimin në Shqipëri**

Arsimi është një nga zërat më të rëndësishme në buxhetet qeveritare. Për të analizuar shpenzimet e qeverisë për arsimin, përdoret teoria e të mirave publike. Duke parë rëndësinë e investimeve në arsim, vazhdimisht diskutohet: A janë të mjaftueshme shpenzimet për të? Gjithashtu shtrohet një pyetje tjetër: A ndikojnë shpenzimet më të larta në një arsim më të mirë? Shqetësimi më i madh qëndron tek rezultatet e studentëve, sesa tek shpenzimet e arsimit në vetvete. Duke ditur se ndikimi i shpenzimeve të shkollës për arritjet arsimore është një çështje e rëndësishme dhe interesante, ajo nuk na jep ndonjë evidencë konkrete

---


3. Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012), Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Tiranë 2013, fq.47-53.



në lidhje me një variabël tjetër të rëndësishëm - fitimet. Vlerësimet më optimiste sugjerojnë, se një rritje prej 10% e shpenzimeve të arsimit, gjeneron një rritje 1 apo 2 % në fitimet, që rezultojnë.

Duke konstatuar, që arsimi është një nga zërat më të rëndësishëm në buxhetet qeveritare, le të shohim në mënyrë tabelore dhe grafikisht se si kanë vijuar *shpenzimet arsimore në Shqipëri, për çdo banor të vendit për vitin 2005-2015*<sup>4</sup>.

	Buxheti i arsimit për frymë Në /000 Lekë	% e ndryshimit të buxhetit të arsimit për frymë
2005	8,425	3.47%
2006	8,733	3.66%
2007	10,499	20.22%
2008	12,177	16%
2009	13,148	8.0%
2010	12,838	-2.36%
2011	13,175	2.63%
2012	13,188	0.10%
2013	13,257	0.52%
2014	13,851	4.5%
2015	13,498	-2.55%



Grafiku nr.1

4. <http://www.financa.gov.al/>; <http://www.instat.gov.al/>, (Thirrur më 09.06.2015)  
Përpunimi dhe komentet: Open Data Albania.

Të dhënat e popullsisë për vitet 2005-2015 janë marrë nga INSTAT.

Të dhënat e buxhetit të arsimit për vitet 2005-2006 i përkasin Buxhetit Fillestar të miratuar.

Të dhënat e buxhetit të arsimit për vitet 2007-2008 i përkasin Buxhetit Suplementar

Të dhënat e buxhetit të arsimit për vitet 2009-2012 i përkasin Buxhetit të Rishikuar me Aktet Normative.

Të dhënat e buxhetit të arsimit për vitin 2013 i përkasin aktit normativ Nr.6, datë 4.10.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.119/2012, “Për buxhetin e vitit 2013. “Buxheti i rishikuar i vitit 2013 sipas Ministrive të Linjës dhe Institucioneve Buxhetore Të dhënat e buxhetit të arsimit për vitin 2014 i përkasin Buxhetit të Vitit 2014 Sipas Ministrive të Linjës dhe Institucioneve Buxhetore Të dhënat e buxhetit të arsimit për vitin 2015 i përkasin Ligjiit nr.160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015” - Tabela 1 - Buxheti 2015 (institucionet me programe)

Sikurse mund të vihet re nga grafiku, financimi i arsimit për frymë, rritjen më të lartë e ka pasur në vitet 2007-2008 përkatësisht me 20.22% dhe 16%, ndërsa në vitet e tjera ritmet e rritjes kanë qenë më të ulëta.

Për vitet 2012-2013 konstatojmë një rritje shumë herë më të vogël se në dhjetë vitet e fundit, me 0.1% për vitin 2012 dhe 0.52% për vitin 2013. Vitet, që kanë shënuar rënie në financimin e arsimit për frymë, ka qenë viti 2010 me 2.36% përkundrejt vitit 2009 si dhe viti 2015 me 2.55% krahasuar me vitin 2014. Kjo rënie ka ardhur kryesisht si pasojë e tkurrjes së buxhetit të arsimit në vitet e lartpërmendura.

#### **4. Veprimtaria e Kishës Orthodhokse në fushën e arsimit**

Në ligjin Nr. 10 057, Datë 22.01.2009, për ratifikimin e **“Marrëveshjes Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë për Rregullimin e Marrëdhënieve të Ndërsjella”**, vëmë re nënë që i përkasin pikërisht kontributit të Kishës në fushën e arsimit:

1- **Neni 17**; *Institucionet edukative dhe arsimore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*

2- **Neni 18**; *Kryerja e veprimeve sociale*<sup>5</sup>.

Arsimimi dhe edukimi i brezit të ri kanë qenë gjithmonë ndër synimet kryesore të kontributit të Kryepiskopit Anastas gjatë këtyre viteve në Shqipëri. Ndër veprimet e para, që kreu sapo erdhi si Ekzark Patriarkal ishte hapja e një shkolle për klerikët, që ata të përgatiteshin dhe të kishin nivelin e duhur arsimor përballë sfidave të kohës. Që nga ajo kohë, gjithmonë me kujdesin e tij të veçantë dhe me anë të mundësisë, që ai krijoi, u hapën një sërë qendrash edukimi, duke nisur nga arsimi parashkollor, ai parauniversitar e deri tek arsimi i lartë. Qëllimi i këtij kontributi është shërbimi cilësor në aspektin edukues dhe social për familjet në nevojë. Të gjitha shkollat e Kishës janë vendosur në ambiente private dhe

---

5. Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012), Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Tiranë 2013, fq.165-166.

financohen ekonomikisht prej saj. Në të njëjtën kohë ofrohen qindra bursa për fëmijë dhe të rinj të të gjitha moshave.

Nëse do i referohemi arsimit kishtar numri i bursave të plota (të llogaritura në vit), deri më sot ka arritur **2342**. Ndërsa në total numri i bursave vjetore, të plota ose të pjeshme të akorduara nga Kryepiskopi Anastas ka arritur në **24,596**<sup>6</sup>.

#### 4.1 Institucionet arsimore të Kishës Orthodhokse në vend

Në tabelën e paraqitur më poshtë duke u bazuar nga viti shkollor 2006-2007 deri në vitin 2014-2015 na tregohet ecuria e institucioneve arsimore të ngritura nga Kisha Orthodhokse në Shqipëri duke filluar nga ai parashkollor e deri tek arsimi i lartë së bashku me numrin gjithsej të pjesëmarrjes së fëmijëve, nxënësve, studentëve dhe përbërjes administrative (edukatorë, mësues, pedagogë e personel ndihmës).

	Viti 2006		Viti 2015	
	Parashkollor	9-të vjeçar	Parashkollor	9-të vjeçar
Pjesëmarrja (Fëmijë, nxënës, studentë)	800	182	818	765
Nr. i Institucioneve	14	2	21	3
Nr. Stafit	70	35	93	97


	Viti 2006		Viti 2015	
	I mesëm	I lartë	I mesëm	I lartë
Pjesëmarrja (Fëmijë, nxënës, studentë)	124	388	312	331
Nr. i Institucioneve	2	3	5	3
Nr. Stafit	44	122	89	98

**Tabela 1.** Totali i institucioneve arsimore, i pjesëmarrjes fëmijë, nxënës, studentë dhe personelit për çdo nivel arsimor nga viti shkollor 2006 deri në vitin 2015.

6. Revista “Gëzohu”, Viti XVII i botimit, shtator 2015, Nr. 9 (216), botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.

	Viti 2006	Viti 2015	Viti 2006-2015	
			Ndr në %	Ndr në nr
Pjesëmarrja (Fëmijë, nxënës, studentë)	1494	2226	49	732
Godina Arsimore	21	31	47.6	10
Nr. Stafit	271	377	39	106

Tabela 2



Grafiku nr.2

Nga të dhënat përmbledhëse të paraqitura në mënyrë tabelore dhe grafike vihet re kontributi arsimor i pareshtur i Kishës Orthodhokse në vend. Në këtë periudhë 10- vjeçare shohim punën, që është bërë mbi nivelin arsimor, pasi për çdo zë të paraqitur kemi rritje të dukshme. Përkatësisht numri i pjesëmarrjes së fëmijëve, nxënësve dhe studentëve është rritur me 49%, pra me një numër prej 732 personash. Gjithashtu vëmë re rritjen e investimeve me 47.6% të institucioneve arsimore përfshirë nivelin parashkollor, 9-të vjeçar e të mesëm. Ndërsa përbërja administrative nga viti 2006 deri në vitin 2015 është rritur me 39%, pra kemi rritje të personelit me 106 vetë<sup>7</sup>. *Ajo që mbetet për t'u theksuar e që duket qartazi është edhe ndikimi pozitiv i veprimtarisë së Kishës Orthodhokse*

7. Kalendarri Orthodhoks, viti 2007 fq. 44-49 dhe viti 2015, fq. 34-39.

*në punësimin në vend, pasi janë punësuar një numër i konsiderueshëm personash në këto institucione arsimore të ngritura dhe financuara nga Kryepiskopi Anastas. Për mbulimin e shpenzimeve të këtyre shkollave nevojitet një shumë mbi 1.2 milion euro në vit.*

## **4.2 Kontributi i Kishës Orthodhokse në restaurimin e institucioneve arsimore publike në vend.**

Kisha Orthodhokse e Shqipërisë përveç investimeve në institucionet e saj arsimore, ka përkrahur denjësisht dhe shkollat publike në vend, duke kontribuar në mënyra të ndryshme, që nga restaurimi i shkollave e deri në plotësimin e materialeve didaktike. Më poshtë na paraqiten disa nga shkollat publike në të cilat Kisha Orthodhokse ka krijuar mundësitë për përmirësimin e kushteve mësimore:

**1- SHKOLLA PUBLIKE FILLORE, FIKAS-ELBASAN** - Sip. e objektit. 145 m<sup>2</sup>/ Fillimi i veprës:1966/ Përfundimi i veprës: 1997

Pas restaurimit të Kishës së Shën Dhimitrit në fshatin Fikas, u financuan punimet e rikonstruktimit të shkollës publike fillore, si dhuratë për fëmijët e këtij fshati. Përtëritja rrënjësore e infrastrukturës dhe e ambienteve, përmirësoi kushtet mësimore të saj.

### **2- KOPSHTI PUBLIK I FËMIJËVE, MUCAJ-TIRANË**

Në vitin 2008, pas shpërthimit të depos së armëve në fshatin Gërdec, Kisha Orthodhokse kontribuoi moralisht dhe materialisht për të ndihmuar banorët. Ajo realizoi rikonstruktimin e kopshtit në fshatin Muçaj.

#### **• Ndërtime të tjera të qendrave arsimore publike**

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës gjatë vitit 1999 përpiloi një listë për rehabilitimin e ambienteve arsimore, të cilat kishin shërbyer për strehimin e një numri të madh të emigrantësh që erdhën në Shqipëri nga Kosova. Kisha Orthodhokse nëpërmjet zyrës “Diakonia Agapes”, ndërmori gjatë viteve 1999-2000, rikonstruktimin ose rindërtimin e objekteve të mëposhtme:

- 1- Shkolla e mesme Luz i Vogël, Kavajë
- 2- Kopshti Luz i Vogël, Kavajë

3- Shkolla 9-vjeçare “Konferenca e Pezës”, Tiranë

4- Kopshti nr.14, Laprakë-Tiranë

5- Kopshti nr.34, Kombinat-Tiranë

6- Shkolla fillore dhe kopshti, Shën Joan Vladimir, Elbasan

Gjatë asaj periudhe kritike, Kisha organizoi në zonën e Ndroqit një projekt të madh strehimi dhe ndihme, me kushte të shkëlqyera qëndrimi për emigrantët kosovarë. Pas rikthimit të tyre në Kosovë, Kisha kreu rikonstruktimin tërësor të shkollës publike fillore në fshatin e Ndroqit. Pas përfundimit të rikonstruktimit të të gjitha objekteve të lartpërmendura, shkollat u pajisën me bazën e nevojshme materiale didaktike, për të ngritur cilësinë mësimore (banka, karrige, tabela dhe mjete didaktike). Të gjitha ndërtimet e mësipërme u realizuan me mbështetjen financiare të agjencive ekumenike anëtare të ACT-së (Action by Churches Together) mekanizmi i emergjencës i Këshillit Botëror të Kishave<sup>8</sup>.

---

8. Vepra ndërtuese e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë gjatë viteve 1992-2012, volumni 1, fq.214-216.

**Institucionet arsimore  
të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë në vend.**



## Arsimi parashkollor (funksionimi i kopshteve kishtare në vend)

Me bekimin dhe kujdesin e vazhdueshëm të Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit Anastas dhe me iniciativën e Grupit të Grave Orthodhokse të qytetit të Tiranës u hap për herë të parë më 10 tetor 1994 përkujdesja ditore e fëmijëve pa dallim race apo feje. Në përkujdesjet ditore janë të mirëpritur fëmijët e familjeve në nevojë, si: familjet me të ardhura të pakta, familjet me prindër të divorcuar, familjet me një prind (jetimët), familjet, ku nënat janë me nivel të ulët edukimi, familjet me prindër emigrantë, ku fëmijët jetojnë me gjyshërit dhe familjet e nënave në punë.

Deri në vitin 2007 përkujdesjet ditore i kanë ofruar shërbim rreth 8100 fëmijëve, nga të cilët rreth 65% u përkasin familjeve me të ardhura të pakta, 2.5% familjeve me prindër të divorcuar, 2.7% jetimë, 4.5% me prindër emigrantë, që jetojnë me gjyshërit dhe rreth 45.5% nënave që punojnë. Ndërsa deri në vitin 2015 janë rreth **12,626** fëmijë, të cilët kanë frekuentuar qendrat e këtyre përkujdesjeve. Gjatë këtyre viteve, ofrimi i këtij programi ka qenë i suksesshëm, kjo është e dukshme nga vetë fakti i rritjes nga viti në vit i kërkesave për regjistrimin e fëmijëve në kopshtet e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë të ngritura me bekimin e Kryepiskopit Anastas. Përkatesisht bazuar në analizat statistikore për vitin shkollor 2014-2015, pjesëmarrja e fëmijëve në përkujdesjet ditore rezultoi me një rritje 26%, rritje kjo shumë më e lartë se në të gjitha vitet e tjera<sup>9</sup>.

Në vitin 2002 programi i përkujdesjeve ditore u bë pjesë e Fondacionit “Frymë Dashurie”, të cilat janë të licensuara nga Ministria e Arsimit dhe vizitohen rregullisht nga drejtoritë arsimore të rretheve përkatëse, e njëkohësisht janë vlerësuar si për programin ashtu edhe për ambientin. Përkujdesjet ditore të Kishës Orthodhokse jo vetëm janë vlerësuar nga drejtoritë arsimore, por janë bërë qendra kualifikimi dhe praktike për studentët e degës së Arsimit Parashkollor në Universitet dhe për stafin mësimdhënës të kopshteve të tjera publike të qytetit. Në të gjitha përkujdesjet ditore deri në vitin shkollor 2014-2015

---

9. <http://www.orthodoxalbania.org/>, <Vepra Sociale>, (Thirrur më dt. 30.03.2015).



numërohet një staf i kualifikuar prej 93 vetash, i përbërë nga edukatorë, ndihmës edukatorë dhe kuzhinierë.

### Shkolla “Protagonistët” Tiranë

Shkolla “Protagonistët”, Tiranë, pjesë e Fondacionit “Fryma e Dashurisë” është hapur në shtator të vitit 2002, e licensuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në bazë të Urdhrit Nr. 95 dt. 16.04.2003. Të gjithë nxënësit ndjekin programin shtetëror sipas MASH, përfshirë dhe njohuri shtesë në gjuhën angleze, shkencë dhe kompjuter. Shkolla “Protagonistët” në mënyrë të pandërprerë shikon aftësitë dhe talentet e secilit nxënës dhe i inkurajon në zhvillimin e fushave të ndryshme<sup>10</sup>. Për godinat e këtij kompleksi arsimor, që përfshin 2 godina për shkollën dhe 2 për kopshtin e mjediset sportive, janë investuar 2.56 milionë euro<sup>11</sup>.

Viti Shkollor	2007-2008	2008-2009	2009-2010	2010-2011	2011-2012	2012-2013	2013-2014	2014-2015
Nxënës	18%	-7%	13%	24%	5%	18%	11%	18%

17

**Tabela 3.** Përqindja e luhatshmërisë së pjesëmarrjes së nxënësve në shkollën 9-vjeçare “Protagonistët”, Tiranë, për vitin shkollor 2007-2008 deri në vitin 2014-2015.

- Për pjesëmarrjen e nxënësve në shkollën 9-vjeçare “Protagonistët”, Tiranë referuar vitit shkollor 2014-2015 kemi një rritje me 18%, dhe në total për të tri shkollat 9-vjeçare (Tiranë, Durrës, Gjirokastër) shënohet një rritje me 12%, krahasuar me vitin 2013-2014.

10. <http://www.orthodoxalbania.org/>, <Vepra Sociale>, (Thirrur më dt. 30.03.2015)

11. Gazeta “Ngjallja” nr. 5 (268), viti XXIII i botimit, maj 2015, Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, fq.12.

12. Kalendari Orthodhoks, viti 2007, fq.44-49; viti 2008, fq.44-49; viti 2009, fq.44-49; viti 2010, fq.45-49; viti 2011, fq.47-51; viti 2012, fq.47-51; Kalendari Orthodhoks viti 2013, fq.46-51; viti 2014, fq.46-51; viti 2015, fq.34-39.

## Arsimi kishtar

### **Shkolla e Mesme Kishtare Jopublike “Kryqi i Nderuar”, në Gjirokastrë dhe në Sukth të Durrësit.**

Me iniciativën dhe kujdesin e Kryepiskopit Anastas, u krijua dhe funksionon që nga shtatori i vitit 1998 shkolla e mesme kishtare jopublike “Kryqi i Nderuar” në Gjirokastrë. Procesi mësimor i shkollës zhvillohet në bazë të ligjeve të shtetit për shkollat jopublike dygjuhëshe fetare dhe me program të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në shtator të vitit 2007 një shkollë tjetër e mesme kishtare me po të njëjtin emër, nisi funksionimin e saj në Sukth të Durrësit. Edhe në këtë shkollë procesi mësimor zhvillohet në bazë të ligjeve të shtetit e sipas programeve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Objektivi i të dyja shkollave të mesme “Kryqi i Nderuar” si ajo e Gjirokastrës dhe e Sukthit në Durrës është krijimi i kushteve të përshtatshme, që të gjithë nxënësit të arrijnë një nivel të lartë kulturor e shkencor. Së bashku me stafin e tyre pedagogjik të specializuar ato synojnë edukimin, integrimin e nxënësve si anëtarë të denjë të shoqërisë, si dhe përgatitjen e kuadrove të aftë për nevojat dhe kërkesat e ndryshme të Kishës. Për gjimnazin “Kryqi i Nderuar” në Sukth mund të përmendim vlerësimin e nxënësve të këtij gjimnazi nga Drejtoria Arsimore Rajonale, Durrës, për vendet e treta, të dyta dhe të para për olimpiadat e vitit shkollor 2014-2015, ku gjashtë prej nxënësve morën shtatë vlerësime për lëndët: matematikë, fizikë, kimi, biologji dhe letërsi. Ndërsa në olimpiadat kombëtare për vitin 2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit organizoi në dt. 20.05.2015 ndarjen e çmimeve për nxënësit fitues të kësaj olimpiade, ku sërish nxënës të të njëjtit gjimnaz u vlerësuan për punën dhe përkushtimin e tyre me tri çmime, në vendin e tretë në lëndën e Biologjisë, në vendin e dytë në Kimi dhe në vendin e tretë në olimpiadën e Matematikës. Në të dyja rastet nxënësit u pajisën me çertifikata personale. Gjithashtu në mbyllje të vitit shkollor 2014-2015, liceu doli me rezultate të larta: kalueshmëria 100% dhe notë mesatare 9. Edhe në provimet e Maturës Shtetërore u arritën rezultate shumë të mira me një notë mesatare 8.7<sup>13</sup>.

---

13. Gazeta “Ngjallja” nr. 8 (271), viti XXIII i botimit, gusht 2015, Botim i Kishës Orthodoxkë Autoqefale të Shqipërisë, fq.2.

Për sa i përket pjesëmarrjes së nxënësve referuar dy shkollave të mesme “Kryqi i Nderuar” në Sukth dhe Gjirokastrë, për dy vitet e fundit shkollore shënohet një rritje me 20.7% në Sukth për vitin 2013-2014 dhe 35% në Gjirokastrë për vitin 2014-2015.

### **Akademia Teologjike “Ngjallja e Krishtit” Shën Vlash, Durrës.**

Akademia “Ngjallja e Krishtit” është institucioni i parë arsimor që Kryepiskopi Anastas ngriti në momentin e parë, kur mbërriti në Shqipëri, pasi e konsideronte si një nevojë urgjente krijimin e një institucioni, që do të përgatiste kuadro të rinj, të cilët do të përbënin zhvillimin e Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Seminari nisi funksionimin më 7 shkurt të vitit 1992, me 45 studentë, të cilët nisën studimet e tyre në këtë shkollë të vendosur fillimisht në një hotel në plazhin e Durrësit deri në vitin 1996, e më pas u vendos në Manastirin e Hirshëm të Shën Vlashit, në Shën Vlash të Durrësit me një kompleks multifunksional. Kompleksi përfshin kishën e shkollës, në të cilën bëhen shërbesat ditore, klasa mësimi, sallë informatike, sallë studimi, mensën, konviktin e djemve dhe atë të vajzave. Në vitet e para pjesëmarrja në këtë shkollë ishte vetëm për djem, të cilët përgatiteshin për t’u bërë klerikë të ardhshëm të Kishës Orthodhokse në Shqipëri, por në vitin 1997 shkolla hapi dyert dhe për përgatitjen e studimit e vajzave, të cilat do të shërbenin në aktivitete të ndryshme të kishës, dhe ishin vetëm 8 vajza që studiuuan për here të parë në këtë shkollë.

Vitet	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	TOTALI
Diplomuar	11	13	15	8	4	10	8	7	3	10	9	98

**Tabela 4.** Numri i studentëve të diplomuar në 11- vjeçarin e fundit 2005-2015.

Ajo që vihet re nga të dhënat tabelore është, se numri më i lartë i të diplomuarve rezulton në vitin 2007 me 15 studentë ndërsa numri më i ulët regjistrohët për vitin 2009 me 3 të diplomuar<sup>14</sup>. Në total numri i të diplomuarve

14. Të dhënat tabelore janë marrë nga regjistri studentor i Akademisë “Ngjallja e Krishtit”, Shën Vlash, Durrës.

në Akademinë Teologjike për këtë 11- vjeçar arrin në 98 studentë, nga të cilët rreth 90% prej të diplomuarve janë pjesë e administratës së Kishës me funksione të ndryshme laikë (katekistë) dhe klerikë.

Për sa i përket pjesëmarrjes së studentëve në këtë shkollë rritje e njëjtë dhe më e lartë shënohet për vitet 2012-2013 dhe 2013-2014 me 11%, dhe në vitin shkollor 2014-2015 nuk ka ndryshueshmëri<sup>15</sup>.

### **Shkolla e Lartë Private “Logos”**

ShLP “Logos”, është një institucion tjetër arsimor, i themeluar me bekimin dhe kontributin e Kryepiskopit Anastas. Në korrik të vitit 2010, me Vendim të Këshillit të Ministrave u miratua funksionimi i Shkollës së Lartë Private “Logos” sipas kërkesave dhe kritereve të kartës së Bolonjës dhe Akredituar me Urdhër Nr. 232 në datën 04.07.2012. ShLP “Logos” e ka nisur rrugëtimin e saj para vitit 2010 si Institut 2-vjeçar profesional “Frymë Dashurie” me vendimin Nr. 1055 datë 27.07.2009 të Këshillit të Ministrave.

Sot ShLP “Logos” prezantohet si institucion i lartë, që garanton një formim bashkëkohor teoriko-praktik në disipinat ekonomike, informatike dhe të teknikës laboratorike mjekësore me programe mësimore të standardeve evropiane, duke synuar vazhdimisht një përgatitje teorike shkencore dhe profesionale të studentëve, të cilat janë mjaft të kërkuara në tregun e punës dhe orientimi i tyre teoriko-praktik i jep siguri studentëve në këtë drejtim.

ShLP “Logos” vepron në treg me tarifa mjaft konkurruese. Në vitin e parë të saj ShLP numëronte 230 studentë, të cilët vendosën për të ndjekur studimet e tyre universitare në ShLP “Logos”, me një staf akademik në përputhje me kërkesat e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Aktualisht stafi përbëhet nga pedagogë të njohur dhe me përvojë në mësimdhënie, me tituj dhe grada shkencore të fituara apo në proces<sup>16</sup>.

---

15. Kalendar Orthodhoks viti 2007, fq.44-49; viti 2008, fq.44-49; viti 2009, fq.44-49; viti 2010, fq.45-49; viti 2011, fq.47-51; viti 2012, fq.47-51;

Kalendar Orthodhoks viti 2013, fq.46-51; viti 2014, fq.46-51; viti 2015, fq.34-39

16. Gazeta “Ngjallja”, nëntor 2010, Nr.11 (214), viti XVIII i botimit, botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, fq.20.

Treguesi i pjesëmarrjes së studenteve në këtë shkollë rezulton pozitiv, pasi për vitin mësimor 2014-2015, shënohet një rritje me 35%, 18.8% më shumë, krahasuar me vitin 2010-2011 dhe 4.6% me vitin 2011-2012<sup>17</sup>. Ndërsa nëse do t'i referohemi vitit shkollor 2015-2016, kërkesat e studentëve kanë qenë jashtë parashikimeve duke pasur një numër shumë të madh kërkesash, e për këtë shkollës iu shtuan dhe ambiente të reja me qëllim krijimin e hapësirave të përshtatshme. Në vitin 2013 SHLP "Logos" mori miratimin për programin e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional" me kohë të plotë, kohëzgjatja 1.5 vjet dhe "Master Shkencor", me kohë të plotë, kohëzgjatja 2 vjet.

Nr.	INSTITUCIONI PERKATES	Parashkollor	9-të vjecare	Gjimnaze	E Lartë
1	KOPSHTET (21)	5687			
2	SHKOLLA "FRYME DASHURIE" DURRES		262		
3	SHKOLLA "FRYME DASHURIE" GJIROKASTER		298		
4	SHKOLLA "PROTAGONISTET",TIRANE		690	51	
5	KOLEGJI "PLATON" KORCE			36	
6	SHKOLLA PROFESIONALE MESOPOTAM			353	
7	GJIMNAZI "KRYQI I NDERUAR" SUKTH			377	
8	GJIMNAZI "KRYQI I NDERUAR" GJIROKASTER			108	
9	AKADEMIA TEOLOGJISE, DURRES				436
10	SHKOLLA E MUZIKES BIZANTINE, TIRANE				6
10	ISH-INSTITUTI "FRYME DASHURIE", TIRANE				943
11	SH.LP "LOGOS"				682
	<b>TOTALI</b>	<b>5687</b>	<b>1250</b>	<b>925</b>	<b>2067</b>

**Tabela 5.** Totali i fëmijëve / nxënësve / studentëve të arsimuar në institucionet e Kishës Orthodhokse në vend që nga funksionimi i tyre.

Që nga fillimi i veprimtarisë së institucioneve arsimore të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, në të gjitha nivelet arsimore, deri në vitin mësimor 2014-2015, janë arsimuar 9929 nxënës dhe studentë<sup>18</sup>.

17. Kalendar i Orthodhoks viti 2007, fq.44-49; viti 2008, fq.44-49; viti 2009, fq.44-49; viti 2010, fq.45-49; viti 2011, fq.47-51; viti 2012, fq.47-51;

Kalendar i Orthodhoks viti 2013, fq.46-51; viti 2014, fq.46-51; viti 2015, fq.34-39

18. Marrë nga Zyra e Fondacionit "Frymë Dashurie", (Nga të dhënat është shtuar Shkolla e Muzikës Bizantine).

Kontributi në arsim është një faktor kryesor, që paraqet një rëndësi të madhe për të ardhmen e fëmijëve dhe për zhvillimin ekonomik-social të vendit, e pikërisht këtë gjë Kisha Orthodhokse e Shqipërisë me në krye Kryepiskopin e Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasin, e ka bërë dhe vazhdon ta bëjë *pa zhurmë dhe në mënyrë dinjitoze*.

## BIBLIOGRAFIA

- *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë (1991-2012), Kryepiskopi i Tiarnës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Tiranë 2013.*
- Revista *Gëzohu* – Viti XVII i botimit, shtator 2015, Nr.9 (216), botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë.
- *Gazeta “Ngjallja” Nr.8(271) Viti XXIII i botimit, gusht 2015, botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, fq.2.*
- <http://www.orthodoxalbania.org/>, <Vepra Sociale>
- <http://www.shlplogos.edu.al/>
- *Ilhan Ozturk a theoretical perspective, 2001. The role of education in economic development. <http://mpr.ub.uni-muenchen.de/9023/>.*
- *MSc Eda TEREZI, Eksperienca evropiane dhe arsimi e trajnimi profesional në Shqipëri, Ekonomia dhe formimi profesional, viti 2012.*
- *Arlinda Hoti, Arsimi si faktor i rëndësishëm në ekonomi, Ekonomia dhe formimi profesional, viti 2012.*
- **Dr. Chris Sarlo of Nipissing University**, *The minimum wage and poverty: A Critical Evaluation*
- **M. Mejstik and J. Burger** “Welfare and social policy in the Czech Republic” paper, june 1993.
- **Igor Tomes**, *E drejta e sigurimit social, Tiranë fq.187.*
- **G. T. Soldatos** *Ekonomia dhe Tranzicioni Nr.1, 1996.*

• **Kwiatkowski, D. and al.**. *Testing the Null Hypothesis of Stationarity against the Alternative of a Unit Root: Jurnal of Econometrics.*

## SUMMARY

Based on the fact that education is considered an important factor, which affects directly the social and economic development of a country, aim of this paper is to analyze and highlight the high contribution of the Orthodox Autocephalous Church to the education in Albania.

Education of the young generation has always been one of the main objectives of Archbishop Anastasios during these years. He created lots of opportunities for the younger generation by opening a number of centers for education, starting from pre-school centers up to institutions of higher education. By using and analyzing the statistical data, this paper shows the positive impact of the Orthodox Church on the performance of educational institutions opened by the Orthodox Church as well as a positive correlation between the activity of the Church in the field of Education and the economic development. Through its contribution in education, Orthodox Autocephalous Church of Albania aimed at improving the quality of education and helping families in need. All schools of the Church are located in private spaces and financed by the church. At the same time, the church provided hundreds of scholarships for children and young people of all ages. Regarding to the education, the number of full scholarships (annually calculated), until today has reached 2342, while the number of full or partial scholarships awarded to the students by the Archbishop Anastasios has reached 24.596 in a period of 23 years.

During a ten-year period it is noticed a positive performance of educational institutions, as the participation of children, pupils and students has increased by 49%, to a total of 732 people. Investments in educational institutions, including pre-school education and the 9-year compulsory education increased by 47.6%. The administrative structure changed by 39%, from 2006 to 2015, meaning a staff increase of 106 people.

The contribution of the Orthodox Church in education enabled a positive impact on the employment in the country. A considerable number of people are employed in these educational institutions established and funded by Archbishop Anastasios. At the same time the Orthodox Church of Albania besides to its investments in educational institutions, supported even the restoration of public schools and fulfilled their needs for didactic materials.

The Orthodox Autocephalous Church of Albania through the construction of infrastructure works, which reach up to 450 buildings, has contributed to the economic development by providing jobs for hundreds of local companies and hundreds of specialized employees. The Orthodox Church in Albania is one of the most serious investors to the country, having two basic features: it pays all taxes and all the money (in euros or dollars) remains inside the country.





- 1.** Në redaksinë e revistës shkencore “Logos” pranohen artikuj të cilët nuk janë publikuar më parë dhe nuk do të publikohen përpara se të dalin në këtë revistë.
- 2.** Artikulli duhet të përmbajë 4000-5000 fjalë.
- 3.** Abstrakti rreth 200 fjalë vendoset në fillim të artikullit.
- 4.** Artikujt duhet të paraqiten në gjuhën shqipe dhe përmbajtje të shkurtuar në gjuhën angleze, në hard copy dhe në formë elektronike, të punuara në Microsoft Word, me shkrim “Palatino Lynotype”, madhësi shkrimi “12”
- 5.** Në fillim të faqes së parë të artikullit vendoset emri dhe mbiemri i autorit, titulli akademik, grada shkencore, funksioni dhe emri i institucionit ku punon autori.
- 6.** Citimet dhe shënimet vendosen në fund të faqes dhe numërohen në mënyrë kronologjike.
- 7.** Tabelat, grafikët dhe ilustrimet numërohen në mënyrë kronologjike dhe poshtë shënohet burimi nga janë marrë të dhënat.
- 8.** Literatura e konsultuar ose bibliografia vendoset në fund të tekstit, e renditur sipas rendit alfabetik të mbiemrave të autorëve. Kur citohen disa vepra të të njëjtit autor, më përpara vendoset botimi më i hershëm.
- 9.** Çdo artikull i dërguar në adresën e redaksisë u jepet për recension dy studiuesve kompetentë në fushat përkatëse. Artikulli botohet nëse të dyja recensat janë pozitive. Nëse njëra është pozitive dhe tjetra negative, punimi i jepet një recensenti të tretë, vlerësimi i të cilit vendos për botimin ose jo të punimit.
- 10.** Varianti elektronik i çdo numri të revistës publikohet në faqen zyrtare të Shkollës së Lartë Private” Logos” [www.shlplogos.edu.al](http://www.shlplogos.edu.al)